

Korrik 2020  
Numri: 148  
E përnuajshme

Revistë edukative-kulturore - [www.revistaetika.com](http://www.revistaetika.com)

# ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë  
Kosovë: 1.5 Euro  
Maqedoni: 90 Den  
Evropë: 7 Euro

## MIRËSIA si SPROVË




revistaetika



progresibotime



E çfarë mund të jetë tjetër  
qëndrimi indiferent,  
pandjenja dhe injorant përballë  
mrekullive të pafundme  
madhështore, që prej  
grimcës më të vogël, e deri tek  
trupi më i madh, prej botës  
mikro, e deri në atë makro,  
të cilat ndriçojnë më së miri  
mendjen dhe zemrën,  
përveçse një çoroditje  
dhe falimentim i mendjes!?



Profeti (a.s.), thotë:

“Ditën e Kiametit asnjë rob  
nuk do të bëjë qoftë edhe një hap  
pa u pyetur se ku e ka kaluar jetën  
e tij, se çfarë ka bërë me dijen e  
tij, se ku e ka (tuar dhe shpenzuar  
pasurinë e tij dhe se ku e ka  
konsumuar trupin e tij.” (Tirmidhi,

Kiamet, 1/2417)

“Allahu i Madhëruar e do të riun e  
pjekur, që nuk sillet si fëmijë, që  
është drejtuar kah e mira dhe ka  
braktisur dëshirat e kënaqësitë (e  
ulëta të egos).” (Ahmed, IV, 151.)





Jeta e kësaj bote është quajtur “daru’l-imtihan / vendi i sprovës”, sepse në të gjitha aspektet e jetës bëhet fjalë për sprovat e ndryshme hyjnore. Këto, në një aspekt, janë sprova që nxjerrin në pah cilësinë e nënshtrimit ndaj Allahut të Madhëruar. Suksesit apo dështimit do të jetë shkak për lumturinë ose ndëshkimin e njeriut në jetën e përherëshme. Çështja është shumë serioze dhe për askënd nuk bëhet fjalë që të mos sprovohet. Pyetjet e këtij provimi janë të veçanta për secilin. Fusha e kësaj sprove është në varësi të mundësive apo pamundësive që i janë dhënë njeriut. Sprovimi me para, apo me një shprehje tjetër, sprovimi me pasuri, është njëri prej sprovimeve më të vështira. Në Kuranin Fisnik ka shumë ajete që flasin në lidhje me këtë çështje. Por në këtë shkrim, ne do të shtjellojmë dhe do të marrim mesazhet bazë të disa historive që Allahu Teala na i ka shfaqur në formën e tablove. Në suren Kehf tregohet biseda e një besimtari të vetëdijshëm me një besimtar të shkujdesur dhe të pasur:

*“Jepu atyre si shembull ndodhinë e dy njerëzve. Njërit prej tyre Ne i kishim dhënë dy kopshte vreshtash, që i kishim rrethuar me hurma e midis tyre kishim bërë fusha drithi. Të dy kopshtet jepnin frytet e veta, pa u munguar asgjë dhe bëmë që midis tyre të rridhte një lumë. Ai pati prodhim të bollshëm dhe i tha shokut të vet, duke biseduar me të: ‘Unë kam më shumë pasuri se ti dhe kam rreth më të fortë!’ Pastaj hyri në kopshtin e vet dhe, duke qenë i padrejtë me vetveten, tha: ‘Unë nuk mendoj se kjo do të shkatërrohet ndonjëherë dhe nuk mendoj se do të arrijë ndonjëherë Ora (e Kiametit). Por, edhe nëse do të më kthejnë te Zoti im, sigurisht që do të gjej një vend më të mirë se ky (kopsht)’! Shoku i tij i tha: ‘A e mohon ti Atë, i Cili të ka krijuar nga dheu, pastaj nga pika e farës dhe të bëri më në fund njeri të plotë?! Sa për mua, unë besoj se Allahu është Zoti im dhe Zotit tim unë nuk i shoqëroj askënd (në adhurim). Do të ishte më mirë për ty sikur të kishe thënë, kur hyre në kopshtin tënd: ‘Kështu ka dashur Allahu! Nuk ka fuqi përveçse nëpërmjet Allahut.’ Nëse ti sheh se unë kam më pak pasuri dhe pasardhës, dije, Zoti im mund të më japë diçka më të mirë se kopshti yt, ndërsa në kopshtin tënd mund të dërgojë një shkatërrim nga qielli e të gdhijë rrafsh pa asgjë ose të bëjë që uji i tij (kopshtit), të humbasë në thellësi e të mos mund ta gjesh kurrë më’. Dhe pasuria e tij (e mohuesit) u shkatërrua, kurse ai i rrihte duart për gjithçka që kishte shpenzuar në të (pronën e vet), që tashmë ishte shkretuar nga rrënjët dhe thërriste: ‘Ah! Sikur të mos i kisha shoqëruar Zotit tim askënd!’ Kështu, ai nuk pati kurrfarë rrethi që ta ndihmonte kundër Allahut dhe as që ishte në gjendje të mbronte vetveten. Në një rast të tillë, mbrojtja vjen vetëm nga Allahu, i Vërteti. Ai është më i miri për të shpërblyer dhe jep përfundimin më të mirë.” (Kehf, 32-44)*

Mesazhi bazë që jepet në këtë tablo, është e vërteta se kur njeriu nuk pranon që mirësinë e ka nga Allahu, privohet nga mirësia si rezultat i humbjes së sprovës dhe shfaqjes së mosmirënjohjes ndaj Zotit (xh.sh.).

## Korrik 2020

VITI: XIV

NUMRI: 148

## BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

## DREJTOR

Albert Halili

## KRYEREDAKTOR

Alban Kali

## REDAKTOR

Zija Vukaj

## PËRKTHYES

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

## DIZAJN

Bledar Xama

## ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

## MOBILE

+355 67 340 6182

## E-MAIL

rev.etika@gmail.com

## WEBSITE

www.progresibotime.com

## KOSOVË

Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 45 639 143

Prishtinë; Kosovë

Mob: +377 44 566 577

## MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7145 6003

## ABONIMI VJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

# Përmbajtja



8

Sprovimi me mirësi  
Dr. Adem Ergyl




Edukimi fetar dhe këndimi i Kuranit  
Nurullah Dag

12




16



34

Lumturia Familjare - Nënät e nderuara  
Osman Nuri Topbash

- 5 Sprova e myslimanit me pasuri  
Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz
- 7 Njeriu dhe bota tjetër  
Duran Ekizer
- 10 Kibla e zemrës, Kibla e trupit  
Ibrahim Arpaxhë
- 14 Ihlas dhe Iflas  
Ali Riza Temel
- 16 Thelbi i çështjes është në fillimin e punës  
Prof. dr. Harun Ĕmysh
- 18 Kushtet e të qenit njeri me shpresë  
Xhafer Durmush
- 22 Morali i lartë është pjekuri besimi  
Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan
- 25 Ruani pasardhësit tuaj prej zjarrit  
Prof. dr. Omer Çelik
- 28 Në cilën pjesë të rrugës jemi?  
Fuat Akpënar



52

- Dinjiteti njerëzor 30  
Duran Ekizer
- Një Ajet - Një Hadith 32

- Mirësia e dashurisë 40  
Zejneb Allbajrak
- Pema e hurmave e Ebu Xhehlit në xhenet 42  
Nuredin Jëlldëz
- Dhikri dhe vitaliteti me Kuranin 45  
Sadik Këllëç
- Dëshmorët nuk vdesini 52  
Osman Ersan
- Njerëzit që hanë besimin e tyre 54  
Abdurrahman Xhandan
- Respektimi i prindërve është porosi hyjnore 56  
Naim Drijaj

38

Nëse do të bësh plane  
fillo nga vetja  
Mehmet Dinç



Sakrifica, prologu i udhës drejt lumturisë  
A. Jasin Demirxhi

50







# S PROVA

## e myslimanit me pasuri

— Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz —

Marrëdhënia e njeriut me pasurinë dhe këtë botë, është një nga problemet e tij më të mëdha që prej krijimit. Prandaj, një nga synimet kryesore të fesë dhe besimit ka qenë rregullimi i sjelljes së njeriut ndaj kësaj bote. Për shkak të natyrës së tij, biri i njeriut është shumë i dhënë pas kësaj bote dhe të mirave të saj. Nëse njeriu nuk e frenon këtë pasion, ai nuk mund të shpëtojë lehtë prej ambicies dhe dëshirave të pashtershme, që e bëjnë atë sikur do ta gllabërojë gjithë botën. Në Kuranin Fisnik, Allahu i Madhëruar na këshillon të mos mashtrohemi nga kjo botë dhe urdhëron: **“Mos e hidh shikimin në të mirat kalimtare, që Ne ua kemi dhënë disave prej tyre si stoli të jetës së kësaj bote, për t’i vënë ata në provë! Shpërblimi i Zotit tënd është më i mirë dhe më e qëndrueshëm.”** (Ta-Ha, 131) Ndërsa në disa ajete të tjera, duke këshilluar mbajtjen e ekuilibrit, shprehet se rrugëdalja e vetme është puna.<sup>1</sup> Pra, mund të themi se, sukcesi i myslimanit në sprovën me pasuri, është kufizimi i nevojave, duke jetuar në mënyrë të ekuilibruar.

Nëse e trajtojmë sprovën e myslimanit me pasuri nga aspekti i drejtësisë sociale, që është edhe një nga çështjet të cilën mundohen ta realizojnë të gjitha fetë, sistemet politike dhe ekonomike, do të vëmë re se kjo është një çështje e cila më tepër se me ligje e kanune, mbrohet nga individët që kanë arritur pjekurinë njerëzore dhe ngopjen shpirtërore. Jo duke braktisur punën e duke ndërprerë prodhimin, por duke punuar e duke pakësuar konsumin personal, në mënyrë që t’i lërë një pjesë edhe vëllait të tij nevojtar. Pra, duke u treguar altruist e duke preferuar tjetrin para vetes. Në një shoqëri ku ekziston altruizmi, drejtësia sociale realizohet në një

atmosferë të plotë dashurie.

Ekonomia përkufizohet si shkencë e plotësimit të nevojave të pakufizuara nga burime të kufizuara. Në bazë të botëkuptimit të sotëm të ekonomisë moderne, nevojat janë të pakufizuara, ndërsa burimet janë të kufizuara. Pra, shihet qartë se sa e vështirë është të plotësosh nevojat e pakufizuara prej burimeve të kufizuara. Dëshirat dhe kërkesat njerëzore nuk kanë të mbaruar dhe, as jeta nuk mjafton për plotësimin e të gjitha këtyre. Prandaj, njeriu e shpenzon jetën e vet duke u munduar të sigurojë nevojat materiale dhe nuk ndan fare kohë për nevojat e tij shpirtërore, si adhurimi apo arti. Për këtë arsye, në traditën e kulturës islame, këshillohet që nevojat të pakësohen në nivelin e domosdoshmërisë, nën botëkuptimin **“një kafshatë, një rrobë”**, me qëllim që të mos bëhemi robër të pasurisë. Kjo, sepse gjëja më kryesore në këtë traditë, është të dish se çdo gjë i takon Allahut, duke e lidhur çdo gjë me Të.

Botëkuptimi **“një kafshatë, një rrobë”**, ka për qëllim kufizimin e nevojave të njeriut dhe ndalimin e tij nga vrapimi pas dëshirave e kërkesave të pa-fundme. Pejgamberi (a.s.), nevojat e domosdoshme të njeriut, i ka kufizuar në këto tri gjëra:

1. Disa kafshata që të drejtosh belin,
2. Veshje që ta mbron trupin nga të ftohtit e të nxehtit,
3. Një shtëpi për të futur kokën. (shih. Ahmed b. Hanbel, Musned, V, 81.)

Në fakt, botëkuptimi **“një kafshatë, një rrobë”**, i traditës kulturore islame, është si një përmbledhje e këtij e hadithi. Mirëpo, kjo nuk i shtyn njerëzit në dembelizëm dhe braktisje të prodhimit, ashtu siç pandehet e pretendohet. Përkundrazi, kjo i orienton ata të shkojnë pas dijes, kulturës dhe adhurimit. Nuk është e vështirë të përfytyrohet se si ia nxin

1. shih. Nexhm, 53/39.



jetën shpirtërore njeriut pasuria e kësaj bote për të cilën digjet nga dashuria, megjithëse ai nuk e zotëron atë.

Fusha ku kufizimi i nevojave njerëzore është më me ndikim, është ajo e konsumit. Veçanërisht në ditët tona, kur në sajë të reklamave të ndryshme “ekonomia e konsumit dhe e shpërdorimit” po e ndez gjithmonë e më shumë këtë fushë, çdo gjë është mbështetur në parimin e konsumit dhe shpërdorimi po përhapet me shpejtësi. Kurse marrja nën kontroll e nevojave dhe pakësimi i reklamave dhe elementeve nxitëse, do të bëhet shkak që vendin e ekonomisë shpërdoruese, ta zërë ekonomia e nevojës dhe prodhimitarisë. Njerëzit do të shpëtojnë nga shpenzimi i pavetëdijshëm i mundësive që prodhon teknologjia dhe i pasuri nuk do ta shtypë të varfrin. Po ashtu, i varfri do të shpëtojë nga bartja e dhimbjes ndrydhëse të varfërisë dhe nga kriza e shikimit të të pasurit me syrin e smirës.

Njeriu i ditëve tona, për shkak se ka humbur vlerat e larta shpirtërore, rend gjithmonë pas dëshirave dhe konsumit, duke qëndruar larg ndjenjave që i kanë hije njeriut, si arti, letërsia, adhurimi dhe shërbimi. Për shkak se nuk mund t'i kufizojë nevojat e veta, ai përjeton dilemën e atij “që nuk e di se çfarë kërkon dhe nuk e kupton kur e gjen atë”.

Kriteri i kufizimit të nevojave në sproven e myslimanit me pasurinë, është të jesh i kënaqur me atë që zotëron. Për aq kohë sa kjo lloj kënaqësie ruhet larg ekstremeve, disa nga ndjenjat dhe vlerat njerëzore ngelen të paprekura. Nëse shohim me kujdes, të mëdhenjtë e Islamit nuk kanë përçmuar këtë botë dhe pasurinë e saj, por “dashurinë ndaj kësaj bote”, e cila mbush zemrën dhe nuk lë vend për dashuri të tjera. Këto fjalë të Mevlanës e përcaktojnë shumë bukur kriterin në lidhje me këtë çështje:

*“Çfarë është kjo botë? Kjo botë do të thotë të jesh i shkujdesur ndaj Allahut. Kjo botë nuk është as rrobë, as flori, as fëmijë e as grua.”* (Mesnevi, I, b. 984.)

Në botëkuptimin islam, ku prej besimit ngrihesh drejt devotshmërisë dhe mirësisë, këshillohet të hapësh krahët prej një jete të kufizuar nga kjo botë, drejt botës së përjetshme dhe të udhëtosh drejt botës tjetër me mendimin për të shpëtuar shpirtin, i cili është burgosur nga prirjet e dëshirat. Edhe pse jeta e kësaj bote është e gjerë dhe tërheqëse, për shpirtin e njeriut ajo është shumë e mërzitshme.

Siç shprehet edhe Mevlana; kjo botë është ngrohur shumë dhe i ngjan një hamami<sup>2</sup> të nxehtë. Pra, kjo botë është si një hamam, ku njeriu nuk merr dot frymë dhe i ngushtohet shpirti. Në fakt, hamami është një vend i gjerë dhe i lartë. Mirëpo, për shkak të nxehtësisë, ai ia merr e ia ngushton frymën nje-

riut, i cili nuk çlirohet dot pa dalë jashtë hamamit. Këtë veçori mbytëse e plasëse të botës, njeriu mund ta përballojë vetëm duke dhënë, duke ndarë dhe duke e çliruar shpirtin e tij nga ajo (bota). (Mesnevi, III, b. 3544.)

Sprova e njeriut me pasuri, është një çështje që lidhet me mbështetjen në Allahun (tevekulin), e cila formohet në zemër; është siguria në Allahun dhe kënaqësia ndaj asaj që vjen prej Tij. Kufizimi i nevojave është qëndrimi që mban njeriu ndaj egos së vet dhe edukimi i saj. Kushti themelor i edukimit të egos, është të japësh. Ky botëkuptim të mëson të mbështetesh jo tek pasuria, por tek Krijuesi i saj, pra të bësh durim pa u ankuar për shkak të varfërisë. Kjo, sepse në krye të shqetësimeve të kësaj bote që e prishin ekuilibrin shpirtëror të njeriut, vjen stresi. Ndërsa në krye të shkaqeve që i hapin rrugën stresit, qëndron lakmia dhe dëshirat e pashtershme. Midis dëshirës dhe dhimbjes, ekziston një lidhje, sepse dëshirat dhe kërkesat e pafundme bëhen burim i dhembjeve të pafundme. T'i pranosh njerëzit dhe ngjarjet ashtu siç janë dhe jo ashtu siç duhet të jenë, është një nga motivet kryesore të kënaqësisë shpirtërore. Kënaqësia dhe qetësia është një nga treguesit kryesorë të shëndetit shpirtëror. Ndërsa besimi dhe dorëzimi tek Allahu, janë kushtet bazë të kësaj.

Sprova e myslimanit me pasuri përbëhet nga pasioni dhe prova. Allahu i Madhëruar urdhëron: **“Si-gurisht që Ne do t’ju provojmë me frikë dhe uri, me dëmtim të pasurisë, të njerëzve dhe të të lash-tave!..”** (Bekare, 155) Nga kjo, kuptohet se pasuria dhe skamja, janë një provë prej Allahut dhe në sajë të durimit, njeriu mund të kalojë provën e skamjes, ndërsa në sajë të falënderimit mund të kalojë provën e pasurisë. Duke u mjaftuar me ato që ka kur është i varfër dhe duke ndarë me të tjerët mundësitë që ka kur është i pasur, njeriu realizon falënderimin ndaj asaj që zotëron. Edhe pse durimi dhe falënderimi janë veprime që reflektohen jashtë, ato marrin formë në zemër. Vendimi merret në zemër para se të bëhet durim ndaj varfërisë e të falënderohet për pasurinë. Mirëpo, durimi ndaj pasurisë, është më i vështirë se durimi ndaj varfërisë.

E vetmja rrugë e durimit ndaj pasurisë dhe varfërisë, është që kjo botë “plot dhimbje dhe pabesi”, të konsiderohet si kalimtare dhe të vazhdohen përgatitjet për në vendin e botës tjetër, i cili është edhe vendi ku do të jetohej përjetësisht. Pra, me qëllim që myslimani të dalë me sukses nga sprova me pasurinë, ai duhet të largohet nga pasuria e kësaj bote e të zgjedhë botën tjetër. Nëse nuk vepron kështu, ashtu siç po ndodh edhe sot, ai do të bjerë në prehrin e materializmit, i cili ndryshe quhet edhe “shekullarizëm”.

2. Hamam: Vend publik ku lahen njerëzit sipas traditës osmane.



# NJERIU DHE BOTA TJETËR

— Duran Ekizer —

Kurani Fisnik është shpallja e fundit, e dërguar për udhëzimin e njerëzimit. Ai na lajmëron se Muhamedi (a.s.), është peygamberi i fundit dhe se Islami është feja e fundit e plotësuar me dërgimin e tij. Për rrjedhojë, çdo gjë në këtë botë që ka lidhje me njeriun, ai mund ta gjejë në Kuran dhe në Sunetin e Pejgamberit (a.s.), që është edhe reflektimi i tij (Kurani).

Kurani Fisnik i drejtohet direkt njeriut dhe kërkon që edhe njeriu të krijojë lidhje me të. Argumenti më i fortë i këtij fakti është se në shumë ajete të Kuranit Fisnik theksohet aftësia që ka njeriu për të menduar. Nëse do të na duhej të jepnim një shembull, mund të përmendim ajetin 21, të sures Hashr, në të cilin urdhërohet: **“Sikur këtë Kuran t’ia shpallnim ndonjë mali, ti do ta shihje atë (mal) të përulur dhe të copëtuar nga frika e Allahut. Shembuj të tillë Ne ua japim njerëzve, me qëllim që ata të meditojnë.”**



Nëse e shohim Kurani Fisnik në mënyrë të përgjithshme, do të vëmë re se në shumë ajete të tij theksohet mjaft edhe bota tjetër. Këtë e vëmë re në mënyrë të veçantë në suret e fundit të Kuranit, ku kjo çështje na del përballë në mënyrë të shpeshtë së bashku me ndodhinë e Kiametit. Shkaku i kësaj, është që njeriu, të cilit i drejtohet Kurani, të përgatitet për jetën e përjetshme, e cila vjen pas kësaj jete dhe ku do të japë llogari për çdo gjë që ka bërë. Përfshi edhe peygamberët, të gjithë do të japin llogari në Ditën e Kiametit për veprat e tyre në këtë botë. Në një ajet fisnik, urdhërohet: **“Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë (e kësaj bote)!”** (Tekathur, 8)

Kurani Fisnik shprehet se njeriu ka dy jetë. Këto janë jeta e kësaj bote dhe e botës tjetër. Jeta e kësaj bote është jeta e tanishme, në të cilën gjendemi dhe ku po jetojmë realitetin e saj. Mirëpo, jetës së kësaj bote, e cila siç shprehet edhe Kurani, është e shkurtër aq **“sa hap e mbyll sytë”**, një ditë do t’i vijë fundi. Dhe në këtë botë të fundme duhet të fitojmë botën e pafundme. Nga kjo e vërtetë është e pamundur të iket. Prandaj, nuk duhet të mashtrohemi nga bukuria e jetës së kësaj bote të përkohshme dhe të hedhim pas shpine jetën e përjetshme.

Njeriu, për shkak të natyrës së tij, zgjedh më të lehtë dhe më të shpejtën. Ky fakt, në Kurani Fisnik shprehet me këto fjalë: **“Jo, por ju doni të shpejtën (jetën kalimtare) dhe e hidhni pas shpine jetën e botës tjetër!”** (Kijame, 20-21) Po ashtu, Kurani Fisnik shprehet se jeta e botës tjetër është më e mirë se jeta e kësaj bote, por njerëzit preferojnë jetën e kësaj bote. Ndërsa në ajetet 16-17 të sures A’la, urdhërohet: **“Por ju, përkundrazi, më shumë po e parapëlqeni jetën e kësaj bote, ndonëse jeta tjetër është më e mirë dhe e amëshuar.”**

Si përfundim, nuk duhet të harrojmë se ka vdekje, ringjallje, llogaridhënie, peshore, xhenet dhe xhehenem. Shkurtimisht, ekziston një jetë tjetër që na pret dhe që është e përjetshme. Allahu na bëftë prej besimtarëve të mirë, që e mbajnë gjithmonë gjallë vetëdijen e besimit. Amin!





# SPROVIMI ME MIRËSI

— Dr. Adem Ergyl —

Jeta e kësaj bote është quajtur “daru’l-imtihan / vendi i sprovës”, sepse në të gjitha aspektet e jetës bëhet fjalë për sprovat e ndryshme hyjnore. Këto, në një aspekt, janë sprova që nxjerrin në pah cilësinë e nënshtimit ndaj Allahut të Madhëruar. Suksesit apo dështimit do të jetë shkak për lumturinë ose ndëshkimin e njeriut në jetën e përhershme. Çështja është shumë serioze dhe për askënd nuk bëhet fjalë që të mos sprovohet. Pyetjet e këtij provimi janë të veçanta për secilin. Fusha e kësaj sprove është në varësi të mundësive apo pamundësive që i janë dhënë njeriut. Sprovimi me para, apo me një shprehje tjetër, sprovimi me pasuri, është njëri prej sprovimeve më të vështira. Në Kuranin Fisnik ka shumë ajete që flasin në lidhje me këtë çështje. Por në këtë shkrim, ne do të shtjellojmë dhe do të marrim mesazhet bazë të disa historive që Allahu Teala na i ka shfaqur në formën e tablove. Në suren Kehf tregohet biseda e një besimtarit të vetëdijshëm me një besimtar të shkujdesur dhe të pasur:

**“Jepu atyre si shembull ndodhinë e dy njerëzve. Njërit prej tyre Ne i kishim dhënë dy kopshte vreshtash, që i kishim rrethuar me hurma e midis tyre kishim bërë fusha drithi. Të dy kopshtet jepnin frytet e veta, pa u munguar asgjë dhe bëmë që midis tyre të rridhte një lumë. Ai pati prodhim të bollshëm dhe i tha shokut të vet, duke biseduar me të: ‘Unë kam më shumë pasuri se ti dhe kam rreth më të fortë!’ Pastaj hyri në kopshtin e vet dhe, duke qenë i padrejtë me vetveten, tha: ‘Unë**

**nuk mendoj se kjo do të shkatërrohet ndonjëherë dhe nuk mendoj se do të arrijë ndonjëherë Ora (e Kiametit). Por, edhe nëse do të më kthejnë te Zoti im, sigurisht që do të gjej një vend më të mirë se ky (kopsht)! Shoku i tij i tha: ‘A e mohon ti Atë, i Cili të ka krijuar nga dheu, pastaj nga pika e farës dhe të bëri më në fund njeri të plotë?! Sa për mua, unë besoj se Allahu është Zoti im dhe Zotit tim unë nuk i shoqëroj askënd (në adhurim). Do të ishte më mirë për ty sikur të kishe thënë, kur hyre në kopshtin tënd: ‘Kështu ka dashur Allahu! Nuk ka fuqi përveçse nëpërmjet Allahut.’ Nëse ti sheh se unë kam më pak pasuri dhe pasardhës, dije, Zoti im mund të më japë diçka më të mirë se kopshti yt, ndërsa në kopshtin tënd mund të dërgojë një shkatërrim nga qielli e të gdhijë rrafsh pa asgjë ose të bëjë që uji i tij (kopshtit), të humbasë në thellësi e të mos mund ta glesh kurrë më’. Dhe pasuria e tij (e mohuesit) u shkatërrua, kurse ai i rrihte duart për gjithçka që kishte shpenzuar në të (pronën e vet), që tashmë ishte shkretuar nga rrënjët dhe thërriste: ‘Ah! Sikur të mos i kisha shoqëruar Zotit tim askënd!’ Kështu, ai nuk pati kurrfarë rrethi që ta ndihmonte kundër Allahut dhe as që ishte në gjendje të mbronte vetveten. Në një rast të tillë, mbrojtja vjen vetëm nga Allahu, i Vërteti. Ai është më i miri për të shpërblyer dhe jep përfundimin më të mirë.” (Kehf, 32-44)**

Mesazhi bazë që jepet në këtë tablo, është e vërteta se kur njeriu nuk pranon që mirësinë e ka nga

Allahu, privohet nga mirësia si rezultat i humbjes së sprovës dhe shfaqjes së mosmirënjohjes ndaj Zotit (xh.sh.). Nëse e shohim me vëmendje, kjo gjendje shprehet si rënie në shirk, që është mëkati më i madh. Në të njëjtën mënyrë u dënua edhe Karuni, i cili pandehte së pasurinë e kishte nga dija e tij dhe u zhyt në fund të dheut.<sup>1</sup> Edhe një tablo tjetër që tregohet në Kuranin Fisnik është në lidhje me disa njerëz, që e fshihnin pasurinë për veten e tyre, që nuk e ndanin me të varfrit, koprracë dhe që e pandehnin veten të mençur e dinakë. Allahu i Madhëruar thotë:

*“Ne i kemi vënë në provë ata (banorët e Mekës), ashtu siç i sprovuam të zotët e kopshtit, të cilët ishin betuar se në mëngjes do t’i vilnin frutat dhe nuk patën thënë: ‘Në dashtë Zoti!’ Kështu, kopshtin e goditi një fatkeqësi nga Zoti yt, ndërkohë që ata po flinin dhe gdhiiu si i kositur. Në agim, ata thirrën njëri-tjetrin: ‘Nxitoni herët në kopshtin tuaj, nëse doni t’i vilni frutat!’ Dhe u nisën duke pëshpëritur: ‘Të mos lejojmë asnjë të vobektë të hyjë në kopshtin tonë!’ Ata u nisën herët, të vendosur në atë që thanë. Por, kur e panë kopshtin, thanë: ‘Ne qenkemi vërtet të humbur, madje, qenkemi të privuar (nga frutat e kopshtit).’ Më i arsyeshmi ndër ta tha: ‘A nuk ju thashë unë se duhet ta lartësoni Allahun?!’ ‘Lavdëruar qoftë Zoti ynë! - thanë - Ne paskemi qenë vërtet të padrejtë!’ Atëherë filluan të qortojnë njëri-tjetrin. ‘Ah, të mjerët ne! - thanë ata - Paskemi qenë vërtet arrogantë! Zoti ynë mund të na japë një kopsht më të mirë, po të kthehemi të penduar tek Ai!’ I tillë ka qenë dënimi i tyre. Ndërsa dënimi në jetën tjetër, është më i madh, veç sikur ta dinin!’ (Kalem, 17-33)*

Mesazhi në këtë ajet është shumë i qartë: Paratë dhe pasuria nuk i përkasin vetëm atij që i janë dhënë. Aty kanë pjesë edhe nevojtarët. Largimi nga infaku nuk i jep begati pasurisë, përkundrazi, bëhet shkak që ajo të humbasë. Ndarja e pasurisë me të tjerët është një lloj i përkujtimit dhe madhërimit të Allahut Teala nga ana e zotëruesit të pasurisë. Kur njeriu të mos veprojë në këtë mënyrë, siç shprehet edhe Kurani, bën padrejtësi. Ne duhet ta dimë se Allahu Teala është kundër padrejtësisë dhe të padrejtë. Të padrejtët ndëshkohen që në këtë botë. Ndërsa ndëshkimi në Ahiret, pa dyshim se do të jetë më i ashpër.

Paratë, pasuria dhe mirësitë, sigurisht se janë të ëmbla. Dora e lavdëruar nuk është ajo që merr, por ajo që jep. I Dërguari i Allahut, (a.s.), çdo gjë e ka shpjeguar me këtë hadith të Tij: *“Sa mirësi e madhe është pasuria për një njeri të devotshëm!”* (Ahmed b. Hanbel, Musned, IV, 197,202.) Domethënë, e rë-

1. Shik. Kasas, 76-83.

ndësishme është që njeriu të jetë i devotshëm. Sa bukur e shpjegojnë këtë të vërtetë edhe këto ajete që bëjnë fjalë për Sulejmanin, alejhi’s-selam, në Kuranin Fisnik:

*“Ne i falëm Daudit Sulejmanin. Sa rob i mrekullueshëm ishte ai! Sigurisht se ai i drejtohej gjithnjë me pendesë Zotit! Kur një pasdite u paraqitën kuajt këmbëshpejtë, ai tha: ‘Unë me të vërtetë e dua pasurinë, ngaqë më bën të përkujtoj Zotin. Kur i humbën nga sytë dhe ikën, tha: ‘M’i ktheni ata (kuajt)!’ (Kur erdhën kuajt), filloi t’u ledhatonte këmbët dhe qafën.”* (Sad, 30-33) Edhe në këtë mesazh që jep kjo tablo, tregohet mënyra e të qenit “rob i mrekullueshëm te Allahu”, kur të jepen mirësitë. Kjo do të thotë që mirësitë duhet t’ia kujtojnë njeriut Zotin dhe njeriu, gjithmonë duhet ta gjejë mundësinë e shansin për t’iu drejtuar Zotit (xh.sh.), me ato mirësi që i janë dhënë. Fitimi i madh është diçka e pëlqyeshme, përderisa nuk kalohen kufijtë që ka vendosur Allahu Teala. Ndërsa lakmia për të fituar sa më shumë pa pasur kujdes ndaj hallallit dhe haramit, i sjell njeriut shkatërrimin e tij. Në Kuranin Fisnik shfaqet një tablo shumë spikatëse në lidhje me këtë. Allahu i Madhëruar thotë:

*“(O Pejgamber!) pyeti ata për qytetin që gjendej në bregdet dhe për çfarë i gjeti banorët e tij kur thyen urdhëresën e Sabatit (të shtunës)!<sup>2</sup> Atë ditë u vinin peshqit me shumicë, ndërsa ditëve të tjera që nuk i kremtonin, nuk u vinin. Kështu, Ne i vumë në provë, sepse bënin punë të mbrapshta. Kur disa prej tyre thanë: ‘Përse këshilloni, kur e dini se Allahu do t’i zhdukë ose do t’i ndëshkojë ashpër?!’ Këshilltarët u përgjigjën: ‘Për t’u arsyetuar para Zotit tuaj dhe që ju të mund të ruheni nga gjynahet’. Por, kur e harruan atë për të cilën ishin paralajmëruar, Ne i shpëtuam ata që këshillonin, kurse i ndëshkuam ashpër keqbërësit, për shkak të mosbindjes së tyre. Kur ata ngulmuan me mendjemadhësi të bënin atë që u ishte ndaluar, Ne u thamë: ‘Bëhuni majmunë të përbuzur!’” (A’raf, 163-166)*

Njëri prej mësimëve më të rëndësishme që mund të merret nga ky ajet fisnik, është: Hapja e mundësive të fitimit të madh me rrugë haram, asnjëherë nuk duhet të pranohet si diçka e duhur. Kjo është humbja më e madhe që duket si fitim. Lloji i pasurisë, që e nxjerr njeriun nga të qenit njeri, në përgjithësi është nga ky lloj.

2. Njëra prej dispozitave hyjnore që u zbrit Musait, alejhi’s-selam, ishte respekti i ditës së shtunë duke mos u angazhuar me punët e kësaj bote dhe duke u preokupuar me punët e ahiret. Por disa çifutë që pandehnin se ishin dinakë, menduan se gjetën zgjidhjen e duhur për t’i kapur peshqit që vinin me shumicë. Në këtë mënyrë, përpiqeshin të shkelnin ndalesën e vënë nga Zoti (xh.sh.). Ajeti bën fjalë për gabimin që bënë këta njerëz.





# Kibla e zemrës, Kibla e trupit

— Ibrahim Arpaxhë —

Në fjalor, kuptimi i fjalës “kible” është drejtim apo anë nga e cila drejtohesh. Ndërsa si term nënkupton drejtimin nga i cili kthehemi kur falim namazin, pra Qabja. Drejtimi nga Qabja bëhet edhe gjatë ezanit, ikametit, therjes së kafshës, duasë dhe varrimit të xhenazes.

Në disa adhurime botëkuptimi i drejtimit është i rëndësishëm, si për nga aspekti i disiplinës, ashtu edhe nga aspekti i bashkimit në një qendër shpirtërore. Ky orientim shpreh, jo vetëm unitetin në planin shpirtëror me Allahun, i Cili është i pavarur nga “hapësira”, por edhe unitetin e umetit islam dhe të njerëzve që drejtohen nga e njëjta qendër shpirtërore. Uniteti dhe bashkimi i njerëzve që kanë një qëllim dhe një besim, arrihet me demonstrime të përbashkëta materiale dhe shoqërore. Kibla është jashtëzakonisht e rëndësishme për nga aspekti i garantimit dhe shfaqjes së unitetit e bashkimit të umetit. Ajo është një nga kushtet e domosdoshme të namazit. Për shkak se myslimanët bashkohen në një kible të përbashkët, ata quhen edhe “Ehl-i Kible/ njerëzit e kiblës”. Pejgamberi ynë (a.s.), ka thënë:

*“Kush e fal namazin tonë, kthehet nga kibla jonë dhe ha prej mishit të kafshëve që therim ne, ai është nën mbrojtjen/përgjegjësinë e Allahut dhe të Pejgamberit të Tij. Prandaj mos e prishni garancinë e Allahut.”* (Buhari, Salat, 28.)

Fjala “kible” kalon shtatë herë në pesë ajete të

Kuranit Fisnik. Meqenëse kibla shpreh një drejtim, një orientim, ky drejtim duhet të jetë patjetër i përsosur dhe duhet të synojë mirësinë dhe bukurinë. Kuptimi i vërtetë i kiblës, është të drejtohesh për të fituar kënaqësinë e Allahut. Ja si shprehet Allahu i Madhëruar në Kuran: **“Të Allahut janë Lindja dhe Perëndimi, pra, ngado që të ktheheni andej është Fytyra (ana/kënaqësia) e Allahut...”** (Bekare, 115) Ndërsa Rasullullahu (a.s.), e ka përkufizuar në këtë mënyrë qëllimin e kiblës: *“Kur dikush prej jush drejtohet nga kibla, është drejtuar nga Allahu.”* (Ebu Daud, Salat, 22.)

Orientimet, të cilat nuk kanë për qëllim fitimin e kënaqësisë së Allahut, nuk kanë asnjë të mirë. Ndërsa në drejtimin nga e mira, gjendet kënaqësia e Allahut. **“Çdokush ka një drejtim nga i cili kthehet. Pra, bëni garë me njëri-tjetrin për punë të mira. Kudo që të gjendeni, Allahu do t’ju mbledhë të gjithëve...”** (Bekare, 148) Pra, përdërisa mbledhja e fundit do të jetë para Allahut, në këtë rrugë, përfundimi i së cilës është mbledhja, duhet të hyjmë me dëshirë dhe të mbledhim sa më shumë të mira. Rruga e vërtetë dhe drejtë, është ajo që të çon në kënaqësinë e Allahut. **“Kjo është rruga Ime e drejtë; prandaj ndiqeni e mos shkoni rrugëve të tjera, që ju shmangin nga rruga e Tij...”** (En’am, 153)

Kryesorja është drejtimi i zemrës, ndërsa drejtimi i trupit është kusht formal. Nëse e ke harruar qëllimin e vërtetë të drejtimit gjatë adhurimit, nuk ka rëndësi nëse i përshtatesh apo jo formës, duke e kthyer fytyrën nga lindja apo perëndimi. Nëse trupi është drejtuar nga Qabja e zemra nga idhujt, nuk konsiderohesh i kthyer nga Qabja, e cila është simboli i teuhidit. E rëndësishme është të thyesh idhujt në Qaben e zemrës dhe të kthehesh nga Qabja, e cila është simboli i materializuar i teuhidit.

**“Mirësia nuk është të kthyerit e fytyrës suaj nga lindja dhe perëndimi, por mirësia është (cilësi) e atij që beson Allahun, Ditën e Fundit, melekët, Librin dhe pejgamberët; e atij që me vullnet jep nga pasuria e vet për të afërmit, jetimët, të varfrit, udhëtarët e mbetur rrugës, lypësit dhe për lirimin e të robëruarve; e atij që fal namazin dhe e jep zekatin; dhe e atyre që i plotësojnë premtimet,**

**kur marrin përsipër diçka; e atyre që durojnë në kohë skamjeje, sëmundjeje dhe luftime. Këta janë besimtarët e vërtetë dhe këta janë ata që e kanë frikë Allahun.**” (Bekare, 177)

Ky ajet u jep përgjigje edhe grupeve që bënin thashetheme dhe dëshironin të krijonin ngatërresa në kohën e kthimit të kiblës nga Mesxhidi Aksa, në Mexhidi Haram, por thekson edhe qëllimin kryesor të kiblës. Ai tregon se formalizmi që nuk përmban besim, moral dhe virtyte nuk ka asnjë rëndësi. Sinqeriteti në adhurime është si shpirti në trup. Trupi pa shpirt nuk ka asnjë kuptim. Kibla është legjitimuar për t'u kujtuar atyre që falin namaz se duhet t'ia kthejnë shpinën çdo gjëje përveç Allahut dhe se vetëm atij duhet t'i drejtohen për lutje e përgjërime. Kthimi i fytyrës në një drejtim, është shkak për kthimin e zemrës. Ajeti fillon me besimin në Allahun dhe botën tjetër, sepse këto janë themeli i çdo mirësie dhe fillimi i çdo pune të dobishme.

Kibla e trupit është Qabja, ndërsa kibla e zemrës është Allahu. Thelbi i të gjitha adhurimeve, është drejtimi nga Ai, arritja e kënaqësisë së Tij. **“Jepja të drejtën e tij të afërmit, edhe të varfrit, edhe udhëtarit! Kjo është më e mirë për ata që e duan kënaqësinë e Allahut...”** (Rum, 38) **“Ne ju ushqejmë vetëm për hir të Zotit. Për këtë, nuk duam shpërblim e as falënderim!”** (Insan, 9)

Qëllimi i dhikrit është përkujtimi i Allahut. Gjuha është përkthyesja e zemrës. Kryesore është uniteti gjuhë-zemër. Adhurimet që nuk bëhen për hir të Allahut, që janë larg vetëdijes dhe sinqeritetit, shprehin ose shkujdesje, ose abuzim. Ibrahim (a.s.), në lidhje me kthimin e vërtetë shprehet: **“Unë e kthej fytyrën time nga Ai që i ka krijuar qiejt dhe Tokën, duke qenë besimtar i vërtetë dhe nuk jam nga idhujtarët!”** (En'am, 79) Qëllimi i kthimit të fytyrës nga Allahu, është drejtimi me gjithë qenie për nga Ai dhe kënaqësia e Tij. **Thuaj: “Në të vërtetë, namazi im, kurbanimi im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve.”** (En'am, 162)

Të fokusohesh vetëm tek simbolet dhe të mos njohësh kuptimet që shprehin ato, nuk është vepër e një myslimani të vetëdijshëm. Haxhinjtë flasin gjithmonë për Qaben. Mirëpo, askush prej tyre nuk flet për pronarin e Qabes. Kush është kryesore, shtëpia apo i zoti i shtëpisë? Vizita i bëhet shtëpisë apo të zotit të shtëpisë? Haxhinjve u thonë edhe “vizitorët e Rrahmanit”. E çfarë vizitorësh mund të jenë ata që e shohin shtëpinë dhe nuk e kujtojnë të zotin e saj? Edhe simbolet janë të rëndësishme. Mirëpo ato janë vetëm mjete përkujtimi.

Allahu dhe kënaqësia e Tij janë të përhershme. Të drejtohesh për nga e përhershëmja, është zgjedhje më e mençur se sa të mbash shpresat tek kalimtarja. **“Çdo gjë që është në Tokë, do të zhduket e do të mbetet vetëm Fytyra (Qenia) e Zotit Tënd, plot Madhësi dhe Nderim.”** (Rahman, 26-27)

Fytyra dhe zemra janë duhet të jetë e kthyer gjithmonë nga Ai dhe kënaqësia e Tij. Nëse një devijim i çastit nga kibla gjatë namazit, e prish namazin, devijimi i zemrës sonë për një çast nga Allahu, cendon devotshmërinë tonë. Edhe nëse nuk arrijmë të jemi njëqind për qind të devotshëm, të paktën gjatë namazit nuk duhet ta largojmë fytyrën e zemrën tonë nga Allahu dhe Qabja, e cila përfaqëson Njëshmërinë e Tij. Kjo është gjëja më e vogël që duhet të bëjmë patjetër.

Pejgamberi ynë (a.s.), ishte i kthyer gjithmonë në drejtim të Allahut dhe kënaqësisë së Tij. Madje edhe në gjumë dëshironte të qëndronte në atë drejtim. Sipas një transmetimi të Bera bin Azib, kur Pejgamberi (a.s.), shtrihej në shtrat, kthehej në të djathtë dhe bënte këtë dua: **“O Allah! Shpirtin tim ta dorëzova Ty, fytyrën time e ktheva nga Ti, çështjen time ta besova Ty e shpinën time e mbështeta tek Ti. Vendstrehim dhe vendshpëtim tjetër përveç Teje nuk ka.”** (Buhari, Texhrid-i Sarih, Hadithi nr: 2071) Ja pra, ky është orientimi dhe kibla e vërtetë. Mbështetja e plotë shpreh kthimin e plotë.

Besimtari, në çdo fazë të jetës, si në kamje e në skamje, në rehati e në vështirësi, në varfëri e në pasuri, në sëmundje e në shëndet, fytyrën dhe zemrën e tij e kthen gjithmonë në drejtim të Zotit të tij. Madje edhe varrosja e xhenazeve me fytyrë nga kibla, shpreh po të njëjtin kthim e drejtim.

**“Pra, vraponi drejt Allahut!..”** (Dhariat, 50) Ecja dhe vrapimi ynë le të jenë gjithmonë në drejtim të kënaqësisë së Tij. Vrapimi në ndonjë drejtim tjetër do të thotë largim prej Tij.

Sido që të jetë, më në fund **“.. Tek Ai do të ktheheni!”** (Ja-Sin, 83) Të kthehesh me dëshirë pa u kthyer me pahir, edhe të lehtëson, edhe të respekton. Padyshim se ai që dorëzohet vetë, nuk është i njëjtë me atë që kapet për leckash dhe sillet me zor. Kush kthehet tek Ai, sheh veprat e mirësitë e Tij dhe gjithmonë e falënderon Atë. Të gjitha adhurimet janë shprehje falënderimi. Të gjitha rebelimet dhe kundërshtimet janë kthim i shpinës ndaj Tij. Gjynahu është t'i kthesh shpinën Allahut, ndërsa pendimi është ta kthesh përsëri fytyrën nga Ai. Fjala pendim, nënkupton kthimin tek Ai.

Hixhret/Mërgim; do të thotë të shkosh në drejtimin që ka treguar Allahu dhe i Dërguari i Tij. **“...Ai (Ibrahimi) tha: ‘Unë do të mërgoj tek Zoti im!..’** (Ankebut, 26)

Shkurt e qartë; kibla e vërtetë është kibla e zemrës; është kthimi në drejtim të kënaqësisë së Allahut. Ndërsa Qabja, e cila është kibla e trupit, është simboli i këtij kthimi. Zoti i bëftë zemrat tona të kthehen në drejtim të kënaqësisë së Tij dhe jo në drejtime të tjera. Amin!..





# Edukimi fetar dhe këndimi i Kuranit

— Nurullah Dag —

Edukimi përkufizohet si procesi i ndryshimit dhe zhvillimit të sjelljeve. Bazuar në këtë edhe edukimi fetar konsiston në zbatimin e këtij procesi ndryshimi me anë të elementeve fetare. Ka shumë elemente islame, të cilat ndikojnë në personalitetin e njeriut. Prandaj, në emër të edukimit të personalitetit njerëzor, është e nevojshme që edhe këto elemente të përdoren më shumë. Këto elemente, si dashuria, siguria, liria, meditim, drejtësia, durimi dhe vullneti, formohen kur njeriu edukohet njëkohësisht nga të gjitha aspektet, si ato shpirtërore, ashtu edhe ato fizike. Nëse elemente të tilla funksionojnë në mënyrë të suksesshme, padyshim se do të kontribuojnë jashtëzakonisht shumë në fitimin e lumturisë personale dhe shpëtimin në botën tjetër.

Në këtë shkrim, krahas parimeve të edukimit fetar që duhen zbatuar për të arritur lumturinë e kësaj bote dhe botës tjetër, dëshirojmë të ndalemi edhe në rëndësinë e “Këndimit të Kuranit”. Këndimi i Kuranit zë një vend të rëndësishëm në edukimin fetar. Nuk ka dyshim se Kurani Fisnik është elementi më kryesor i shpëtimit të myslimanit dhe vlerësohet shumë, si për nga përsosmëria e shprehjeve origjinale, ashtu edhe për nga kuptimi që bart. Kjo veçori e tij ka shtyrë shumë dijetarë që ta përkufizojnë atë me shprehje magjepsëse.

Në lidhje me fjalën e përjetshme të Allahut të Madhëruar, janë bërë përkufizime të mrekullueshme. Disa nga këto përkufizime janë në lidhje me përsosmërinë e tij në këndim e disa të tjera

“Kurani është litari më i fortë i Allahut. Ai është një fjalë e mbushur me urtësi... dhe një rrugë që të çon tek Allahu. Ai i ruan nga rrëshqitja ata që e ndjekin atë dhe nga ngatërrimi, gjuhët që e lexojnë atë. Dijetarët nuk ngopen kurrë me të. Ai nuk e mërzit dhe nuk ia heq shijen atij që e lexon shumë. Anët e tij, që i mahnitin njerëzit, nuk kanë të sosur...”

në lidhje me dijet që burojnë nga thellësia e tij. Por këtu do të mjaftohemi me përkufizimin që bën Kurani për veten e tij dhe përkufizimin e bërë nga vetë Pejgamberi (a.s.), të cilat e shprehin më së miri madhësinë e tij. Në Kuranin Fisnik urdhërohet: **“Elif Lâm Râ. Këtë Libër ta kemi shpallur ty (o Muhamed), për t’i nxjerrë njerëzit me lejen e Zotit të tyre, nga errësira në dritë, në rrugën e të Plotfuqishmit, të Denjit për çdo lavd.”** (Ibrahim, 1) Ky përkufizim tregon qartë se Kurani është një libër edukimi.

Ndërsa, sipas Pejgamberit tonë të dashur (a.s.), Kurani: **“...është litari më i fortë i Allahut. Ai është një fjalë e mbushur me urtësi... dhe një rrugë që të çon tek Allahu. Ai i ruan nga rrëshqitja ata që e ndjekin atë dhe nga ngatërrimi, gjuhët që e lexojnë atë. Dijetarët nuk ngopen kurrë me të. Ai nuk e mërzit dhe nuk ia heq shijen atij që e lexon shumë. Anët e tij, që i mahnisin njerëzit, nuk kanë të sosur...”** (Tirmidhi, **Fedailu’l-Kuran**, 14; **Musned**, 1/91.)

Ky është një hadith shumë i gjerë, i cili tregon qartë shpirtin e Kuranit, përmbajtjen gjithëpërfshirëse të tij dhe faktin se ai është një thesar i pashtershëm. Pejgamberi (a.s.), e ka përkufizuar atë nga shumë aspekte, pasi e ka mësuar, kuptuar dhe jetuar në mënyrë të përsosur. Ata që bëjnë një jetë në përputhje me këtë përshtkrim, kanë hapur velat e lumturisë në një det të madh shpirtëror.

Nëse një burim kaq i rëndësishëm, paraqitet në mënyrë që të reflektojë kuptimin e saktë në aspektin e leximit, padyshim se kjo paraqitje do të hapë në zemrën e atij që e dëgjon një dashuri për këtë libër të pashoq dhe do ta ndihmojë njeriun të përfitojë nga urtësia e pashtershme e Kuranit.

Sipas një shprehjeje, e cila vlerëson aspektet e këtij libri madhështor, thuhet: “Kurani u zbrit në Arabi, u këndua në Egjipt dhe u shkrua në Stamboll.” Dhe me të vërtetë që zërat më të bukur dhe më të përsosur të Kuranit janë nga Egjipti. Përfaqësuesja kryesore e këndimit të Kuranit,

është zona e Egjiptit. Ky vend ka edukuar dhe ka nxjerrë njerëz të tillë, që kanë arritur gradën e përfaqësuesve në fushën e këndimit dhe të cilëve mjafton vetëm t’u përmendësh emrat dhe menjëherë do të lindë një lidhje dhe dashuri e veçantë për Kuranin.

Për shembull, kur kujton Abdussamedin, kupton se këndimi i Kuranit ka nevojë për një zë të bukur, kur kujton Mustafa Ismailin, kupton se në këndim ka nevojë për art dhe kur kujton Siddik Minshauin, kupton se në këndimin e Kuranit ka nevojë edhe për një lexim melankolik.

Nuk mjafton që Kurani të lexohet vetëm me fjalë. Atmosfera që duhet të japë melodia e tij, padyshim që duhet të jetë atmosfera që jep kuptimi i tij. Të ndjesh kuptimin e tij në një pikë, varet nga këndimi i tij me një stil të veçantë. Këndimi i Kuranit duhet ta bartë njeriun në horizonte të tjera. Ai duhet të reflektohet në zemrën e njeriut si një thirrje që vjen prej Allahut. Një këndim që nuk të ledhaton shpirtin, nuk të rehaton zemrën dhe nuk ndikon në fjalët dhe veprat e njeriut, nuk mund të arrijë sukses. Një këndim melankolik, është si një letër hyjnore. Po kështu, është edhe një këndim që përmban thellësi dhe art. Për këtë arsye, një letër që paraqitet në një format hyjnor, patjetër që do të bëhet shkak i shumë ndryshimeve në personalitetin e njeriut dhe do të marrë vlerë në edukimin fetar të njeriut.

Duke u nisur nga sa thamë më sipër, është e mundur të bëjmë këto vlerësime nga ana e edukimit fetar: Dëgjimi i këtyre leximeve kuptimplotë që përmbajnë një art të veçantë, e kënaq njeriun nga ana shpirtërore. Dhe kjo kënaqësi shpirtërore do ta bëjë njeriun ta dëgjojë veten në lidhje me jetën fetare dhe ta detyrojë atë deri në pikën e frenimit të gjynaheve të ndryshme. Me kalimin e kohës, tek njeriu do të zhvillohet ndjenja e mirësisë dhe gjithmonë do të korrigjojë fjalët dhe veprat e tij, duke qenë i vetëdijshëm se në çdo moment vëzhgohet nga kamerat hyjnore.





# IHLAS DHE IFLAS

— Ali Riza Temel —

Fjala ihlas është në kuptimin: dëlirje, pastrim dhe shpëtim; që përkufizohet si të bësh ibadete dhe mirësi, duke iu larguar sipërfaqësisë dhe interesave të caktuara dhe duke bërë gjithçka vetëm për hir të Allahut.

Shpirti i ibadetit është ihlas. Njeriu nuk ka dobi, as nga vepra pa ihlas e as nga ihlasi pa vepër. Zoti i Madhëruar e përkufizon fenë e vërtetë kështu: “... **ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me përkushtim të sinqertë, duke qenë në fenë e pastër** (të Ibrahimit), **si dhe të falnin namazin e të jepnin zeqatin. Kjo është feja e drejtë.**” (Bej-jine, 5)

Ndërkohë që bën ibadetet, të kesh tjetër qëllim përveç pëlqimit të Zotit, të bësh shirk apo të vep-rosh për sy e faqe, janë vepra që bien ndesh me ihlasin. Gjithçka që është e pastër dhe e sinqertë, është e pranuar.

Njerëzit janë në tre pozicione të lidhur me çësh-tjen e ibadetit. Ose bëjnë ibadete krejtësisht për sy e faqe, ose bëjnë ibadete duke përzier ihlasin me syfaqësinë, ose bëjnë ibadete vetëm me ihlas. Të parët, përveçse nuk kanë asnjë sevap, kanë gjyna-he shumë të mëdha. Të dytët, pra ata që përziejnë veprën e sinqertë me të pasinqertën, shpresohet që të falen, nëse do të pendohen. Të tretët, pra atyre që veprojnë vetëm me ihlas, shpërblimin ua jep vetë Zoti i Madhëruar.

Feja është sinqeritet. Cilësia kryesore e besimtarit është sinqeriteti. Syfaqësia është cilësi e hipokri-tit. Ata, ndërkohë që nuk besojnë, shfaqen sikur besojnë, që të arrijnë ndonjë interes të tyre ose për t’iu larguar ndonjë të keqeje të mundshme. Me shprehjen e Kuranit Famëlartë: “...**Kur ata ngrihen për namaz, ngrihen me përtesë, vetëm sa për t’u dukur para botës dhe Allahun e përmendin fare pak.**” (Nisa, 142)

Synimi i besimtarëve, kibleja e tyre, është gjith-një vetëm pëlqimi i Zotit. Ata thonë: “**Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.**” (Fatiha, 5) Sjellja e besimtarit është sjellja e Ibra-

himit, i cili kaloi jetën me një betejë monoteiste (tevhid) dhe mori përsipër që për hir të kësaj kauze të hidhej edhe në zjarr. Ai u shpreh kështu: “**Unë e kthej fytyrën time nga Ai që i ka krijuar qiejt dhe Tokën, duke qenë besimtar i vërtetë, dhe nuk jam nga idhujtarët!** (En’am, 79)

Le t’u kushtojmë vëmendjen e duhur këtyre këshi-llave të Pejgamberit (a.s.), që shprehin në mënyrën më të thjeshtë të mundshme ihlasin dhe dorëzimin (teslimijet): “**Kur të shtrihesh në shtrat, lutu në këtë mënyrë: ‘Allahu im! Ta dorëzova Ty tërë qenien time. E mbështeta shpinën tek Ti. Po e lë tek Ti veprën time me shpresë e frikë. Nuk ka tjetër strehë, tjetër mbrojtje përveç Teje. I besova Librit që ke zbritur. E pranova pejgamberin që ke dërguar.’** Nëse do të vdesësh në një natë pasi ke thënë këto, do të vdesësh mbi natyrshmërinë tënde (fitra). Nëse do të zgjo-hesh, do zgjohesh në një ditë të mbarë.” (Ibn Maxhe, Kitabud-dua, 15.) Këto shprehje janë shprehje të dorëzimit dhe ihlasit të plotë. Janë përtej frikës së shirkut dhe dyfytërisë.

Dyfytërsia është një shirk i fshehur. Shirku është e kundërta e teuhidit. Zoti fal gjynahet, përveç shirkut. Kurrë nuk pranon ibadetet që janë të për-ziera me shirk dhe dyfytërsi. “...**Kush shpreson takimin me Zotin e vet, le të bëjë vepra të mira dhe të mos i shoqërojë askënd në adhurim Zotit të vet!**” (Kehf, 110)

Begatia është në ihlas, kurse iflasi (falimentimi) është dyfytërsia. Begatia që gjendet në ihlas shpje-gohet në këtë mënyrë: “**Ata që shpenzojnë pasurinë e vet në rrugë të Allahut, i shembëlajnë atij që mbjell një kokërr nga e cila dalin shtatë kallinj, ku secili kalli ka nga njëqind kokrra. Allahu ia shton (shpërblimin) edhe më tepër kujt të dëshirojë; Allahu është Mirëbërës i madh dhe i Gjithë-dijshëm.**” (Bakara, 261) Hipokrizia e njerëzve të syfaqësisë përbëhet nga shkatërrimi dhe falimentimi total i tyre.

“**O besimtarë! Mos i çoni dëm lëmoshat tuaja duke ua kujtuar ato (atyre që ua keni dhënë) dhe duke fyer, siç vepron ai që e shpenzon pasurinë e**

*vet për sy e faqe të botës dhe nuk beson në Allahun dhe Ditën e Fundit. Ai shembëllen me një gur të lëmuar të mbuluar me dhé, mbi të cilin bie shiu me rrebesh, duke e lënë të zhveshur. Ata nuk kanë kurrfarë dobie nga veprat që kanë bërë, se Allahu nuk e udhëzon në rrugë të drejtë popullin mohues.”* (Bakara, 264) Ashtu sikurse shiu pastron dheun që gjendet mbi një shkëmb, edhe dyfytirësia heq begatinë e veprës në mënyrë të njëjtë.

Besimtari i vërtetë nuk pret ndonjë shpërblim apo falënderim nga njerëzit për ibadetet apo lëmoshat e tij. *“Por vetëm për të kërkuar Fytyrën (kënaqësinë) e Zotit të tij, më të Lartit.”* (Lejl, 20)

Shejtani nuk përzihet me robërit e sinqertë. Ib-lisi ka thënë kështu: *“... dhe të gjithë do t'i shpie në mashtrim, përveç robërve të Tu të sinqertë.”* (Hixhr, 39-40)

Përfaqësuesit më idealë të ihsanit janë pejgamberët. Në jetën e tyre nuk kanë asnjë grimcë dyfytirësie. Përndryshe nuk mund të ishin të besueshëm. Pasi ai që nuk beson, nuk arrin të bëjë të tjerët ta besojnë atë.

Isai është përpjekur që njerëzit t'i këshillojë që të ruhen nga dyfytirësia. Përmbledhtazi ai ka thënë këto: *“Ruhuni që të mos bëni syfaqësi para njerëzve. Kur të jepni lëmoshë, të mos e dijë dora e majtë atë çfarë jep dora e djathtë. Edhe kur të luteni, mos u bëni sikurse hipokritët. Kur të luteni mos bëni sikurse politeistët që u drejtohen idhujve të tyre me përsëritje të kota. Edhe kur agjëroni, mos të dukeni si hipokritët. Mos u dukni si agjërueshëm karshi njerëzve, por karshi Zotit.”* (Ungjilli, Mateu, 16.) Shprehjen *“Atë”* që kalon në Inxhil, e përkthym si *“Zot”*.

Një false e një gjëje është armikja më e madhe e origjinale, sepse, kanë të njëjtën pamje. Ari i vërtetë ka armik arin fals, pasi nuk është e lehtë të dallosh të vërtetën nga falsja. Prandaj dhe për besimtarët nuk janë rreziku më i madh femohuesit, por hipokritët. Mohuesi është i qartë, mund të mbahet qëndrim i qartë përballë tij. Kurse hipokriti, ngaqë duket si besimtar, është si një mikrob që qarkullon nëpër trup, i padallueshëm dhe nuk mund të mbahet qëndrim ndaj rrezikut që vjen prej tij. Paraja false është rreziku më i madh për paranë e vërtetë. Shprehjet dhe sjelljet e pasinqerta janë mashtruese dhe të rrezikshme.

Vlera e njeriut është në varësi të sinqeritetit që ka. Kauzat e mëdha janë bartur në supet e njerëzve të sinqertë dhe nëpërmjet njerëzve mashtrues janë degjeneruar.

Gjatë gjithë historisë ka ekzistuar dhe do të ekzistojë gjithmonë beteja e false me origjinalen. Nuk janë fjalët ato që faktojnë të sinqertin dhe hipokritin, por janë veprat. Veçanërisht në raste kur nevojitet një kosto e lartë apo sakrificë e madhe dallohet i sinqerti nga hipokriti.

Historia e njerëzimit është e mbushur me shembuj të njerëzve të sinqertë dhe atyre hipokritë. Le të përmendim një shembull tejet domethënës nga historia islame:

Njëri nga beduinët erdhi tek Pejgamberi (a.s.). I besoi Pejgamberit, nisi ta ndjekë atë dhe i tha se do të bënte hixhret bashkë me të. Resulullahu i rekomandoi disa nga sahabët për një udhëtim të tillë. Ndërkohë, nisi një luftë. Pejgamberi mblodhi ganimete (pasuri lufte) nga kjo luftë. Ashtu sikurse ndau për të gjithë, ndau edhe për të. Pjesën e personit në fjalë, Pejgamberi (a.s.) ia dorëzoi sahabëve që ata t'ia jepnin atij, pasi personi në fjalë po kulloste bagëtitë e tyre. Kur i shkuan pranë, i dhanë pjesën e ganimetit. Kur pyeti *“Ç'është kjo?”*, ata iu përgjigjën: *“Është pjesa që ka ndarë për ty Pejgamberi.”* E mori pjesën e vet dhe shkoi pranë Pejgamberit (a.s.) dhe e pyeti edhe atë se ç'ishte ajo. Resulullahu i tha: *“Kjo është pjesa nga ganimeti.”* Pas kësaj, beduini i tha: *Unë nuk të kam besuar ty për këtë dhe duke bërë me shenjë tek tyti, i tha: “Unë të besova ty, duke menduar se mu këtu do më binte një shigjetë për të rënë shehid dhe për të hyrë në xhenet.”* Atëherë, Resulullahu iu drejtua: *“Nëse vërtet je i sinqertë para Allahut për këtë fjalë, atëherë Allahu do ta plotësojë këtë dëshirë.”* Pas një kohe të shkurtër, u shfaq një tjetër luftë dhe personit në fjalë, ngaqë ishte gjuajtur me shigjetë aty ku ai kishte bërë me shenjë, kishte ndërruar jetë dhe, ashtu sikurse ishte u soll në prezencë të Resulallahut (a.s.). *“A është ky ai personi?”* – pyeti Pejgamberi (a.s.). *“Po”* – i thanë. *“Kjo do të thotë se ai paska qenë i sinqertë në fjalën që thoshte. Ndaj dhe Allahu ia plotësoi dëshirën e tij.”* – tha Pejgamberi (a.s.). U qefinos me xhyben e Pejgamberit, iu fal xhenazja dhe Resulullahu (a.s.), u lut në këtë mënyrë: *“Allahu im! Ky njeri për hir Tëndin bëri hixhret dhe për hir Tëndin ra shehid. Unë jam dëshmitar i kësaj.”* (Suneni Nesai, Xhenaiz, 61.)

Nga jeta e sahabëve fisnikë dhe të besimtarëve të tjerë gjenden plot shembuj të tillë mbi sinqeritetin. Sikur mos të kishte trima të tillë, që vepronin vetëm për hir të Allahut, pa pritur asgjë nga kjo botë, nuk do të jetonin dhe zhvilloheshin kauzat e vërteta, do të shkatërroheshin nga dora e abuzuesve dhe interesaxhinjve.

Dyfytirësia, mbi të gjitha është mashtrimi që i bën njeriu vetes dhe në një farë kuptimi është një vetëvrasje konceptuale. Është shndërrimi i identitetit të vërtetë në identitet fals. Ndonëse njeriu fiton ndonjë gjë nëpërmjet falsitetit, humbet veten. Çfarë mund të fitojë një njeri që ka humbur veten? Me siguri ky është edhe falimentimi më i madh. Pasuria që është humbur mund të fitohet sërish, mirëpo të rifitosh personalitetin është mjaft e vështirë. Le të mos na ndajë Zoti nga sinqeriteti dhe le të na ruajë nga iflasi (falimentimi) shpirtëror. Amin...





# THELBI I ÇËSHTJES ËSHTË NË FILLIMIN E PUNËS

— Doç. dr. Harun Ĕmysh —

Në përgjithësi ngjarjet i shohim pa u kushtuar rëndësinë dhe kujdesin e duhur. Kur ndodhin krime ndaj grave dhe fëmijëve, menjëherë kërkojmë që të shtohen ndëshkimet dhe të futet përsëri në fuqi ligji i ekzekutimit të fajtorit. Sapo të bjerë një tërmet, menjëherë vijnë në rendin e ditës mangësitë në lidhje me licencën e ndërtimit të ndërtesave, çështjet në lidhje me kontrollin e ndërtimeve, pamjaftueshmëria e kontrollit dhe shtimi i ndëshkimeve të sipërmarrësve që vjedhin nga materialet e ndërtimit. Ndodhin aksidente në punë dhe minatorët ngelin brenda në minierë. Çështja që diskutohet më parë, janë rregullat në lidhje me sigurinë e punës, vazhdimësia e kontrolleve dhe ndëshkimet e lehta që u jepen biznesmenëve të cilët keqpërdorin çfarëdo gjëje që të kenë mundësi. Përfundimisht jemi të bindur se çdo problem zgjidhet me sanksione. Ne pandehim se këto ngjarje të dhimbshme do të parandalohen

kur shtohen ndëshkimet. Sikur e gjithë çështja përbëhet nga të ndëshkuarit. Sigurisht se ndëshkimet duhen shtuar, nëse nuk janë në shkallën e duhur apo janë të pamjaftueshme, por a do të mjaftonte sikur të sillnit edhe ndëshkimin më të madh për t'i parandaluar këto ngjarje të kobshme? A janë bërë ato që duhet të bëhen para se të arrihet në ekzekutimin e ndëshkimit? Askush nuk pyet për këtë.

Ky lloj këndvështrimi, që e merr në qendër ndëshkimin, i ngjan perceptimit që kanë disa gjoja organizata islamike për Islamin, të cilat janë shfaqur në disa vende islame. Këto organizata, të cilat pohojnë se do të sjellin sheriatin, siç thuhet nëpër gazeta dhe televizione, e kuptojnë Islamin vetëm si zbatim ndëshkimesh të rënda, si prerja e dorës së vjedhësit dhe rrahja me kërbëç e atyre që kanë kryer

marrëdhënie seksuale të paligjshme. Në të vërtetë, nuk mund të gjendet një mënyrë më e mirë për ta shfaqur të shëmtuar Islamit në sytë e jomuslimanëve dhe madje edhe në sytë e muslimanëve. Në këtë mënyrë e poshtërojnë Islamit, duke e shfaqur sikur Islami të jetë prerje dore dhe rrahje me kërbaç dhe përhapin islamofobinë. Sigurisht se prerja e dorës së vjedhësit dhe rrahja me kërbaç e atij që ka kryer marrëdhënie seksuale të paligjshme është urdhër i Kuranit, por qëllimi i Islamit kurrë nuk janë këto gjëra. Për këtë arsye, sikundër përshtypjes që japin organizatat islame (e kam fjalën për ato të mësipërmet), Islami nuk kërkon për të gjetur njerëz amoralë dhe për t'i rrahur me kërbaç. Sikundër kësaj, Islami nuk mjaftohet vetëm me ndalimin e ndërhyrjes në jetën private të njerëzve, me ndalimin e të folurit pa argument në lidhje me ta dhe me ndalimin e paragjykimin të të tjerëve, por në të njëjtën kohë i dënon ashpër këto gjëra. Krimi më i vështirë për t'u argumentuar në Islam është marrëdhënia seksuale e paligjshme. Për ta vërtetuar këtë krim, duhen katër dëshmitarë, të cilët njihen për ndershmërinë e tyre, për mendjemprehtësinë e tyre dhe për aftësinë e të shikuarit. Këta dëshmitarë duhet ta shohim qartë penetrimin e organit mashkullor në organin femëror, siç përngjasohet në literaturën e jurisprudencës islame, siç hyn pena në shishen e bojës. Po ashtu, ndërmjet rrëfimeve të dëshmitarëve nuk duhet të ketë ndonjë kundërshtim me njëri-tjetrin. Mbi të gjitha, dëshmitarët nuk janë të obliguar ta padisin në gjykatën fetare ngjarjen që kanë parë. Madje, hadithet profetike përfshijnë një inkurajim në të kundërt me këtë, duke u shprehur se kush mbulon gabimin e vëllait musliman, edhe Allahu do t'ia mbulojë gabimin atij. Ajo që duam të themi është se Islami nuk ka për qëllim të ndëshkojë, por ai e ndalon përhapjen e kësaj veprë të shëmtuar në shoqëri duke u bërë në mënyrë të hapur. Të mos harrojmë se ka edhe fakihë që mendojnë se ndëshkimi bie me pendim.

Qëllimi i Islamit është mbrojtja e pesë vlerave që përbëhen nga jeta, pasuria, mendja, feja dhe nderi për të realizuar të drejtat e jetesës e pronësisë dhe liritë e mendimit, të shprehurit, fesë, ndërjegjes, martesës dhe shtimit. Për t'i mbrojtur këto vlera në shkallë universale, të cilat quhen Makasidu'sh-Sheriah (qëllimet e shariatit), sigurisht se mund

të përdoret edhe ndëshkimi. Por ndëshkimi është një masë dhe aplikohet më në fund. Prandaj shariatit nuk kërkon njerëz për t'u prerë dorën dhe amoralë për t'i rrahur me kërbaç. Synimi parësor i tij është realizimi i drejtësisë në shoqëri. Për këtë arsye, Islami siguron formimin e mundësive social-ekonomike, në mënyrë që të gjithë të kenë ushqim dhe punë, të gjithë të martohen dhe të bëhen me familje e fëmijë. Nisur nga kjo, zhvillohet shpirti i solidaritetit dhe ndihmës shoqërore, lehtësohen të martuarit, mbështeten ata që nuk mund të martohen, formohen vakëfe për t'u ardhur në ndihmë njerëzve dhe parandalohen mediat që i shtojnë të rinjtë drejt marrëdhënieve të paligjshme. Sigurisht se para të gjitha këtyre, individëve, duke filluar që nga familja, u injektohet frika ndaj Allahut Teala, u jepet vetëdija për t'i respektuar të drejtat e të tjerëve, u mësohet se një ditë do të dalin në gjykatën supreme (gjykatën e madhe hyjnore) dhe se çdo gjë e ka një llogari.



A mund t'i dhunojë të drejtat e të tjerëve një individ i edukuar në këtë mënyrë në një shoqëri të tillë? A vjedh nga materialet e ndërtimit nëse është sipërmarrës? A merr punëtorë pa sigurancione dhe a dhuron të drejtën e punëtorëve, nëse është biznesmen? A i favorizon të paaftët duke i penguar të aftët dhe duke marrë rryshfet, nëse është administrues? A mund t'i ngrejë dorë veçanërisht bashkëshorti bashkëshortes? A do të dëgjonim më për abuzimin me fëmijët dhe për krimet ndaj fëmijëve? Nëse del ndonjë që guxon t'i bëjë këto krime, edhe pse janë marrë që në fillim të gjitha këto masa, atëherë ai është një egërsirë dhe kriminel që e meriton ndëshkimin.

### IMAZH

Siç shikohet, çdo gjë rrotullohet rreth moralit. Por morali është çështja që e shtjellojmë më pak, madje, që nuk flasim aspak për të dhe që shpeshherë e anashkalojmë. Me të vërtetë, nëse shohim programin e shkollave, vëmë re se morali është njëri prej mësimëve që jepet më pak. Të gjitha ngjarjet e tmerrshme që pushtojnë rendin e ditës në vendin tonë, janë çështje që kanë të bëjnë me moralin. Për t'i zgjidhur këto probleme mund t'i shtojmë ndëshkimet, por të mos harrojmë se së pari duhet ta marrim seriozisht edhe kryerjen e atyre gjërave që duhet të bëhen që në fillim.





Xhafer Durmush



# KUSHTET e të qenit njeri me shpresë

Në suren Zumer thuhet kështu: **Thuaj: “O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti.”** (Zumer, 53)

Kuptimin e ajetit kuranor mund ta shpjegojmë më gjerë në këtë mënyrë: “O robërit e Mi, që keni dëmtuar veten tuaj dhe keni bërë disa gjynahe të caktuara! Mos hiqni dorë nga shpresa prej Allahut! Mos jini të pashpresë lidhur me faljen që do t’ju bëjë Ai. Padyshim që Allahu, nëse dëshiron, ua fal gjynahet robërve të vet dhe nuk i gjykon fare ata të cilët i janë shmangur shirkut. Zotëruesi i bujarisë ju fal ju. Mjafton të mos hiqni dorë nga shpresa për mëshirën e pafund të Tij; mbështetuni në mëshirën e Tij, duke kërkuar pendim dhe falje prej Tij.”

Sipas komentatorëve të Kuranit, ajeti në fjalë është shpallur për një grup shoqëror të caktuar që kishte frikë se mund të mos ua falte Zoti gjynahet e mëdha të mëparshme, si shirkun, shqetësimi i tjetrit, marrëdhënia seksuale jashtë kurorës, armiqësia ndaj Resulullahut (a.s.), lufta e bërë kundrejt tij etj. Aq sa Pejgamberi ynë i dashur (a.s.), ishte gëzuar që ishte shpallur një ajet i tillë, kurse sahabët e kishin vlerësuar si sihariqi më gjithëpërfshirës lidhur me faljen e gjynaheve. Ndaj dhe ishte bërë e ditur që dera e pendesës është gjithnjë e hapur për ata që e kanë kaluar cakun duke e tepruar përmes gabimeve

dhe harresës, deri në një kohë të caktuar.

Sipas asaj çfarë bëhet e ditur në **Ruhul-Bejan**, lidhur me ajetin në fjalë Pejgamberi (a.s.), është shprehur kështu: “Këtë ajet nuk e ndërroj me asgjë çfarë ka bota.” Pra, ky ajet është i barabartë me tërë botën dhe, edhe sikur t’me ofrohet e gjithë bota në këmbim të këtij ajeti, nuk e ndërroj. Pasi, Allahu i Madhëruar ka premtuar se do t’ua falen të gjithë gjynahet edhe robërve të vet që i kanë bërë keq vetes së tyre dhe u është ndaluar të heqin shpresat nga mëshira e Zotit. Mirëpo, ky ajet tregon se Allahu nuk do ua falë të gjitha gjynahet të gjithë njerëzve, por vetëm atyre që Ai dëshiron t’ua falë. Ndaj dhe urdhri për pendim që kalon në ajete, nuk bie ndesh me njoftimin se Ai do t’i dënojë ata që i kundërvihen Atij, as me urdhrin për sinqeritet në vepra e as me kanosjen (tehdid) me dënim që u bën Zoti njerëzve. Allahu i Madhëruar e fal shirkun vetëm atëherë kur njeriu pendohet dhe kur heq dorë tërësisht prej tij. Kurse gjynahet e tjera, të mëdha apo vogla qofshin, ua fal përmes pendimit, por kujt Ai dëshiron ia fal edhe pa pendesë. Përndryshe, nuk kuptohet se Allahu ua fal njerëzve çdo lloj gjynahu.”

Sipas asaj çfarë transmetohet, një ditë, **Ibni Mesudi** kishte hyrë në mesxhid. Vaizi i xhamisë po fliste mbi zjarrin e xhehenemit, zinxhirët dhe prangat. Ibn Mesudi nuk rezistoi dot dhe i tha: “Përse po i

drejton njerëzit drejt pashpresës?” dhe pastaj shtoi këto fjalë: “A nuk e ke lexuar ajetin: **O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut..!?”**

Këtu mbi të gjitha, duam të theksojmë këtë: shpallja e ajetit kuranor lidhur me një çështje të caktuar, nuk përbën pengesë që gjykimi i tij të jetë i përgjithshëm. Pasi, thuajse në të gjithë librat e komentimit të Kuranit Famëlartë (tefsir) bëhet e ditur se ky ajet bën fjalë për faljen dhe mëshirën që përfshin të gjithë ata që i kanë bërë keq vetes duke bërë gjynah.

Ajeti kuranor në fjalë është ajeti më shpresdhënës i Kuranit Famëlartë. Kësisoj, bëhet e ditur gjëresia e mëshirës hyjnore dhe madhështia e faljes së Zotit të Madhëruar ndaj të gjithë njerëzve që bëjnë pjesë brenda rrezes së Islamit. Kur shohim ajetet që janë në vijim, vërejmë se ekzistojnë dy kushte të rëndësishme, në mënyrë që të mos heqim shpresën nga mëshira e Allahut. **E para:** kthimi nga Zoti, para se të vijë dënimi dhe dorëzimi në plot kuptimin e fjalës tek Allahu; të tregohesh i kujdesshëm duke zbatuar urdhrat e Allahut dhe duke u ruajtur nga ndalesat e Tij. Përndryshe, duhet të jemi të vetëdijshtë që nuk na vjen ndihma prej Tij. **E dyta:** të ndjekim me rigorozitet Fjalën më të Bukur (gjykimin e Kuranit) para se të përplasemi me fatkeqësitë. Të praktikohen me përpikëri dhe tërësisht çështjet që përmenden aty.

Ata që nuk ndjekin këto dy kushte, janë ata që nuk hyjnë në rrezën e besimit, ngaqë ndjekin arrogancën dhe mendjemadhësinë. Janë ata që këmbëngulin që të rrinë në batakun e gjynaheve. Janë ata që nuk i drejtohen derës së pendimit. Pikërisht ata janë njerëzit që i kundërvihen ajetit kuranor në fjalë dhe që nuk do t'i përfshijë mëshira hyjnore. Pasi edhe në ajetet në vijim u përmendet shembulli i tyre fatkeq. Në Ditën e Kiametit përmendet se do të thonë të penduar: “*Sa keq për mua që kundërshtova Allahun! Vërtet unë jam prej atyre që kam nënçmuar Fjalën Hyjnore!*” Si dhe: “*Ah sikur të kisha edhe një herë mundësi të rikthehesha dhe të bëhesha prej të mirëve!*” Ndërkohë që nuk do të vlerësohen përgjërimet e tyre të penduara atë ditë dhe do t'u thuhet: “*Ajetet tona erdhën për ty, por ti i përgënjeshtrove, u solle si arrogant dhe u bërë prej mohuesve.*” Si dhe: “*Allahu bën që të shpëtojnë ata që kanë devotshmëri (takva). Ato nuk i shqetëson asgjë e ligë. Ata nuk kanë pse të mërziten...*”

Si përfundim, kushtet për të qenë njeri që shpreson janë të pakta dhe të përmbledhura. Rruga që shkon drejt mëshirës hyjnore është e drejtë dhe e qartë. Për të qenë njerëz që shpresojmë dhe shpresdhënës kemi shumë arsye; përveç pengesave që ofron nefsia nuk kemi tjetër pengesë. Dyert e pendesës janë të hapura deri në çastin e fundit, deri atëherë kur nuk pranohen më. Mjafton që ne të përpiqemi, të ecim, të përgjrohemi.

## Lexo Mendo

# SHËRIMI I SËMUNDJEVE TË ZEMRËS

Në suren Kamer, thuhet: “**Vërtet, Ne e kemi bërë Kuranin të lehtë për t'u kuptuar dhe kujtuar, prandaj, a ka ndonjë që të marrë këshillë?!?**” (54/17). Kurse në suren Isra, jepet ky sihariq: “**Ne shpallim nga Kurani atë që është shërim dhe mëshirë për besimtarët e që mohuesve keqbërës u shton vetëm humbje.**” (17/82)

Ne e dimë që Kurani Famëlartë është dhuntia më e madhe që ofron mundësinë e komunikimit të Allahut me njeriun. Është dhikri, që hap dyert e meditimit. Është çelësi i lumturisë së dy botëve. Të lexosh, të dëgjosh dhe të shohësh me *ihlas* Fjalën Hyjnore është ibadet. Pasi, leximi shëron sëmundje shpirtërore si arrogancën dhe dyfytërsinë. Dhe bën që të gjallërohen thellësitë e zemrës. E hap zemrën pranë përshpirtshmërisë së Krijuesit të Lartë. Ndaj dhe ajeti “**Prandaj, më kujtoni Mua (me namaz e lutje) që Unë t'ju kujtoj (me shpërblime)...**” (Bekara, 152), është një shenjë e sakinitit që do të kri-



johet në rast kur kujtohet Ai...

Sipas asaj që përmendet në tefsir, lëngata më e madhe është pikërisht të mos bësh këtë dhikër; ashtu sikurse bëhet e ditur edhe në ajetin “**Ata e kanë harruar Allahun, por edhe Ai i ka harruar ata.**” (Teube, 67), është të jesh gafili që përmendet. Kështu që, nuk duhet treguar të shkujdesur ndaj ushqimit që duhet të marrë zemra, që mos ta kaplojnë sëmundjet *batini*. Le të mos prishet natyrshmëria, për arsye të harresës që bëjmë për Allahun. Butësia dhe shëndeti të mos shndërrohen në vrazhdësi dhe ashpërsi. Që të mos shndërrohen modestia në arrogancë, përshtatshmëria në papërshtatshmëri, bashkimi në ndarje, dashuria në armiqësi, etj.

Meqë arsyeja kryesore e sëmundjeve të zemrës është mungesa e dhikrit dhe mosmirënjohja ndaj Zotit, a mund të shërohet atëherë pa u diagnostikuar siç duhet? Ai që nuk e di saktësisht shqetësimin që ka, a mund ta kërkojë siç duhet shërimin e tij?!



# NDJENJAT DHE SJELLJET HELMUESE

që prishin miqësinë dhe dashurinë

— Mesut Kaja —

Mund të thuhet se morali i besimtarit është ngjyra e natyrshme e paprishur e njeriut. Kjo ngjyrë është një ngjyrë hyjnore dhe është e pamundur të imagjinosh diçka më të bukur se ajo.<sup>1</sup>

Thelbi i fesë përbëhet prej besimit, Islamit dhe ihsanit (mirësisë).<sup>2</sup> Këto e ruajnë, e pastrojnë dhe e plotësojnë në mënyrë të shëndetshme natyrën e pastër njerëzore për të cilën po flasim. Kjo është një rrugë hyjnore dhe profetike, që i jep njeriut nderin dhe dinjitetin që meriton. Kjo rrugë është rruga e paqes dhe e shpëtimit, që e çon njeriun në dashurinë dhe miqësinë me veten e tij, me gjininë e tij me të cilët ndan të njëjtat ndjenja dhe me të gjitha krijesat e tjera.

Nisur nga kjo, besimi është një eliksir hyjnor, që përveç armiqve të Allahut, i lidh të gjitha krijesat me njëra-tjetrën, i miqëson dhe i vëllazëron ato. Çdo gjë që e prish këtë atmosferë të bukur, që duhet arritur e përjetuar, çfarëdo qoftë apo çfarëdo forme pastë ajo, është rezultat i dobësimit të besimit.

Për të mos e humbur kapitalin e kësaj miqësie, dashurie e vëllazërie që u është falur zemrave në sajë të besimit, më parë duhet

ta ruajmë kapitalin ekzistent prej elementeve të dëmshëm. Burimi i elementeve të dëmshëm për të cilët bëhet fjalë, janë tundimet, ndjenjat dhe sjelljet egoiste e djallëzore. Ndërsa mjeti i kësaj atmosfere negative dhe helmuese që formohet, në të shumtën e rasteve, është gjuha, dora dhe zemra së cilës i ka humbur pastërtia.

Allahu i Madhëruar dhe i Dërguari i Tij (a.s.), na kanë lajmëruar në mënyrë shumë të qartë se në ç'formë e shkaktojnë prishjen këto mjete:

E para, është helmi i gjuhës fyese, lënduese, ndarëse dhe prishëse e marrëdhënieve: Plaga që shkakton gjuha, është në krye të plagëve më të thella. Një fjalë e urtë thotë: *“Plaga e shpatës shërohet, por plaga e gjuhës nuk shërohet”*. Kjo, sepse ndërkohë që njëra lëndon pjesën e jashtme të trupit, tjetra lëndon zemrën dhe esencën e njeriut. Kjo formë lëndimi, ndonjëherë rrjedh prej përmbajtjes së fjalës e ndonjëherë prej mënyrës se si thuhet. Për shembull; gënjeshtër në marrëdhëniet njerëzore është një lloj helmi që mbjell farat e pasigurisë dhe mosbesimit. Shpifja është një vrasëse që merr nëpër këmbë dinjitetin njerëzor dhe e dënon me vdekje njeriun për aq kohë sa është gjallë. Ndërsa përgojimi është operacioni i përluljes së njeriut tek të tjerët, duke e turpëruar dhe poshtëruar atë. Fyerja, fjala e keqe, nofka e keqe, shprehjet lënduese dhe sjellje të tjera të ngjashme, janë elementet djallëzore të një gjuhe të paedukuar që prishin marrëdhëniet e shëndetshme.

Një lloj tjetër i helmit të gjuhës, i cili është po aq lëndues sa edhe përmbajtja e fjalës, është mënyra e thënies së fjalës. Energjia negative që bartin fjalët e papërshtatshme që përdoren në një fjali, i ngrin ndjenjat e ngrohta dhe i shuan marrëdhëniet. Mbase ajo që thuhet është e drejtë, por mënyra se si thuhet është lënduese dhe shkatërruese.

Zoti yni i Madhëruar i paralajmëron vazhdimisht robërit e Tij në lidhje me këtë çështje dhe urdhëron që, *“bashkëbiseduesit t'i drejtohem në një mënyrë që shpreh respekt”*<sup>3</sup>, *“jo duke e këshilluar në mënyrë të ashpër, por në mënyrë të butë si mëndafshi që t'i prekë zemrën”*<sup>4</sup>, *“jo duke i bërtitur me zë të lartë si të gomarit, por duke ia treguar me ton të ulët aq sa mund ta dëgjojë”*<sup>5</sup>. Përveç kësaj, Allahu i fton robërit e tij të jenë të mirësjellshëm, duke thënë:

*“(O i Dërguar!) Thuaju, robërve të Mi, që të flasim atë që është më e mira. Në të vërtetë, djalli mbjell ngatërresa ndërmjet tyre. Vërtet, djalli është armik i hapët i njeriut.”* (Isra, 53) Në këtë ajet na tërheqin vëmendjen këto dy çështje: e para; të përiqesh gjithmonë të gjesh fjalën më të bukur, sepse një fjalë e cila është e bukur për dikë, mund të jetë e shëmtuar dhe e ashpër për dikë tjetër. Pra, çdo njeri e ka për detyrë ta zhvillojë vazhdimisht veten për të gjetur fjalët më të bukura brenda vetes. Ndërsa çështja e dytë është fakti se duke u nisur prej një fjale të thënë, forcat e dukshme dhe të padukshme, mund të mbjellin farat e përçarjes dhe armiqësisë ndër besimtarët.

Elementi i dytë, që i çon dëm marrëdhëniet dhe e kthen miqësinë në armiqësi, është ajo që bëjmë me dorën, trupin apo me forcën tonë. Për shembull, padrejtësia është një helm i tillë. Përçmimi i njëri-tjetri duke e tallur me lëvizje syri a dore, është një helm i tillë. Të gjitha veprimet që bëhen për të shkaktuar shkatërrime në tokë, janë të tilla. Kështu është edhe sëmundja e spiunimit për të nxjerrë në shesh të metat e të tjerëve. Kështu është edhe kur një grup garon me një grup tjetër për të poshtëruar e turpëruar njëri-tjetrin. Ka edhe shumë sjellje e veprime të ngjashme, të cila nuk i kanë hije besimtarit dhe që janë si viruse që na turpërojnë ne si myslimanë. Rasulullahu (a.s.), në lidhje me këtë çështje ka thënë:

*“Mysliman është ai, nga dora dhe gjuha e të cilit janë të sigurtë myslimanët e tjerë.”*<sup>6</sup>

Ndërsa elementi i tretë që e njollos dhe e cenon moralin e vëllazërisë, është prishja e moralit të zemrës. Një sëmundje e tillë është edhe konsiderimi i vetes më lart se vëllai yt besimtar. Kështu është edhe

përcaktimi i kriterëve të epërsisë në bazë të racës, fisit, grupit, medhhebit apo statusit shoqëror. Kështu është edhe ushqimi i urrejtjes dhe armiqësisë në zemër ndaj besimtarëve të tjerë -për çfarëdolloj shkak qoftë-. Në të njëjtën mënyrë, edhe kaplimi nga ndjenja e smirës është po aq lënduese. Ndjenja e armiqësisë që hyri midis Kabilit dhe Habilit, Jusufit (a.s.) dhe vëllezërve të tij, ishte për shkak të ndjenjës së smirës.

Të mendosh keq ndaj vëllezërve për shkak të hamendjeve të cilat nuk mbështeten në asnjë argument të prerë, është një nga sëmundjet që copëton marrëdhëniet e zemrës. Madje, mund të thuhet se, burimi i energjisë negative të veprimeve shkatërruese që bëjmë me dorën dhe gjuhën tonë, në shumicën e rasteve është egoja dhe zemra jonë e papastruar dhe e parafinuar.

Si përfundim, sëmundja që copëton lidhjet, shkatërron miqësinë dhe e kthen atë në armiqësi, është brenda nesh dhe në veten tonë. Nëse duam që morali i besimtarit të shfaqet në dorën, gjuhën dhe zemrën tonë, është e domosdoshme që besimi ynë të ndikojë në zemrën, gjuhën, dorën dhe në të gjitha qelizat tona. Nëse e shkrijmë egon tonë në enën e besimit -përveç armiqve të Allahut-, e gjithë bota do të miqësohet me ne.

#### Referencat:

1. shih. el-Bekare, 138. 2.-Ndërkohë që forma e besimit rregullon botëkuptimin ndaj Zotit, Islami disiplinon adhurimin, marrëdhëniet dhe çështjet e tjera në lidhje me jetën. Ndërsa ihsani ndërton anën e ndjenjave dhe moralin e njeriut. 3. shih. el-Isra, 17/23. 4. shih. Ta-Ha, 20/44. 5. shih. Lukman, 31/19. 6. Buhari, Iman 4-5, Rikak 26; Muslim, Iman 64-65.

**Sëmundja që copëton lidhjet, shkatërron miqësinë dhe e kthen atë në armiqësi, është brenda nesh dhe në veten tonë. Nëse duam që morali i besimtarit të shfaqet në dorën, gjuhën dhe zemrën tonë, është e domosdoshme që besimi ynë të ndikojë në zemrën, gjuhën, dorën dhe në të gjitha qelizat tona. Nëse e shkrijmë egon tonë në enën e besimit -përveç armiqve të Allahut-**







# Morali i Lartë ËSHTË PJEKURI BESIMI

— Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan —

Morali është një koncept që ndër të gjitha krijesat, i intereson vetëm njeriut. Ndërsa në Islam është një nga pjesët kryesore të fesë. Vetë Pejgamberi ynë (a.s.), na ka bërë të ditur se: *“Ai është dërguar për të plotësuar moralin e larta.”*<sup>1</sup> Ndërsa në Librin hyjnor, Pejgamberi ynë (a.s.), është prezantuar si *“njeriu me moralin më të lartë”*<sup>2</sup>.

Në librat e haditheve ka me qindra hadithe të radhitura nën kapitullin e “moralit”, të cilat na tregojnë dhe na mësojnë mirësitë e moralit. Një nga këta hadithe, është edhe ai që kemi përmendur në fillim të shkrimit tonë. Sipas një transmetimi të Ebu Hurejres (r.a.), Rasullullahu (a.s.), ka thënë: *“Myslimani me pjekurinë më të madhe të besimit, është ai që ka moralin më të lartë.”*<sup>3</sup>

Siç shihet, ky hadith e cilëson karakterin e bukur dhe moralin e lartë, si treguesin e pjekurisë së besimit. Ndërsa në disa hadithe të tjerë, zënë vend shprehjet: *“Më i miri prej jush është ai me moralin*

*më të lartë”*. Pra, morali i lartë është treguesi i njeriut të mirë. Kriteret që vendosin të dy grupet e haditheve, janë të njëjta: Pjekuria e besimit në fe varet nga epërsia dhe bukuria e moralit.

## SJELLJA DHE JETA MORALE

Kur marrëdhënia moral-besim bëhet e pandashme, padyshim që edhe sjellja dhe jeta morale do të jenë në përputhje me Islamin, pra me Kuranin Fisnik dhe Sunetin e Pejgamberit (a.s.). Çdo sjellje që është në kundërshtim me këto dy burime, është jashtë normës së moralit. Pra, sipas nesh, burimi i moralit është feja. Burimi dhe kriteri i vetëm i moralit islam, është vetë Islami. Dhe, myslimani me moral të lartë, është ai që jeton me moralin islam. Nëse do të organizohej një garë për të zgjedhur “myslimanin më të mirë”, ajo do të përfundonte me gjetjen e myslimanit me moralin më të mirë.

## MORALI ISLAM

Përkufizimi më i shkurtër dhe më i përmbledhur i moralit islam, është: “et-Ta’dhim li emri’l-lah, ue’shefakatu ala halki’l-lah / Respekt e madhërim i urdhrave të Allahut dhe mëshirë ndaj krijesave

1. shih. Muuatta, Husnu’l-hulk 8.

2. shih. el-Kalem, 68/4.

3. Darimi, Rikak 74; shih. Buhari, Edeb 38, 39; Ebu Daud, Sunnet 14; Tirmidhi, Rada’ il, Iman 6; Ahmed b. Hanbel, Musned, II. 250, 472, 527; V, 99; VI, 47, 99.

të Tij”. Ky përkufizim është aq përfshirës, sa përmbledh çdo detaj të moralit individual e shoqëror dhe çdo sjellje tjetër morale. Origjinalin e këtij përkufizimi e gjejmë në Kuranin Fisnik, në ajetin: **“Ata që thonë, «Zoti ynë është Allahu», e pastaj vazhdojnë të vendosur në rrugën e drejtë...”**<sup>4</sup> dhe në përgjigjen që Pejgamberi ynë (a.s.), i dha sahabiut, i cili i tha: “Ma shpjego Islamin në mënyrë të tillë, që të mos kem nevojë të pyes dikë tjetër”. Përgjigja e Pejgamberit (a.s.), ishte: **“Thuaj! Zoti im është Allahu, pastaj bëhu i drejtë!”**<sup>5</sup>

Respektimi i urdhrave të Allahut është kreu i të gjitha punëve dhe sjelljeve të mira morale. Nëse ai që nuk ndjen respekt të thellë ndaj Krijuesit të vetëm, Allahut, i Cili di çdo gjë të fshehtë e të hapët dhe, që nuk i përkushtohet në devotshmëri vetëm Atij, çfarë tjetër do të arrijë të respektojë në mënyrë serioze? Kush mund të japë garanci se ai që nuk respekton urdhrat e Allahut, mund të tregojë respekt ndaj vlerave njerëzore?

Allahu i Madhëruar, thotë: **“...Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij...”**<sup>6</sup> Po ashtu, kënaqësinë e Allahut, të cilën Ai Vetë e ka përkufizuar si **“shpërblimin më të madh”**<sup>7</sup>, mund ta arrijnë vetëm ata që tregojnë respektin e duhur ndaj Tij.

Frikë-respekti ndaj urdhrave të Allahut, është parimi rregullator i sjelljeve të individit dhe kriter i moralit. Pra, burimi i të gjitha virtyeteve, është respekti ndaj Allahut. Nëse i analizojmë një nga një të gjitha cilësitë dhe virtytet e bukura, si urtësia, trimëria, ndershmëria, drejtësia, bujaria, modestia dhe durimi, do të shohim se të gjitha mbështeten në respektin ndaj urdhrave të Allahut. Jo më kot kanë thënë: **“Burimi i çdo të mire, është frika ndaj Allahut”**<sup>8</sup> Po ashtu, edhe poeti i madh Mehmed Akif Ersoj, Allahu e mëshiroftë, virtytet njerëzore i lidh me frikën ndaj Allahut:

4. shih. Fussilet, 41/30; el-Ahkaf, 46/13.

5. Muslim, Iman 62; Ahmed b. Hanbel, Musned, III, 413; IV, 385, Gjithashtu, shih. Tirmidhi, Zuhd 61; Ibn Maxhe, Fiten 12; Darimi, Rikak 4; Mukaddime 19.

6. el-Huxhurat, 49/13.

7. shih. et-Teube, 9/72.

8. shih. Axhluni, Keshfu'l-hafa, I, 421, Nr: 1350.

As dija nuk jep moral të lartë dhe as ndërgjegjja;

Virtytet e njeriut prej frikës nga Allahu janë.

Ta zëmë se prej zemrave frika nga Zoti ka ikur,

As dija nuk ndikon më dhe as ndërgjegjja.<sup>9</sup>

Kjo, do të thotë se kushti i parë për t'u bërë një mysliman i pjekur me moral të lartë, është të tregosh një respekt të thellë ndaj urdhrave të Allahut në çdo fushë të jetës dhe t'i mbash ato më lart se çdo gjë tjetër.

## MËSHIRË NDAJ KRIJESAVE

Parimi **“mëshirë ndaj krijesave”**, që është edhe themeli i dytë i moralit islam, përfshin sjelljet që duhen shfaqur në çdo lloj marrëdhënieje njerëzore, që prej moralit familjar e shoqëror, deri tek morali i punës e i tregtisë; madje edhe sjelljet ndaj kafshëve dhe natyrës. Kjo, sepse çdo gjë e ka krijuar Allahu i Madhëruar.

Mëshira, e detyron njeriun në një sjellje me dy drejtime. Së pari, e motivon të bëjë detyrën e tij pa mangësi dhe në mënyrën më të mirë. Më pas, e urdhëron të mos i bëjë dëm asnjë krijese në mënyrë të vetëdijshme dhe të mos mashtrojë, sepse kjo është domosdoshmëria e dhembshurisë dhe mëshirës.

Është shumë e qartë se në themel të çdo sjelljeje dhe veprë morale, që prej mosdëmtimit të asnjë krijese në mënyrë të vetëdijshme e deri tek dhënia përparësi e të tjerëve ndaj vetes, qëndron ndjenja e mëshirës, e mbështetur në besim.

Njerëzit që nuk zotërojnë asnjë pjesë prej mëshirës dhe dhembshurisë, nuk mendojnë gjë tjetër përveç egoizmit, koprracisë dhe interesave të dëshirave të tyre. Argumenti më i fortë i kësaj, është tabloja e të uriturve dhe të ngopurve në botën tonë dhe çekuilibrimi shokues i shoqërisë ndërmjet vendeve ose kontinenteve.

Nuk duhet harruar se virtytet, si dhembshuria, mëshira, butësia, mirëkuptimi, dashuria dhe mirësjellja, në mënyrën më të plotë, i gjen tek pejga-

9. Safahat, fq. 267.

Mëshira,  
e detyron njeriun  
në një sjellje me dy  
drejtime. Së pari, e  
motivon të bëjë detyrën  
e tij pa mangësi dhe në  
mënyrën më të mirë.  
Më pas, e urdhëron të  
mos i bëjë dëm asnjë  
krijese në mënyrë të  
vetëdijshme dhe të mos  
mashtrojë, sepse kjo  
është domosdoshmëria  
e dhembshurisë dhe  
mëshirës.



mberët, të cilët i thërrasin njerëzit në rrugën dhe kënaqësinë e Allahut. Nuk është parë kurrë që një pejgamber të ketë mangësi në dhembshuri e mëshirë apo të jetë sjellë në atë mënyrë. Në fakt, nuk ka asnjë rrugë tjetër për të fituar zemrat e njerëzve, përveç dhembshurisë dhe mëshirës.

Ne jemi umeti i Pejgamberit Muhamed (a.s.), i cili ishte *“mëshirë për botët”*<sup>10</sup>, që i vinte *“rëndë për vuajtjet tona”*<sup>11</sup>, që është *“një shembull i mrekullueshëm”*<sup>12</sup> dhe *“zotëronte moralin më të bukur”*<sup>13</sup>. Për rrjedhojë, çfarë mund të jetë më e natyrshme dhe më e drejtë se t’u dalim zot këtyre virtyteve të larta, sipas mundësisë që kemi?

T’i dalim zot “moralit Muhamedan”, do të thotë të jetojmë Kuranin, sepse nëna jonë Aishe (r.a.), ka thënë se, *“Moralin e jetës së Pejgamberit, ishte formuar prej Kuranit”*.<sup>14</sup> Pra, domethënë se mysliman i pjekur është ai që zotëron moral të lartë. Mirësia e të pamoralshmit, goftë ai edhe mysliman, është një gënjeshtër e madhe.

## REZULTATI I BUKURI I MORALIT TË BUKUR

Sipas një transmetimi të Ebu Hurejres (r.a.): Njerëzit e kanë pyetur Rasulullahun (a.s.), se, cila është ajo gjë që i fut më së shumti njerëzit në xhenet? Dhe ai është përgjigjur: *“Frikë-respekti (devotshmëria) ndaj Allahut dhe morali i mirë!”*<sup>15</sup>

Sahabët fisnikë, të cilët e ndjenin dhe e jetonin thellë përgjegjësinë dhe vetëdijen e vlerësimit të kësaj bote dhe botës tjetër si një të vetme, nga pyetjet që i bënin Pejgamberit tonë (a.s.), morën njohuri edhe për veten e tyre, por përgatitën edhe përgjigjet që do t’u shuanin kureshtjen dhe do t’u plotësonin nevojat myslimanëve që do të vinin më pas. Allahu goftë i kënaqur me ta.

10. el-Enbija, 21/107.

11. et-Teube, 9/128.

12. el-Ahzab, 33/21.

13. el-Kalem, 68/4.

14. Muslim, Musafirin, 139.

15. Ibn Maxhe, Zuhd 29; Ahmed b. Hanbel, Musned, II,392,442; Ram - hurmuzi, Kitabu'l-emsal, fq. 158; Hakim, el-Mustedrek, IV,324, Hakimi, thotë se: “Ky hadith është sahih, por Buhariu dhe Muslimi nuk e kanë futur në librat e tyre”. Po ashtu, edhe Dhehebiu është i mendimit se ky hadith është sahih. Në vazhdim të hadithit, thuhet: “Njerëzit e pyetën përsëri Rasulullahun (a.s.), se cila është ajo gjë që i fut më tepër njerëzit në xhehenem? Dhe ai është përgjigjur: *“Dy brima; goja dhe organi i riprodhimit”*.”

Pyetja në këtë hadith të fundit: “Cila është ajo gjë që i fut më së shumti njerëzit në xhenet?”, është një pyetje e vetme, por përgjigjet që mund t’i jepen janë më shumë se një. Kjo, sepse i njëjti rezultat mund të arrihet me shumë gjëra. Por ajo që kërkohet këtu, është puna, vepra, qëndrimi apo sjellja që të çon “më shumë”, “më shpejt” ose “më shkurt” në të njëjtin rezultat. Dhe Pejgamberi ynë (a.s.), këtyre pyetjeve u ka dhënë gjithmonë përgjigjen më përfshirëse. Për rrjedhojë, edhe në këtë rast ka dhënë një përgjigje të përbërë prej dy fjalish të shkurtra: *“Frikë-respekti (devotshmëria) ndaj Allahut dhe morali i mirë!”*.

Termi “takua”, i cili në përgjithësi kuptohet “frikë nga Allahu”, në të njëjtën kohë kuptohet edhe si “vetëdije ndaj përgjegjësisë” dhe shpreh gjendjen e përhershme të vigjilencës dhe disiplinës. Ata që janë të vetëdijshëm se jetojnë vazhdimisht nën kontrollin dhe vëzhgimin hyjnor, e dinë shumë mirë se nuk kanë një jetë private përpara Allahut. Pejgamberi ynë (a.s.), në një hadith fisnik, thotë: *“Trego respekt ndaj Allahut kudo që të jesh!”*<sup>16</sup> Ndërsa në një hadith tjetër, thotë: *“Besimi më i mirë, është të dish se Allahu është me ty kudo që të jesh”*<sup>17</sup>.

Nga ana tjetër, e bukura dëshiron të bukurën. Xheneti është i bukur dhe vendi i bukurive. Atje do të shkojnë vetëm ata që kanë moral të bukur. Njerëzit e mirë dhe me moral të bukur, formojnë përreth tyre një atmosferë xheneti që në këtë botë. Mirëpo, “të jesh me moral të bukur”, ka një kriter të caktuar. Në Islam, burimi i bukurisë dhe i mirësisë është shpallja hyjnore. Morali i bukur, asnjëherë nuk do të thotë që çdo gjë ta konsiderosh të mirë. Njerëzit me moral të bukur që kanë kriteret dhe dinë të bëjnë dallimin midis të bukurës dhe të shëmtuarës, të mirës dhe të keqes dhe, të cilët përpiqen që ky dallim të bëhet edhe nga pjesa tjetër e shoqërisë, padyshim se janë kandidatë për në xhenet.

Ky pra është edhe rezultati më i bukur e për t’u pasur zili, i bukurisë morale dhe pjekurisë së besimit që e bën njeriun të lumtur edhe në botën tjetër.

16. Tirmidhi, Birr 55.

17. Hejthem, Mexhmeu'z-Zeuaid, I, 60.



# Ruani pasardhësit tuaj prej zjarrit

— Prof. dr. Omer Çelik —

**e syve tanë dhe bëna shembull për të mirët!”<sup>4</sup>**

Nisur nga kjo, mund të themi se nuk mjafton që njeriu të përpiqet të shpëtojë vetëm veten e tij prej dënimit të Allahut. Por, në të njëjtën kohë, ai ka për detyrë t’i edukojë familjarët e vet, në mënyrë që ata të bëhen robër të dashur të Allahut. Ai nuk duhet të mendojë vetëm për ushqimin, pijen, strehimin, paqen dhe rehatinë e tyre në këtë botë, por edhe për shpëtimin e tyre në botën tjetër, me qëllim që të mos bëhen lëndë e zjarrit të xhehenemit. Në lidhje me këtë çështje, ky ajet fisnik ka cilësinë e një paralajmërimi serioz:

**“O ju që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët...”** (Tahrim, 6)

Ndërsa Rasulullahu (a.s.), ka thënë: “Të gjithë jeni çobanë dhe të gjithë jeni përgjegjës për tufën tuaj (ata që keni nën vete). ...Burri është çobani i familjes së tij dhe është përgjegjës për tufën e tij. Gruaja, është çobane në shtëpinë e burrit të saj dhe po ashtu është përgjegjëse për tufën e saj...” (Buhari, Ahkam 1; Muslim, Imaret 20)

Kur zbriti ajeti i gjashtë i sures et-Tahrim, sahabët fisnikë pyetën:

“O Rasulullah! Vetën tonë mund ta ruajmë nga zjarri, po familjen tonë si ta ruajmë?” Rasulullahu (a.s.), u përgjigj: “Urdhërojini ata të bëhen robër të Allahut, të jenë të bindur dhe të kryejnë adhurimet. Pengojini ata nga mosbindja ndaj Allahut dhe bërsa e gjynaheve. Ja pra, kjo do të thotë t’i ruash ata.” (Alusi, XXVIII, 156.)

Transmetohet se Pejgamberët gjithmonë kanë jetuar me shqetësimin për brezat e rinj dhe gjithmonë i janë lutur Allahut në lidhje me këtë çështje. Për shembull, Ibrahim (a.s.), është lutur me këto fjalë: “O Zoti ynë! Na bëj të përlur ndaj Teje! Bëj që edhe pasardhësit tanë të jenë të përlur ndaj Teje!..”<sup>1</sup>; “O Zoti im, bëj që unë dhe pasardhësit e mi të kryejmë përherë namazin!..”<sup>2</sup> Zekerija (a.s.), ka thënë: “(O Zot!) ...më dhuro nga ana Jote një pasardhës, që të më trashëgojë mua dhe familjen e Jakubit. O Zoti im! Bëje atë të pëlqyeshëm (për Ty)!”<sup>3</sup>

Ndërsa Allahu i Madhëruar, i ka këshilluar myslimanët të kujdesen seriozisht për brezat e tyre dhe të luten në këtë mënyrë: “O Zoti ynë! Na dhuro prej grave dhe trashëgimtarëve, të cilët do të jenë drita

1. Bekare, 128.

2. Ibrahim, 40.

3. Merjem, 5-6.

4. Furkan, 74.



Prindërit duhet të tregojnë shumë kujdes në edukimin e fëmijëve. Prandaj, nëse e trajtojmë edukimin që duhet të marrë fëmija brenda familjes, duke i shpjeguar në periudha të lidhura me njëra-tjetrën, mbase prindërit do të vetëdijesohen më tepër në lidhje me përgjegjësitë e tyre në këtë çështje dhe do të përipiqen të bëjnë atë që duhet:

## 1. EDUKIMI NË LIDHJE ME BESIMIN

Themeli i kësaj çështjeje, është besimi i fortë në përputhje me Islamin. Pra, të besosh gjithçka që duhet besuar në mënyrën më të mirë; të pranosh ekzistencën e tyre dhe të bësh atë që duhet. Kur një fëmijë prej bijve të Abdulmutalibit fillonte të fliste, Rasulullahu (a.s.), i mësonte ajetin 111 të sures el-Isra, duke ia lexuar atë shtatë herë: **Thua: “Çdo lavd e falënderim i përket Allahut, i Cili nuk ka bir, nuk ka ortak në pushtet dhe nuk është i pa-fuqishëm, që të ketë nevojë për ndihmës” dhe madhëroje Atë, duke ngritur lart madhështinë Tj!**” (Abdurrezzak, IV, 334; Ibn-i Ebi Shejbe, I, 348.)

Në një hadith fisnik, Rasulullahu (a.s.), ka thënë: *“Mësojini fëmijët tuaj që fjala e tyre e parë të jetë «La ilahe il-lallah!»*” (Bejhaki, Shuabu’l-iman, VI, 398.)

Shkurtimisht, në çdo vend dhe kohë, qoftë gjatë ushqimit e kudo tjetër, fëmijëve tanë duhet t’u flasim për madhështinë e Allahut të Madhëruar, për faktin se Ai është krijuesi i gjithësisë, i ajrit që thithim, i diellit dhe i shumë mirësive të tjera si ushqimet, pijet etj., duke i ndihmuar ata, që në zemrat e tyre të zërë vend një besim i fortë në Allahun e Madhëruar. Gjithashtu, duhet t’u mësojmë atyre se Rasulullahu (a.s.), është një peygamber i Zotit dhe për këtë arsye, Zotin tonë dhe Peygamberin e Tij, duhet t’i duam me gjithë shpirt dhe më shumë se çdo gjë tjetër. Kjo, sepse prej një zemre që e do Allahun dhe Peygamberin, nuk mund të pritët asgjë tjetër përveç mirësisë.

## 2. EDUKIMI NË LIDHJE ME ADHURIMIN

Një edukim i mirë në besim, ndiqet nga një edukim i mirë në adhurim. Allahu i Madhëruar, duke theksuar faktin se edukimi i fëmijëve me namaz është një çështje shumë e rëndësishme, thotë se, në mënyrë të veçantë namazit, duhet t’i jepet një rëndësi më e madhe nga ana e individit, familjes dhe shoqërisë në tërësi: **“Urdhëroje familjen tënde që të falë namazin dhe këmbëngul për këtë! Ne nuk të kërkojmë ty ndonjë furnizim, por jemi Ne që të furnizojmë!..”** (Ta-Ha, 132)

Pas zbritjes së këtij ajeti, Rasulullahu (a.s.), shkoi në shtëpinë e vajzës së tij Fatma (r.a.) dhe urdhëroi:

*“Ejani në namaz!”*. Dhe këtë e vazhdoi me muaj të tërë. (shih. Buhari, Tehexhud 5; Muslim, Misafirin 206.)

Rasulullahu (a.s.), ka thënë: *“Urdhërojini fëmijët tuaj të falin namaz kur të jenë shtatë vjeç dhe rrihini (lehtë), nëse nuk e falin kur të bëhen dhjetë vjeç. Po ashtu, ndajini krevatet e tyre (djemtë nga vajzat).”* (Ebu Daud, Salat 26.)

Rasulullahu (a.s.), i jepte rëndësi të madhe edukimit të fëmijëve me Kuranin Fisnik dhe për këtë ka thënë: *“Kush ia mëson fëmijës së tij leximin e Kuranit, i falen gjyrahët e kaluara dhe të ardhme. Dhe kush ia mëson fëmijës Kuranin përmendsh, në Ditën e Kiametit, Allahu do ta ringjallë atë si hënë e plotë dhe fëmijës së tij do t’i thuhet: «Lexo!»*. Për çdo ajet që ai lexon, Allahu do ta ngrejë një gradë babain e tij. Kjo vazhdon kështu derisa të mbarojnë ajetet e Kuranit që fëmija di përmendsh.” (Hejthemi, VII, 165-166.)

## 3. EDUKIMI NË LIDHJE ME RUAJTJEN NGA GJYNAHET

Njëherë, kur Rasulullahu (a.s.), po e këshillonte Aishen (r.a.), të ruhej prej gjynaheve, përdori këto shprehje: *“O Aishe! Ruhu prej punëve (gjynaheve më të vogla) që nënvleftësohen! Sepse tek Allahu gjendet dikush (një melek) që i vëzhgon dhe i shënon ato.”* (Ibn-i Maxhe, Zuhd, 29; Darimi, Rikak, 17.)

## 4. EDUKIMI NË LIDHJE ME DHURIMIN

Ashtu siç i edukojmë fëmijët me namaz që në moshë të vogël, ashtu duhet t’i edukojmë ata që të japin, të ndihmojnë nevojtarët dhe të sakrifikojnë prej mundësive që kanë. Vogëlushët tanë duhet të shijojnë që në moshë të vogël kënaqësinë që të jep ndihma ndaj të tjerëve dhe marrja e duasë së tyre. Ata duhet ta dëshirojnë këtë kënaqësi shpirtërore më tepër se një ushqim të shijshëm dhe duhet ta përjetojnë paqen shpirtërore që të jep dua ja e nevojtarit. Nëse fëmijët tanë rriten të privuar nga këto kënaqësi shpirtërore, kur të rriten do të jetë më e vështirë ta marrin këtë edukim. Kuptimi dhe të jetuarit e Islamit do të jetë më i vështirë për ta. Nisur nga kjo, njerëzit e mirë dhe dijetarët e vërtetë, ashtu siç i edukojnë fëmijët e tyre që në vogëli me besim dhe namaz, i mësojnë ata edhe të japin e të dhurojnë. Ata i mësojnë vogëlushët e tyre me zemra të freskëta, t’i duan nevojtarët dhe t’i ndihmojnë ata.

Hoxha ynë i nderuar Osman Nuri Topbash, tregon: *“Në kohën e vegjëlisë, babai im Musa Efendi, Allahu e mëshiroftë, na merrte në xhami, na tregonte diçka në lidhje me xhaminë, pastaj na jepte një sasi*

parash, me qëllim që t'ua shpërndanim nevojtarëve aty përqark. Kurse nëna ime, rahmet pastë, gatuate ushqime të shijshme, i vendoste në enë të mbyllura dhe na i jepte që t'ua çonim fqinjëve tanë të sëmurë. Ne i çonim ushqimet dhe gëzoheshim aq shumë kur merrnim duatë e tyre, sa që dëshironim që t'ua çonim edhe njëherë, me qëllim që të përjetonim përsëri atë gëzim shpirtëror që kishim ndjerë më parë.”

## 5. EDUKIMI NË LIDHJE ME MBULESËN DHE VESHJEN

Mbulesa dhe nderi janë çështje që i takojnë vetëm njeriut dhe një urdhri fetar shumë të rëndësishëm. Në ditët tona, njerëzimi ka marrë një plagë të rëndë në lidhje me këtë çështje. Mënyra e veshjes, e cila nuk i përshtatet aspak natyrës njerëzore, është përhapur jashtë mase. Nisur nga kjo, është e domosdoshme që fëmijëve tanë, qofshin djem apo vajza, t'ua japim edukimin e veshjes (mbulesës) që në moshë të vogël. Për fat të keq, disa prindër kanë mendime të gabuara dhe thonë; “Fëmijët janë ende të vegjël. Kur të rriten mbulohen e vishen si duhet”. Por ky lloj mendimi nuk është i drejtë. Përkundrazi, fëmijës duhet t'i jepet ky edukim që në moshë të vogël, me qëllim që kur fëmija të vijë në moshën e pjekurisë, të mbulohet e të vishet pa vështirësi ashtu siç urdhëron Islami. Kjo ndodhi që transmetohet prej Pejgamberit tonë (a.s.), është shumë domethënëse në lidhje me këtë çështje:

Nëna jonë Aisheja (r.a.), ishte ulur në shtëpi bashkë me motrën e saj Esmanë (r.a.). Pejgamberi (a.s.), hyri brenda dhe vuri re se Esmaja (r.a.), kishte veshur një rrobë me mëngë të gjera. Sapo e pa, ai doli menjëherë jashtë. Ndërsa Aisheja (r.a.), i thotë motrës: “Largohu, sepse Rasulullahu pa tek ti diçka që nuk e pëlqeu.” Kur Esmaja (r.a.), doli, Pejgamberi (a.s.), hyri përsëri. Më pas, Aisheja (r.a.), e pyeti Rasulullahun (a.s.), për shkakun e këtij veprimi dhe ai u përgjigj: “A nuk e sheh gjendjen? Një gruaje myslimane mund t'i duket vetëm kaq (gjë)” dhe duke i kapur mëngët i mbuloi duart deri tek gishtat. Më pas mbuloi tëmthat me duar dhe ia hapur vetëm fytyrën. (Hejthemi, V, 137.)

## 6. SHQETËSIMI PËR TË ARDHMEN DHE PËRGATITJA PËR BOTËN TJETËR

Në ditët e sotme, prindërit i ka kapluar një shqetësim i jashtëzakonshëm për të ardhmen e fëmijëve të tyre. Si do të jetë e ardhmja e fëmijës tim? Çfarë do të hajë e do të pijë? Ku do të punojë? Do të jetë nëpunës apo drejtor? Mirëpo, brenda këtyre shqetësimeve, nuk zë vend asnjë shqetësim për jetën e përjetshme, pra për botën tjetër. E megjithatë,

bota tjetër është e ardhmja e vërtetë. Jeta e vërtetë është ajo e botës tjetër. Nga kjo pikëpamje, shqetësimi kryesor duhet të jetë ai i botës tjetër. Në fakt, qëllimi numër një i dërgimit të pejgamberëve dhe zbritjes së librave, është t'ua përkujtojnë njerëzve këtë të vërtetë.

Ejani të mësojmë direkt prej gojës së Pejgamberit tonë (a.s.), se si duhet të bëhet përgatitja e fëmijëve për botën tjetër: Për shkak se vajza e tij Fatma (r.a.), përdorte mullirin, duart e saj ishin bërë tërë plagë; për shkak se mbarte ujë me kacek, në qafë i hapeshin plagë dhe për shkak se fshinte shtëpinë, bëhej gjithmonë me pluhur kokë e këmbë. Njëherë, Rasulullahut (a.s.), i kishin sjellë disa skllëvër. Sapo Fatma (r.a.), u mat të kërkonte një ndihmëse, Pejgamberi (a.s.), tha:

“O Fatma! Ki frikë Allahun, kryej farzet (detyrimet) e Allahut dhe bëj punët e familjes. Kur të shtrihesh në shtrat, thuaj tridhjetetë herë subhanallah, tridhjetetë herë elhamdulillah dhe tridhjetetë herë Allahu Ekber! Kështu, gjithsej bëhen njëqind. Kjo, për ty është më e mirë se sa shërbyesja”. (Ebu Daud, Haraxh, 19-20/2988. shih. Buhari, Humus, 6.)

## 7. SHEMBULLI PRINDËRVE

Nëna kangur i thotë birit të saj: “Biri im, përse ecën ashtu anash e anash? Ec drejt!” Biri i saj, i përgjigjet: “Nënë e dashur! Unë të kam parë të ecësh gjithmonë kështu. Prej teje kam mësuar të eci kështu. Nëse ti do të kishe ecur drejt, edhe unë do të kisha ecur si ti.”

Në fakt, kjo fabul e shkurtër tregon me të gjitha detajet kuptimin dhe rëndësinë e shembullit të prindërve për fëmijët e tyre, në çdo lloj sjelljeje, rregulli, virtyti dhe mirësie tjetër. Pra, s'ka nevojë për fjalë të tjera.

Nisur nga kjo, përgjegjësia e prindërve si kryefamiljarë në edukimin fetar të pjesëtarëve të tjerë të familjes, është shumë e madh. Kjo çështje është aq serioze, sa që nuk pranon neglizhencë dhe nënvleftësim, sepse ekzistojnë shumë ndikues të jashtëm, që në mënyrë të veçantë, fshijnë ndjenjat e të rinjve, tundojnë egot e tyre dhe i shpëpusin ata nga shpirtërorja, duke i bërë robër të egos.

Nga kjo pikëpamje, shkolla, rruga dhe rrethi, përmbajnë cilësi më shumë të dëmshme se sa të dobishme. Ndikimi shkatërrues i mediave të shkruara e vizive, në mënyrë të veçantë i internetit, ka arritur në përmasa që nuk mund të shprehen me fjalë. Pra, është shumë e qartë se çfarë kujdesi dhe përpjekjeje duhet të bëjmë në lidhje me edukimin fetar të fëmijëve tanë.



# NË CILËN PJESË TË RRUGËS JEMI? ÇFARË DUHET TË BËJMË TANI?

— Fuat Akpënar —

Qëllimi kryesor i jetës sonë duhet të jetë devotshmëria ndaj Allahut të Madhëruar, i Cili ka krijuar jetën dhe vdekjen dhe na ka dhënë mirësinë e shëndetit dhe jetës. Me devotshmëri nënkuptohet pranimi i ftesës së Allahut të Madhëruar për t'u bërë miq. Pejgamberët, robërit e mirë të Allahut dhe ata që i ndoqën gjurmët e tyre, i kanë thënë "po" kësaj ftese, pa asnjë dyshim e ngurrim. Madhërimin dhe adhurimin e Allahut, shërbimin me dashuri e mëshirë ndaj krijesave dhe çdo detyrë farz, ata e kanë vendosur në krye të të gjitha punëve të tyre.

Meqenëse;

Fruti më i mirë i devotshmërisë është mëshira dhe rezultati i saj është shërbimi, që nënkupton kërkimin e kënaqësisë së Allahut duke iu drejtuar krijesave me mëshirë dhe një zemër të mbushur me altruizëm...

Atëherë;

Për shkak se shërbimi është një detyrë sociale e devotshmërisë, që Zoti ynë i Madhëruar ka kërkuar prej robërve të Tij, njerëzit që shërbejnë në këtë kuptim, duhet të meditojnë mirë mbi emrat e bukur të Allahut të Madhëruar, Rrahman dhe Rrahim, me qëllim që të marrin frymëzim shpirtëror prej tyre.

Sepse;

Besimtari e ndjen veten përgjegjës për mbarëvajtjen

e shoqërisë në kohën e tij dhe nuk e mendon kurrë se e ka kryer detyrën e tij të devotshmërisë vetëm duke falur namazet e duke mbajtur agjërim.

Lidhur me këtë;

Nëse shërbimi ndaj Allahut të Madhëruar është bindja me dashuri ndaj urdhrave dhe ndalesave të Tij dhe puna në rrugën për ngritjen e Fjalës së Tij;

Nëse shërbimi ndaj të mëdhenjve të Islamit është shfaqja e dashurisë dhe besnikërisë ndaj tyre;

Nëse shërbimi ndaj prindërve, është t'u gëzosh zemrat pa u thënë as "uf";

Nëse shërbimi ndaj fëmijëve, është përpjekja për t'i edukuar ata si besimtar të mirë;

Nëse shërbimi ndaj të afërmve është vizita e tyre dhe plotësimi i nevojave të tyre;

Nëse shërbimi ndaj besimtarëve është ndarja e hallleve, vështirësive, dhimbjeve dhe gëzimeve me ta;

Nëse shërbimi ndaj njerëzve është të jesh i dobishëm ndaj tyre me dorën, gjuhën dhe zemrën tënde;

Nëse shërbimi ndaj krijesave të tjera është t'u hapësh atyre krahët e mëshirës;

Atëherë, në çfarë gjendjeje jemi ne?

A e kemi menduar se, sa më shumë shërbim që bëjmë, aq më shumë mëshirë dhe aq më besim të fortë do të kemi?

Sa është përpjekja jonë për të fituar kënaqësinë e Allahut duke iu drejtuar krijesave me një zemër të mbushur me altruizëm?



A kemi përfituar prej emrave të bukur të Allahut, Rrahman dhe Rrahim dhe sa kanë reflektuar ata tek ne?

Sa të vetëdijshëm jemi se ai që e kërkon shërbimin ndaj krijesave, është Zoti ynë i Madhëruar?

A jemi të vetëdijshëm se kuptimi i devotshmërisë, që kemi marrë përsipër, është përgjegjësia ndaj shërbimit?

Me sa dëshirë dhe dashuri i kryejmë detyrat e devotshmërisë?

Sa afër jemi me Rasulullahun (a.s.) dhe sa e njohim dhe e ndjekim Sunetin e tij? Sa i ngajmë atij në fjalët dhe veprat tona? Ku ndodhet ai në botën e zemrës sonë?

Nëse dëshirojmë të jemi bashkë me njerëzit e mirë e të devotshëm në botën tjetër, a përipiqemi sa duhet për të qenë bashkë me trup e me shpirt edhe në këtë botë?

A mendojmë se si t'i eliminojmë fjalët dhe sjelljet e rënda ndaj prindërve tanë?

Sa jemi të vetëdijshëm ndaj të drejtave që kanë njerëzit dhe krijesat e tjera mbi ne dhe a përipiqemi të marrim dëshminë e mirë prej tyre?

A jemi si një lumë, caku i të cilit është oqeani i takimit të përjetshëm me Allahun e Madhëruar?

A zotërojmë shpirtin e përsosur, i cili për të arritur shpëtimin e tij të përjetshëm kërkon përreth vetes shpirta të tjerë për t'i shpëtuar?

A e bartim qëllimin për t'iu bërë dikushi njerëzve të vuajtur e të vetmuar? A jemi besimtarë me shpirt të butë që u vëmë veshin rënkimeve të tyre?

A është bota jonë e zemrës aq e gjerë sa të marrë brenda të gjitha krijesat?

Nëse përgjegjësia jonë është deri atje ku na arrijnë zemrat, atëherë ku është caku ynë?

Sa e pasqyrojnë sjelljet tona dëshirën e madhe për takimin me Allahun?

A mund t'i themi “jo”, pyetjes se, a është ambicia jonë për këtë botë para kënaqësisë së Allahut dhe dashurisë ndaj njerëzve?

A nxitojmë drejt rënkimeve për ndihmë të krijesave dhe a mundemi t'i mbajmë duart e tyre pa i fyer e cenuar?

A mund t'u afrohemi me mëshirë edhe gjynahqarëve dhe a u drejtohemi atyre me gjuhën e mëshirës, duke u bërë mirë, për t'u treguar atyre fytyrën e bukur të Islamit?

A përputhen sjelljet tona me parimin “edukata e shërbimit është më e rëndësishme se vetë shërbimi”?

*Nëse për zemrat  
e njerëzve të mirë,  
shërbimi ndaj  
krijesave nuk është  
lodhje, por kënaqësi  
dhe burim paqeje  
shpirtërore, po për  
ne si është?*

A e dimë se çelësi i suksesit të njerëzve të zemrës që mbështeten tek Allahu, është durimi dhe qëndresa?

A jemi të vetëdijshëm se shërbimi në rrugën e takimit me Allahun nuk është një dashuri kalimtare, por një borxh i madh i devotshmërisë dhe një profesion pejgamberësh, i cili duhet të vazhdojë gjatë gjithë jetës?

A bëjmë edhe ne dua si Pejgamberi ynë (a.s.), “O Zot! Strehohem tek Ti nga dobësia, përtacia, frika dhe mosbindja”, me qëllim që të jemi pjesë e karvanit të shërbimit ndaj krijesave, shpërblimi i të cilit do të jepet vetëm prej Allahut të Madhëruar?

Nëse për zemrat e njerëzve të mirë, shërbimi ndaj krijesave nuk është lodhje, por kënaqësi dhe burim paqeje shpirtërore, po për ne si është?

Shërbimi është një mirësi, prandaj duhet t'ia dimë vlerën. Sa e falënderojmë Allahun e Madhëruar, i Cili na e bën të mundur të jemi prej shërbyesve?

A jemi të vetëdijshëm se “të ndihmuar prej Allahut” janë njerëzit me zemër të gjerë dhe shërbyesit e vërtetë? A jemi edhe ne prej këtyre njerëzve që kanë arritur një mirësi dhe një përsosmëri të tillë?



# Dinjiteti njerëzor

— Duran Ekizer —

Dinjiteti i njeriut buron nga marrëdhënia që ka me Krijuesin. Përmes mesazhit hyjnor, pejgamberët kanë synuar lartësimin e dinjitetit njerëzor. Njeriu mund ta fitojë dinjitetin vetëm përmes ibadetit.

## NJERIU DHE IBADETI

Njeriu është krijesa më e përsosur dhe e nderuar ndër të gjitha krijesat. Prandaj krahas jetës, pasurisë, fesë, nderit dhe pasardhësve i është marrë në mbrojtje edhe dinjiteti, krenaria dhe ndjenjat.

## SHKAKU DHE QËLLIMI I KRIJIMI TË NJERIUT

Ajeti Kuranor: *“Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë.”* (Dharrijat, 51) e shpreh qartë qëllimin e krijimit dhe burimin e dinjitetit të tij. Pra, dinjiteti i njeriut është i lidhur ngushtë me ibadetin ndaj Allahut.

Pengimi i njerëzve nga ibadeti ndaj Allahut është cenimi më i madh që i bëhet dinjitetit të njeriut. Pengimi i njerëzve dhe moskrijimi i kushteve për të praktikuar fenë, është përdhosje e dinjitetit të njeriut. Pengimi i njerëzve nga feja është ndër mëkatet e mëdha.

*“Të pyesin ty për muajin e shenjtë, për luftën në të. Thuaju: ‘Luftimi në atë kohë është gjynah i madh, por pengimi i njerëzve prej udhës së Allahut, mohimi i Tij, pengimi i njerëzve nga vizita e Xhamisë së Shenjtë dhe dëbimi i banorëve të saj nga ajo, janë gjynah më i madh tek Allahu.”* (Bekare, 217)

Kurse në një ajet tjetër, Kurani na informon se pengimi nga rruga e fesë dhe Allahut është veprim dhe investim i mosbesimtarëve:

*“Në të vërtetë, jobesimtarët e shpenzojnë pasurinë e tyre për t’i penguar njerëzit nga rruga e Allahut. Ata do ta shpenzojnë atë, por në fund ajo do jetë*

*vetëm dëshpërim për ta, sepse do të jenë të mundur.”* (Enfal, 36)

Edhe qëllimi i Xhihadit është mbrojtja e dinjitetit njerëzor, nxjerrja e njeriut nga robërimi ndaj njeriut, në robërimin ndaj Krijuesit të gjithësisë.

## DETYRA E PEJGAMBERËVE

Allahu në një ajet Kuranor thotë:

*“Ne nuk kemi nisur asnjë të dërguar para teje, që të mos i kemi shpallur se: ‘S’ka zot tjetër përveç Meje, andaj më adhuroni (vetëm) Mua!’”* (Enbija, 25)

Kurse në një ajet tjetër thotë:

*“Çdo populli Ne i çuam një të dërguar (që u thoshte): ‘Adhuroni Allahun dhe shmangni idhujt!’”* (Nahl, 36)

Siç vihet re lehtësisht, ajetet përcaktojnë dy detyra kryesore të Pejgamberëve:

1. Thirrjen në Tevhid, njësimin e Allahut.
2. Tërheqjen e vëmendjes për t’u distancuar nga çdo gjë tjetër që nuk ka lidhje me Allahun.

Plotësimi i këtyre dy detyrave i jep njeriut dinjitetin dhe nderin e merituar.

Për të ruajtur të pastër Tevhidin, është e domosdoshme njohja e politeizmit. Dhe të gjithë pejgamberët ia kanë bërë të njohur bashkësisë së vet politeizmin.

## POLITEIZMI

Politeizmi është t’i atribuosh cilësitë e Allahut dikujt tjetër, thënë ndryshe, t’i dedikosh krijesës cilësi hyjnore. Pra, politeizmi nuk është mohim i Zotit, por shoqërimi shok Atij. Politeizmi në Kuran konsiderohet si padrejtësi e madhe dhe faj i pafalshëm. *“Pa dyshim, idhujtaria është një padrejtësi shumë*

*e madhe*". (Lukman, 13) **"Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Atij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë. Kushdo që i bën shok Allahut (në adhurim), ka bërë gjynah të tmerrshëm."** (Nisa, 48)

Politeizmi është shfaqur në fillim si idhujtari. Disa idhujtarë i konsideronin idhujt si ndërmjetës midis tyre dhe Zotit, kurse disa të tjerë kërkonin ndihmë prej tyre.

Shembuj primitivë të politeizmit janë shfaqur në kohën e Nuhut (a.s). Më vonë filluan të shfaqen forma të tjera të politeizmit, si shenjtërimi i zjarrit, njerëzve, kafshëve, diellit dhe yjeve, kurse sot politeizmi na shfaqet përmes sistemeve, koncepteve dhe parimeve.

Sot disa koncepte, parime dhe sisteme janë shenjtëruar, hyjnizuar. Kjo gjendje ka sjellë shfaqjen e një lloj politeizmi të ri. Shembuj të këtij politeizmi janë demokracia, modernizmi, laicizmi, teknologjia etj. Të gjitha këto kanë cenuar dinjitetin e njeriut sepse dinjiteti është shprehje e ibadetit të lirë ndaj Allahut. Nëse një person ose një shoqëri privohet nga kjo mundësi apo nuk e gjen këtë mundësi, atëherë dinjiteti i atij personi apo asaj shoqërie është nëpërkëmbur.

### **THIRRJA E PEJGAMBERËVE PËR TEVHID DHE LUFTA E TYRE PËR DINJITET**

Në një hadith, Pejgamberi (a.s), ka thënë:

*"Fjala më e rëndësishme që kam predikuar unë dhe pejgamberët para meje, ka qenë fjala: Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut."* (Muvatta, Kuran, 32)

Pejgamberët janë dërguar për udhëzimin e njerëzimit. Nga kjo pikëpamje, mesazhi i tyre është shumë i rëndësishëm për arritjen e lumturisë në këtë botë dhe botën tjetër. Më gjithë qëllimin kryesor të njëjtë, mësimet dhe mesazhet e pejgamberëve kanë pasur edhe dallime ndërmjet tyre në varësi të kohës dhe vendit. Predikimi i fjalës së shehadetit ka qenë për të gjithë pejgamberët pa përjashtim. Pra, kauza kryesore dhe më e rëndësishme e pejgamberëve ka qenë njësimi i Allahut dhe skalitja e këtij parimi në zemrat e njerëzve për ta pasqyruar në jetën e tyre të përditshme.

Të gjithë pejgamberët kanë luftuar për lartësimin dhe respektimin e dinjitetit njerëzor, të bazuar në parimet e Tevhidit. Në këtë luftë ata gjetën përballë drejtuesit dhe parinë e shoqërisë, e shprehur ndryshe, gjetën përballë të ashtuquajturit intelektualë. Intelektualët hapën një front të gjerë dhe të ashpër kundër pejgamberëve dhe mesazhit të tyre. Për të penguar përhapjen e mesazhit, filluan një propagandë denigruese dhe shpifje. Kurse besimtarët që ndoqën pejgamberët i diskriminuan, torturuan dhe i bojkotuan duke ndërprerë lidhjet shoqërore, fisnore dhe ekonomike. Shkurtimisht, përdorën mënyrat më

çnjerëzore për të larguar besimtarët nga Tevhidi. Të gjitha këto ishin veprime kundër dinjitetit njerëzor.

Pastrimin e Tevhidit nga idhujtaria, e cila ndot dhe cenon drejtpërdrejt dinjitetin njerëzor, pejgamberët e kanë filluar nga fjala "la ilahe il-la Allah".

Të gjithë pejgamberët kanë luftuar për lartësimin e kësaj fjale. Sepse çdo çoroditje dhe shthurje që shfaqet në shoqëri është e lidhur në mënyrë direkte me Tevhidin. Në momentin që turbullohet pastërtia dhe kthjelltësia e Tevhidit, fillojnë të shfaqen shthurjet dhe shkeljet e dinjitetit njerëzor.

Fatkeqësisht, në ditët tona, ibadetit të pastër i është bashkëngjitur një formë idhujtarie.

Prandaj, pejgamberët e kanë filluar luftën për lartësimin e dinjitetit të njeriut duke vendosur përballë politeizmit Tevhidin dhe përballë ateizmit imanin.

Janë dy qëndrime të pejgamberëve në përpjekjen për lartësimin e Tevhidit dhe dinjitetit njerëzor, të cilat duhen zbatuar nga të gjithë myslimanët sot.

#### *1. Mbrojta e besimtarëve*

Asnjë pejgamber nuk i ka larguar besimtarët dhe dëbuar besimtarët për shkak të kërcënimeve të drejtuesve, përkundrazi i kanë mbështetur dhe mbrojtur ata. Fjala e Nuhut është dëshmi për këtë: **"Unë nuk mund t'i dëboj ata që besojnë... O populli im, kush do të më mbrojë nga Allahu, nëse unë i dëboj (besimtarët)? A nuk doni të merrni këshillë?... Nuk do t'u them atyre, të cilët sytë tuaj i nënçmojnë, se Allahu nuk do t'u japë kurrfarë të mire. Allahu e di më mirë se ç'ka në shpirtrat e tyre. Atëherë, sigurisht që do të isha prej të padrejtëve."** (Hud, 29-31)

Besimtari qoftë edhe i vetëm është një burim virtyti, mirësie dhe dinjiteti.

Sido që të jenë kushtet, myslimanët e kanë obligim madhor mbështetjen, ndihmën dhe daljen për zot të dinjitetit të besimtarit, moslejimin në asnjë mënyrë të përdhosjes së dinjitetit të besimtarit.

#### *2. Përpjekja për të rritur dhe edukuar pasardhës besimtarë.*

Një veçori tjetër e pejgamberëve ka qenë përgjegjësia dhe përpjekja e tyre për të rritur dhe edukuar pasardhës besimtarë. Lutja e Pejgamberit (a.s): **"O Zot, unë nuk dëshiroj shkatërrimin e tyre, por të lutem Ty të nxjerrësh prej tyre pasardhës besimtarë."** Për popullin e Taifit është shprehje e qartë e kujdesit të pejgamberëve për të edukuar pasardhës besimtarë.

Zgjerimi, përhapja e Islamit në një kohë të shkurtër në katër anë e botës dhe krijimi i një qytetërimi madhështor, erdhi si pasojë e brezave besimtarë të cilët morën në mbrojtje dhe nderuan dinjitetin njerëzor.

Prandaj, detyra kryesore e besimtarëve sot është rritja dhe edukimi i pasardhësve besimtarë, të cilët mund të marrin përsipër mbrojtjen dhe lartësimin e dinjitetit njerëzor.





## Një Ajet

*"A mendoni se do të hyni në Xhenet, pa i provuar Allahut ata që kanë luftuar prej jush dhe pa i provuar ata që kanë duruar?"*

(Al 'Imran, 142)

Jeta, vdekja, toka, qielli shkurtimisht i gjithë universi është krijuar për një qëllim të caktuar. Dhe qëllimi është testimi dhe provimi i njeriut në tokë. Allahu, krijuesi i gjithësisë, e ka caktuar dynjanë si vend sprove për njeriun.

Sprova do të bëjë të mundur dallimin e të mirit nga i keqi, paqësorit nga ngatërrestari, punëtorit nga shkatërruesi. Përmes kësaj sprove do të dallohet cili është ndjekësi i mësimëve hyjnore dhe cili është ndjekësi i shejtanit. Sipas kësaj do të realizohet edhe vlerësimi në Ditën e Gjykimit.

Në jetën e kësaj bote jemi përballë një zgjedhjeje. Dhe gjithsecili bën zgjedhjen e vet. Dikush punon për dynjanë, dikush për ahiretin, dikush zgjedh drejtësinë, dikush tjetër padrejtësinë.

Jeta e kësaj bote për besimtarët është si një rrugë me pengesa. Këto pengesa nganjëherë shfaqen si fatkeqësi, nganjëherë si mirësi. Shpëtimin e përhershëm do ta arrijë ai që i kalon një për një këto pengesa. Çdo fushë e jetës luan rolin e një site për njeriun, çdo veprim vë në dukje sinjertetin, besnikërinë ose dyfytërsinë tonë.

Kurani jep shembuj konkretë për sprovën e njeriut në këtë botë. Ngjarja e Talutit me Xhalutin është një nga ato. Taluti merr pjesë në luftë për të luftuar kundër armiqve, por gjatë rrugës ndodh një sprovë e papritur: Allahu ua ndalon të pinë ujë në lumin që do t'u dalë përpara, përveçse një grushti uji. Mirëpo ushtarët, të etur për ujë nuk e respektuan këtë urdhër dhe pinë ujë deri sa u ngopën. Në këtë mënyrë humbën provimin.

Sprova të tilla i përjeton gjithsecili prej

nesh në jetën e tij. Ne sprovohemi në punë, në shtëpi, në rrugë. Sprova, herë shfaqet në planin individual, herë në planin shoqëror. Ne mund gjendemi përballë një sprove në çastet më kritike të jetës sonë. Tundimet e shejtanit dhe egos janë një sprovë për besimin dhe besnikërinë tonë. Në të tilla raste vigjilenca është shumë e rëndësishme.

Në të tilla raste besimtari është i vetëdijshëm për vëzhgimin e rreptë hyjnor. Prandaj besimtari vihet me të gjithë forcën për të përballuar sprovën me të cilën është përballur.

Jeta e njeriut është e mbushur me ulje dhe ngritje, herë jemi të lumtur herë të hidhëruar, herë të pasur herë të varfër. **"Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë "Ne besojmë", pa u vënë në provë?! Ne i kemi sprovuar ata që kanë qenë para tyre, në mënyrë që, Allahu të dallojë ata që thonë të vërtetën dhe, ata që gënjejnë."** (Ankebut, 2-3) Siç theksohet në ajetin e mësipërm, sprova është pjesë e kaderit të njeriut në tokë.

Të gjithë njerëzit do të kalojnë nëpër sprova, nga ky rregull nuk kanë bërë përjashtim as pejgamberët. E gjithë jeta e pejgamberëve ka qenë e mbushur me sprova nga më të ndryshmet.

Njeriu, përballë çdo provimi mban një qëndrim të caktuar, është pikërisht ky qëndrim i cili nxjerr në pah natyrën e moralit të personit. Këtë rregull Kurani na e kujton në këtë mënyrë: **"Ne do t'ju vëmë në provë ju, derisa t'i njohim ata midis jush, që luftojnë (në rrugën e drejtë) dhe durojnë e derisa të provojmë ato që thuhet për veprat tuaja."** (Muhamed, 31)

Pejgamberi -salall-lahu alejhi ve selem-, ka thënë:

*“Janë dy mirësi të cilat shumica e njerëzve i neglizhojnë; shëndeti dhe koha e lirë.”*

(Buhari, Rikak,1)

Zoti në Kuran, për mirësitë e pafundme dhuruar njeriut, nga një anë kërkon të jetë falënderues dhe mirënjohës dhe nga ana tjetër tërheq vëmendjen të mos përfshihet nga vetëkënaqësia. ***“O njerëz! Pa dyshim, premtimi i Allahut (Dita e Gjykimit) është i vërtetë, prandaj të mos ju mashtrojë kurrsesi jeta e kësaj bote dhe të mos ju mashtrojë djalli për Allahun.”*** Ndërsa në njëër anë na kujton se do të vijë një ditë ku do të kërkohet llogari për çdo mirësi, në anën tjetër kërkon të jemi vigjilentë përballë armiqtë të cilët synojnë të harrojmë Ditën e Gjykimit.

Kurani na jep shpesh shembuj konkretë të atyre që u mashtruan nga pozita, fama, pasuria dhe mirësitë e tjera kalimtare, në mënyrë që të mos biem në të njëjtën grackë. Kurani na këshillon të mos mashtrohemi, sepse kur të vijë dita që të na dalë në pah mashtrimi, nuk do të ketë asnjë dobi.

Pejgamberi (a.s), i cili është prijësi ynë në jetën e kësaj bote, na ka tërhequr vëmendjen për dy mirësi, të cilat shumë prej nesh i neglizhojnë. Shëndetin dhe kohën e lirë. Këto dy mirësi nuk janë të domosdoshme për jetën tonë vetëm në këtë botë, por janë të domosdoshme edhe për të ndërtuar botën tjetër. Sepse për të kryer detyrat duhet shëndet dhe të gjitha detyrat kryhen në një kohë të përcaktuar.

Megjithëse rëndësia e shëndetit theksohet pothuajse në çdo mjedis, ai është ndër mirësitë më të neglizhuara dhe të lëna pas dore.

Pasuria materiale pa shëndet është krejtësisht e pakuptimtë dhe e pavlerë. Feja islame ka treguar një kujdes të veçantë në mbrojtjen e shëndetit. Hadithet që flasin për mirushqyerjen, pastërtinë e dhëmbëve, gojës, trupit, enëve, mjedisit, sportit etj., janë të gjithë tregues të kujdesit që tregon Islami për shëndetin e njeriut.

Një tjetër mirësi, të cilën e neglizhojmë shpesh, është edhe koha e lirë. Allahu na ka dërguar në këtë botë për të na sprovuar se cili është vepërmirë e cili jo, në një kohë të caktuar. Mirëpo ne, të mashtruar nga kënaqësitë e kësaj bote, harrojmë detyrat që kemi përballë Allahut me shpresën se jeta jonë është e gjatë dhe me iluzionin se vdekja është shumë larg, harrojmë që çdo moment i kaluar është i pakthyeshëm.

Vetë betimi që bën Allahu mbi kohën është një tregues i qartë i rëndësisë dhe vlerës së saj në jetën e njeriut. Ata që e investojnë kohën në vepra të këqija, në Ditën e Gjykimit do të pendohen dhe do të kërkojnë leje për t’u rikthyer, por atëherë do të jetë tepër vonë dhe përgjigja ndaj kërkesës së tyre do të jetë: ***“Vallë, a nuk jua zgjatëm jetën aq sa të mund të mendohej ai që donte të kujtonte (Allahun)?! Madje juve ju erdhi edhe paralajmëruesi.”*** (Fatir, 37) , prandaj besimtari duhet të vlerësojë më së miri çdo moment të jetës së tij dhe vazhdimisht të falënderojë Allahun për këto dy mirësi të mëdha.

### Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Koha dhe shëndeti janë dy nga mirësitë më të çmuara që ka njeriu.
2. Njeriu i neglizhon këto dy mirësi.
3. Njeriu në përgjithësi është neglizhent ndaj mirësive.





## LUMTURIA FAMILJARE NËNAT E NDERUARA

### NËNA, BURIMI I MIRËSISË

Hudhejfe t tregon:

Një ditë nëna më pyeti:

“Kur u takove për herë të fundit me të Dërguarin e Allahut?”

“Ka disa ditë që nuk jam takuar.”-u përgjigja.

Nëna u zemërua shumë me mua dhe më tërhoqi vërejtjen. Ndërsa unë i thashë: “Mos u zemëro nënë. Do shkoj menjëherë ta takoj të Dërguarin e Allahut, të falem bashkë me të në namazin e akshamit dhe më pas do i kërkoj të lutet për ty dhe për mua.” (Tirmidhî, Menâkib, 30; Ahmed, V, 391-2)

Sa shembull kup-timplotë i edukimit dhe përkujdesjes së një nëne të nderuar ndaj djalit të saj!

Nënat besimtare që u brumosën me edukimin shpirtëror profetik u bënë edukatore dhe heroinat e padukshme të Epokës së Lumturisë.

Ato i përcillnin bashkëshortët në mëngjes me lutje duke u thënë:

*“Ki kujdes! Mos sill në shtëpi diçka të fituar në rrugë të ndaluar. Sepse ne mund ta durojmë urinë në jetën e kësaj bote, por nuk mund ta durojmë dënimin në jetën e botës tjetër.”* (Abdülhamid Kesk, *Fi Rihâbi't-Tefsîr*, I, 26)

Edukimi i nënave fisnike është një domosdoshmëri për ndërtimin e një shoqërie të shëndoshë siç e kërkon Islami.

Kështu në ajetin kuranor thuhet:

“...edhe ata (besimtarët) që thonë: “O Zoti ynë, dhurona nga gratë tona dhe trashëgimtarët tanë, ç’është prejhe për sytë tanë dhe na bëj shembull

për të mirët!” (Furkan, 74)

Qeliza e shoqërisë është familja. Familja ndërtohet përmes kurorëzimit në emër të Allahut. Në mungesë të kurorëzimit nuk mund të ketë as rend familjar dhe shoqëror, por vetëm krijesa që sorollaten si një tufë.

Krijuesi i Gjithësisë kërkon prej nesh të ndërtojmë një shoqëri mbi bazën e devotshmërisë. E kush më shumë se nënat e devotshme dhe të përkushtuara ndaj fëmijëve të tyre mund të ndërtojnë një shoqëri të tillë paqeje dhe qetësie? Të parët tanë kanë thënë:

Ketë të vërtetë e kanë shprehur edhe me fjalët: “Folenë e ndërton zogu femër.”

### FEMRA E SHTYPUR NË KOHËN E INJORANCËS

Në kohën e hershme të injorancës fëmijët vajza ishin të padëshirueshme. Atyre u bëhej padrejtësi, e drejta për trashëgimi u mohoj, madje disa

prej tyre varroseshin të gjalla.

Në shumë luftëra mes fisesh gruaja ishte objekt shfrytëzimi çnjerëzor. Nderi dhe dinjteti i saj nëpërkëmbej përtej çdo lidhjeje të ligjshme kurorëzimi.

Sipas transmetimit të Katades arsyeja pse vajzat groposeshin të gjalla në periudhën e injo-rancës nga fiset arabe të asaj kohe ishte:

“nga frika e nëpërkëmbjes së nderit të tyre në rast robërimi nga fiset e tjera si dhe druajtja nga varfëria.”

Për t’iu shmangur kësaj gjendjeje, thuhet se i vrisnin fëmijët e tyre vajza që në moshë të vogël dhe





në vend të tyre ushqenin qentë. (Taberî, *Tefsîr*, VIII, 68, [el-En'âm, 140])

Natyrisht të tregosh dhembshuri ndaj krijesave dhe t'i ushqesh ato është diçka e bukur. Por të zëvendësosh qentë me fëmijët dhe t'i ushqesh ata në vend të tyre në këndvështrimin familjar dhe shoqëror është padyshim një çështje shqetësuese.

Ndërsa sot, në kohën e **inJORANCËS moderne** femra shihet si një mall, si një objekt për shitje dhe argëtim duke abuzuar kështu me personalitetin e saj. Vlera e një gruaje nuk mund të matet nga gjinia e saj, por nga personaliteti që zotëron. Rezultati i kërkimit të vlerës në lëkurë, gjini apo në ekspozimin e trupit është një katastrofë e dhimbshme njerëzore. Kjo ngjan me shkeljen e një luleje të rrallë të mbirë në kalldrëme apo me flakjen e një diamanti në koshin e mbeturinave. Kjo gjendje s'është tjetër vetëm se turp i njerëzimit.

**Islami** nga ana tjetër e ka ngritur femrën në pozitën e një gruaje fisnike. Sepse kur gruaja është e tillë, ka dobi individi, familja dhe e gjithë shoqëria. Në të kundërt kur gruaja humbet dëlirësinë dhe dinjitetin e saj e tërë shoqëria pëson goditje.

Kurani i Lavdishëm shpesh vë në dukje rëndësinë e barmirësisë ndaj prindërve. Në shumë ajete fëmijët ftohen të jenë mirënjohës, bamirës dhe të bëjnë lutje për prindërit e tyre dhe në mënyrë të veçantë për nënat të cilat i sollën në jetë pas shumë mundimesh:

Njeriun e kemi porositur të jetë i sjellshëm ndaj prindërve të vet. Nëna e mbart atë me mund dhe me mund e lind. Ai mbartet dhe ushqehet me gji për tridhjetë muaj dhe, kur arrin në moshën e burrërisë e i mbush dyzet vjet, ai thotë:

“O Zoti im! Më frymëzo që të të falënderoj për begatitë që Ti më ke dhënë mua dhe prindërve të

mi dhe që të bëj vepra të mira, me të cilat Ti do të jesh i kënaqur! Më dhuro pasardhës të mirë! Tek Ti kthehem i penduar dhe Ty të dorëzohem!” (Ahkaf, 15)

I Dërguari i Allahut ka thënë:

“*Xheneti është nën këmbët e nënës.*” (Nesâi, Xhîhâd, 6)

Thënë ndryshe, asnjë fëmijë nuk mund të prete ndojë të hyjë në derën e xhenetit pa fituar kënaqësinë (zemrën) e nënës.

Një sahabi e pyeti të Resulullahun:

“O i Dërguar i Allahut! Kush e meriton më shumë përkujdesjen time?”

Ai r u përgjigj:

“*Nëna, pastaj nëna, pastaj përsëri nëna, pastaj babai, pastaj më të afërmit tuaj.*” (Muslimi, Birr, 2)

I Dërguari i Allahut ishte shembulli më i bukur i shprehjes së mirënjohjes dhe respektit ndaj mëndeshës së tij. Se herë e shihte zonjën Halime e thërriste: “Nënë e dashur, nënë e dashur!” Ai tregonte dashuri dhe respekt, shtrinte në tokë veshjen (pelerinën) e tij për të dhe nxitonte të kryente çdo kërkesë dhe nevojë që ajo kishte. (Ibn-i Sa'd, I, 113, 114)

Janë të paharrueshëm personalitete të shumta islame që kanë ndjekur shembullin e të Dërguarit të Allahut në respektimin dhe nderimin e nënës.

Imam Ebu Hanifja e pati refuzuar propozimin e udhëheqësit të shtetit të asaj kohe Mansurit, për t'u bërë kadi (gjykatës) i Bagdatit, nga frika e keqpërdorimit të ixhtihadit për interesat e tij. Për rrjedhojë Ebu Hanifja u burgos. Por shqetësimi i tij i vetëm ishte frika se nëna e tij do mërzhitej kur të mësonte këtë lajm.

**Abdurrahman Xhami** respektin dhe mirënjohjen ndaj nënës së tij e shpreh me fjalët:

*“Ki kujdes!  
Mos sill në shtëpi  
diçka të fituar në rrugë  
të ndaluar. Sepse ne  
mund ta durojmë urinë  
në jetën e kësaj bote, por  
nuk mund ta durojmë  
dënimin në jetën  
e botës tjetër.”*

(Abdülhamid Keshk,  
*Fî Rihâbi't-Tefsîr*, I, 26)



*“E si mos ta dua nënën. Ajo më barti për një kohë në trupin e saj, pastaj në krahët e saj, e për gjithë jetën në zemrën e saj.”*

**Bahauddin Nakshibendi** thotë:

*“Kush dëshiron të vizitojë varrin tim, fillimisht të ndalet në varrin e nënës sime...”* duke u përpjekur të bëhej kështu një sadaka rrjedhëse për nënën e tij.

Allahu i Lartësuar në Kuranin Famëlartë përmes tregimeve na ka paraqitur shembuj të nënave dhe baballarëve fisnikë e të familjeve të ndritura:

### **NËNAT SHEMBULLORE PËR NJË FAMILJE SHEMBULLORE**

Allahu i Lartësuar në Kuranin Famëlartë ka përmendur Hz. Merjemën si simbol të ndershmërisë dhe dëlirësisë dhe si model të zonjës fisnike.

Pas çdo personaliteti të ndritur qëndron një nënë e përkushtuar, kështu edhe nëna e Hz. Merjemit ishte një shembull i bukur i sinqeritetit dhe devotshmërisë.

Allahu i lartësuar përmes nënës së Hz. Merjemit, zonjës Hanne na ka ofruar një shembull konkret se si duhen edukuar fëmijët nga prindërit e tyre. Kështu në Kuranin Famëlartë një sure mban emrin, familja e Imranit (Al-i Imran) e cila përbën një shembull të përkushtimit ndaj edukimit të një brezi të shëndoshë dhe shembullor.

Nëna e Hz. Merjemit kur ishte ende shtatzënë duke menduar se foshnja që mbante në bark ishte djalë, ia kushtoi atë Bejtul Makdis-it.

Në thelb kjo ishte një shfaqje e devotshmërisë sepse:

- Të duash për fëmijën si qenia më e shtrenjtë e nënës, që ai të rritet dhe të edukohet në formën më të bukur brenda një atmosfere besimi dhe adhurimi,

- Të dëshirosh që ai të bëhet një sadaka rrjedhëse për prindin dhe një pasardhës i denjë,

- Ta shkëputësh atë nga prehri për t'ia kushtuar Zotit në thelb është simbol i një besimi dhe devotshmërie të thellë.

Nëna e Hz. Merjemit nuk e theu betimin edhe pse fëmija që lindi ishte vajzë. Përmes një vendosmërie të thellë ajo u tregua besnike ndaj premtimit që i kishte dhënë Krijuesit Fuqiptotë duke iu lutur me fjalët:

**“Zoti im!... E kam lënë atë me pasardhësit e saj nën mbrojtjen Tënde nga djalli i mallkuar.”** (Al-i Imran, 36)

Allahu i Lartësuar e pranoi zotimin e saj si shprehje e një qëllimi të pastër dhe e rriti atë si një filiz të njomë.

Hz. Merjemi i shërbente vazhdimisht faltores së shenjtë (xhamisë), ishte gjithnjë e zënë me adhurim, ruhej nga gjërat e ndaluara dhe e mbronte nderin e saj me dëlirësi.

Por edhe pse nuk e kishte prekur dorë njeriu ajo mbeti shtatzënë dhe lindi Hz. Isain, një ndër profetët më të rëndësishëm të historisë.

Allahu i Lartësuar e ka përmendur 34 herë emrin e saj në Kuranin Famëlartë. Shpeshherë kur është folur për Isain a.s. është përmendur në formën “Isai, biri i Merjemes” duke iu dhuruar kështu një nderim dhe respekt nënës së tij, Hz. Merjemit.

Hz. Merjemi gostitej me mirësi të shumta nga Krijuesi i Gjithësisë. Ndërkohë që ajo ishte zënë me adhurim Allahu i Lartësuar e gostiste me fruta (të xhenetit).

Po ashtu në momentet e vështira të lindjes së Hz. Isait, asaj iu dhuruan hurma të freskëta dhe pranë u çel një burim uji si mirësi nga Zoti i Gjithësisë.

Por pas lindjes së fëmijës pa baba si një mrekulli hyjnore, njerëzit e paditur e sulmuan me akuza të pabaza dhe shpifje. Ndërsa Krijuesi Fuqiptotë i dhuroi Isait a.s. mrekullinë e të folurit që në djep që ai të shpallte ndershmërinë dhe dëlirësinë e nënës së tij.

Allahu i Lartësuar duke dëshiruar që Hz. Merjemi të fitojë grada të larta në adhurim, shprehet:

**“O Merjeme! Bindju Zotit tënd! Bëj sexhde dhe përkulu në ruku bashkë me ata që përkulen (duke adhuruar Allahun)!”** (Al-i Imran, 43)

Urtësia e këtij tregimi;

- Besimtarët që e jetojnë jetën me devotshmëri dhe ndershmëri janë nën mbrojtjen e Allahut dhe të lartësuar si në këtë botë ashtu edhe në tjetrën.

- Prindërit e përkushtuar edukojnë një brez të dobishëm.

- Brezi i ri duhet të edukohet me parimin e shërbiimit në rrugën e Zotit përmes frymës kuranore, dhe qetësisë shpirtërore të sexhdeve dhe mesxhideve.

Kurani Famëlartë na mëson se gratë e të Dërguarit të Allahut duhet t'i vlerësojmë si nënat tona. Secila prej tyre është nëna e umetit dhe shembull për ne. Në krye;

### **HZ. HATIXHJA**

Hz. Hatixhja është bashkëshortja e parë e të Dërguarit të Allahut, nëna e të gjithë fëmijëve të tij me përjashtim të Ibrahimit, njeriu i parë që i besoi profecisë së tij dhe shembulli më i bukur i një gruaje fisnike.

Ajo ishte përkrahja më e madhe materiale dhe

shpirtërore e të Dërguarit të Allahut që në ditët e tërheqjes së tij në shpellën Hira deri në kohërat më të vështira të bojkotit mekas.

Kështu kur i Dërguari i Allahut që kthyer i shqetësuar nga ajo që i kishte ndodhur në Hira duke pyetur:

*“O Hatixhe, e kush do të më besojë mua?”* Ajo i tha:

*“Mos ki frikë! Allahu kurrë nuk do të të turpërojë! Sepse ti i ruan lidhjet farefisnore, thua të vërtetën, i ndihmon nevojtarët, u fal fukarenjve, i mirëpret mysafirët dhe i mbron ata të cilëve u është bërë padrejtësi.”*, duke e mbështetur kështu moralisht të Dërguarin e Allahut. (Buhârî, Bed‘u’l-Vahj, 1; Muslim, Îmân, 252; Ibn-i Sa‘d, I, 195)

Hiz. Hatixhja me besnikërinë dhe bujarinë e saj unike shpenzoi të gjithë pasurinë që zotëronte për hir të Allahut dhe të Dërguarit të Tij në një kohë kur Islami përjetoi vitet më të vështira të bojkotit mekas, duke u bërë kështu një simbol i sakrificës dhe besimit të palëkundur.

Vdekja e saj ishte aq e rëndë (e dhimbshme) për të Dërguarin e Allahut sa që sahabët e nderuar e quajtën atë vit, “Viti i Dëshpërimit”. Profeti ynë i dashur kishte kalur sprova të ndryshme: vdekja e fëmijëve një nga një, vrasja çnjerëzore e xhaxhait të tij Hz. Hamzait dhe sahabëve të tjerë të nderuar, e sa e sa vuajtje të tjera, por asnjë nga këto ngjarje nuk u quajt me atë emër...Emërtimi i vitit të vdekjes së Hz. Hatixhes, si: “Viti i Dëshpërimit” është një tregues domethënës i mbështetjes së thellë morale që ajo i dha të Dërguarit të Allahut.

Pejgamberi r nuk e harroi kurrë hijeshinë shpirtërore dhe delikatesën e saj. Sa herë priste ndonjë kurban, nuk harronte të dërgonte një pjesë edhe të afërmeve të saj dhe të interesohej për ta.

Ai e vlerësonte kështu Hz. Hatixhen:

*“Gruaja më e mirë e kohërave të shkuara është Mejremi. Ndërsa gruaja më e mirë e këtyre kohërave është Hatixhja.”* (Buhârî, Menâkibu’l-Ensâr, 20, Enbijâ, 45; Muslim, Fedâilu’s-Sahâbe, 69)

Bashkëshortet e të Dërguarit të Allahut janë për ne një shembull të një nëne fisnike. Le të sjellim shembullin e një personaliteti tjetër madhështor:

## HZ. AISHJA

I Dërguari i Allahut duke u martuar me Hz. Aishen, vajzën e mikut të tij më të shtrenjtë Ebu Bekrin, i dha asaj formimin më të plotë në fushën e jurisprudencës duke e kthyer në një burim të rëndësishëm të diturisë aq sa ka thënë:

*“Kërkojeni një të tretën e diturisë nga shtëpia e Aishes.”* (Dejlemî, II, 165/2828)

Hiz. Aishja përmes nipërve ka ndarë diturinë e saj në rreth 300 nxënës. Sipas Ibn-i Abbasit nuk ka dijetarë që të mos kenë përfutuar nga dituria e Hz. Aishes.

Shkalla e lartë e bujarisë dhe devotshmërisë së Hz. Aishes shihet edhe në tregimin e mëposhtëm:

I Dërguari i Allahut u varros aty ku ndërroi jetë, në shtëpinë e Hz. Aishes.

Po ashtu edhe Hz. Ebu Bekri pati nderin të varrosej pranë Resullullahut. Tashmë kishte mbetur vetëm një vend dhe Hz. Aishja e dëshironte atë për vete. Mirëpo si rrjedhojë e dëshirës së madhe të Hz. Omerit për t’u varrosur pranë të Dërguarit të Allahut, ajo nuk e refuzoi kërkesën e tij. Hz. Aishja tregon:

*“Kur hyja në dhomën time aty ku ishte varrosur i Dërguari i Allahut dhe babai im e hiqja mbulesën pa ndrojtje sepse e dija që aty ishte bashkëshorti im dhe babai im, por kur u varros Hz. Omeri betohem se turpërohesha aq shumë sa kurrë nuk e hoqa mbulesën time.”* (Ahmed, VI, 202; Hâkim, III, 63/4402)

Secila prej nënave të besimtarëve (bashkëshortet e Pejgamberit) ishin burim virtytesh më vete. Hz. Zejnebi merrej me përpunimin e lekurës dhe me të ardhurat që siguronte u dhuronte nevojtarëve. Në ndodhinë e Hudejbijes i Dërguari i Allahut u konsultua me Hz. Ummu Selemen dhe mbeti shumë i kënaqur nga përgjigjja e saj e urtë.

Secila prej tyre, jetoi një jetë me devotshmëri dhe përkushtim ashtu siç dëshironte i Dërguari i Allahut. Asnjëherë nuk iu ankuan. Pasuria e tyre më e madhe ishte qetësia shpirtërore. Kënaqësia më e madhe ishte ngopja e të uriturve. Shqetësimi më i madh i tyre ishte si të udhëzonin dhe mësonin gratë e besimtarëve dhe si t’i ndihmonin vajzat e reja të përgatisnin pajën e martesës.

*“Mos ki frikë!  
Allahu kurrë nuk do të  
të turpërojë! Sepse ti i  
ruan lidhjet farefisnore,  
thua të vërtetën, i  
ndihmon nevojtarët, u  
fal fukarenjve, i mirëpret  
mysafirët dhe i mbron  
ata të cilëve u është bërë  
padrejtësi.”*

(Buhârî, Bed‘u’l-Vahj, 1; Muslim, Îmân, 252; Ibn-i Sa‘d, I, 195)



# Nëse do të bësh plane FILLO NGA VETJA

— Mehmet Dinç —

Njeriu në këtë botë do më shumë fëmijën e vet. Kjo dashuri, pa dyshim sjell me vete edhe pritshmëritë. Prindërit duan që fëmija i tyre të jetë mirë, të jetë gjithnjë mirë, të jetë më mirë. Kjo dëshirë është mjaft e natyrshme dhe e drejtë. Sidoqoftë, siç thonë edhe etërit tanë, në këtë botë ekziston një fëmijë që është më i miri dhe çdo prind është zotëruesi i këtij fëmije kaq të mirë. Por nëse dëshira e mirë që përmendet këtu, bëhet shkak që prindërit të fillojnë ta shikojnë fëmijën e tyre si një plan dhe ta kurdisin atë si një aparaturë mekanike, në përputhje me planet që përfytyrojnë vetë, atëherë këtu ka një problem. Sepse njeriu nuk është një projekt, nuk ngjason fare me një makinizëm. Çdo fëmijë ka tepricat dhe mangësitë e botës së vet. Dikujt prej tyre i ka ardhur që prej lindjes, e dikush tjetër e ka fituar më pas; kanë imagjinatat dhe planet e tyre, kanë të dashur dhe të urryer, kanë mundësi apo pamundësi për të vepruar. Shpërfillja e të gjitha këtyre dhe shndërrimi i fëmijës në një mekanizëm

që merr çfarë t'i japësh, bën çfarë t'i thuash dhe shkon atje ku e dërgon, është shpenzim i tepruar i kohës, shpenzim i marrëdhënieve dhe i së ardhmes, si për prindërit ashtu edhe për fëmijën.

Në fakt, shumica e prindërve i dinë të gjitha këto, por megjithatë, përsëri para nesh del një humnerë e thellë midis teorisë e praktikës dhe prindërit vazhdojnë përpjekjet e tyre, pavarësisht çdo gjëje, për të rritur fëmijë projektimi. Mirëpo, përse prindërit duhet t'i realizojnë me këmbëngulje disa gjëra mbi fëmijët e tyre, megjithëse i vendosin apo nuk i vendosin emrin projekt (*plan*) veprave që bëjnë?

Pa dyshim, përgjigjja e vetme e kësaj pyetjeje ndryshon sipas faktit se si e shikojnë prindërit të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen, në kuadër të kësaj pikëpamjeje dhe mënyrës së pozicionimit të vetes apo familjes së tyre.

Për shembull: disa prindër duan t'i mbyllin llogaritë sipas të kaluarës së tyre në kurriz të

*Çdo fëmijë ka tepricat dhe mangësitë e botës së vet. Dikujt prej tyre i ka ardhur që prej lindjes, e dikush tjetër e ka fituar më pas; kanë imagjinatat dhe plane e tyre, kanë të dashur dhe të urryer, kanë mundësi apo pamundësi për të vepruar. Shpërfillja e të gjitha këtyre dhe shndërrimi i fëmijës në një mekanizëm që merr çfarë t'i japësh, bën çfarë t'i thuash dhe shkon atje ku e dërgon, është shpenzim i tepruar i kohës, shpenzim i marrëdhënieve dhe i së ardhmes, si për prindërit ashtu edhe për fëmijën.*



fëmijëve, fletorja e (*Ilogarive*) të të cilëve nuk është mbyllur ende. Ato çfarë ata nuk arritën dot t'i bënin dhe të kishin sukses në të kaluarën në pamundësi, me injorancë dhe provincialitet etj., dëshirojnë që fëmijët e tyre t'i bëjnë dhe t'ia dalin mbanë. Mobilizohen për të realizuar ëndrrat që nuk u realizuan në atë kohë, kur nuk shfrytëzuan dot kohën, përpjekjet dhe mundësitë e tyre. Por ajo ëndërr që nuk u realizua është ëndrra e tyre e porealizuar, jo e fëmijëve të tyre. Qëndrojnë me këmbëngulje mbi anglishten e fëmijëve, megjithëse në asnjëfarë mënyre nuk e rregullojnë dot anglishten e tyre; nëse nuk kanë aftësim muzikor, kërkojnë të marrin mësim muzikor; nëse janë të zhgënjyer në konceptin e pozitës, bëjnë çdo gjë që fëmijët e tyre të arrijnë një pozitë të caktuar.

Nëse fëmijët e tyre nuk tregojnë dëshirë të madhe për ëndrrat e prindërve të tyre, prindërit vënë në pikëpyetje në fillim aftësinë e fëmijëve, pastaj moralin e tyre, të cilët kanë qëndruar kaq indiferentë ndaj ëndërrave të tyre, vlera e të cilave është e pagjyqeshme, që e kanë bartur përbrenda si një nyjë për vite të tëra. Gjithsesi, për të mos realizuar një ëndërr të tillë, ose duhet të jesh i paaftë ose dembel. Megjithatë, nuk ka asnjë shkak që fëmija të shkojë pas asaj ëndrre. Prandaj, mund të mos jetë i motivuar aq sa dëshiron, siç kanë dëshiruar prindërit e tyre. Sa mund të jetë i motivuar njeriu me një ëndërr që nuk e ka thurur vetë?

Disa prindër nuk janë të lumtur nga gjendja e tyre e sotme. Ata nuk ia kanë dalë dot të bëhen ashtu siç dëshirojnë dhe pas kësaj ore, duket si e pa mundur të bëhen. Në këtë rast, e vetmja mënyrë për të dalë nga kjo, është që njerëzit t'i rrisin fëmijët e tyre ashtu siç duhet. Fëmija më i kualifikuar, më i veçantë, më i aftë dhe më i talentuar do të jetë fëmija i tyre, që nëse askush nuk ka folur për ta, të flasë për fëmijët e tyre. Për një prind që nuk ka asnjë pozitë të mjaftueshme për vete, të jetë babai i një fëmije që flitet gjithnjë rreth tij, është një pozitë mjaft e mirë. Për këtë arsye, ata ngarendin fëmijët e tyre nga një kurs në tjetrin, nga një provim në tjetrin, nga kjo shkollë në një shkollë tjetër. E mbajnë gjithnjë lart thuprën, që fëmijët e tyre të jenë gjithnjë në lëvizje, të kryejnë vazhdimisht ndonjë gjë dhe t'ia dalin mbanë.

Nuk është problem, nëse nuk e di se për çfarë



e kryen diçka apo përse ia ka dalë mbanë, do të vijë dita për ta kuptuar. Nga ana tjetër, në botën e fëmijës dominojnë disa fakte krejt ndryshe. Por rritet një njeri me një identitet dhe personalitet të shtypur e të nëpërkëmbur dhe që vrapon vazhdimisht me një ndjenjë pamjaftueshmërie pambarim, duke mos ditur se çfarë kërkon. Ndoshta është i sigurt nga sukcesi i së nesërme, por është vazhdimisht në dyshim për lumturinë e vet.

Disa prindër kanë aspirata për të ardhmen. Prandaj, duan që fëmijët e tyre ta jetojnë plot e përplot jetën e tyre, të cilën nuk

e jetuan dot vetë. Por për ta pasur të mbushur plot e përplot, punojnë për ta mbushur, duke parë të nesërmen krejtësisht prej ditës së sotme.

Mendojnë që fëmijët e tyre ta fillojnë të ardhmen të përgatitur, për arsye se vetë ata janë zënë të papërgatitur për ditët e sotme. I orientojnë fëmijët e tyre drejt profesioneve të famshme si profesione të së ardhmes, i marrin menjëherë aparatet që kanë mësuar t'i përdorin si teknologji e së nesërme dhe dëshirojnë t'i mësojnë edhe fëmijët e tyre. Përpiqen t'i rrisin fëmijët e tyre përtej kohës që kanë jetuar vetë. Për këtë arsye, fëmijët e tyre mbeten të detyruar të takohen kryesisht me më të mëdhenj se vetja, në vend të bashkëmoshatarëve të tyre. Për këta fëmijë është sikur të kenë veshur rroba shumë të gjera dhe të papërshtatshme që i shqetëson ata.

Çfarëdolloj shkakut të "*pranueshëm*" të kenë prindërit për veten e tyre, fëmija nuk është projektplan. Aktualja ose e ardhmja e tyre, nuk është fëmija apo bashkëshortja e tij, por vetëm dhe vetëm vetvetja. Për këtë arsye, nëse do të bëjë një plan, duhet ta bëjë mbi veten e vet. Është e padrejtë të presë nga i biri që është më i vogël dhe pa përvojë një njeri, i cili ekziston vetëm në kokën e tij. Natyrisht që prindërit duan të mirën e fëmijës së vet. Prandaj, ajo që kërkohet përsëri është të bëjnë plane mbi veten e jo mbi fëmijën e vet.

Sidoqoftë, fëmija ndikohet më shumë nga sjelljet e prindërve sesa nga fjalët e tyre; një prind që e kontrollon veten, që programon plane mbi veten e vet, pa dyshim që do të rrisë fëmijë më të drejtë se një prind që përpiqet ta konsiderojë fëmijën e vet si një plan dhe ta trajtojë si të tillë, duke mos bërë asgjë që ka lidhje me të dhe me qortime e ndëshkime.





# MIRËSIA E *Dashurisë*


— Zejneb Allbajrak —

Allahu i Lartësuar e ka krijuar këtë botë për njerëzit dhe e ka pajisur me begati që të kënaqet zemra e njeriut. E ka bërë atë superior ndaj genieve të tjera, dhe na ka dhënë disa ndjenja të caktuara. Një prej ndjenjave më të rëndësishme është “dashuria”. Burimi i dashurisë është Allahu. Para se foshnjat të vijnë në jetë, Allahu vendos dashuri në zemrën e nënave të tyre. Kur foshnjat vijnë në jetë dhe rriten, edhe dashuria e nënave të tyre rritet. Nëse njerëzit nuk do të kishin dashuri në zemrat e tyre, nuk mund ta toleronin njëri-tjetrin. Dijetari i madh islam, Mevlana, në lidhje me dashurinë ka thënë këtë fjalë: “Ujrat e turbullta dhe të papastra, bëhen të pastra e të kulluara nga dashuria. Nga dashuria hallet zgjidhen. Nga dashuria ringjallen të vdekurit. Nga dashuria padishahët (*sulltanët*) bëhen shërbëtorë. Kjo dashuri është si rezultat i diturisë.”

Dashuria e parë është dashuria dhe ndjenja e dashamirësisë për Allahun. Allahu është ai që e

krijoi njeriun nga mosekzistenca, e mban gjallë, e përçon në pjekuri me krijimin e cilësive të përsosura, krijon shkakun e pjekurisë dhe udhërrëfen përdorimin e këtyre shkaqeve. Personi që do atë që vjen nga dikush tjetër dhe atë (*prindin*) që e solli atë; pa dyshim që e do edhe Atë që e krijoi nga mosekzistenca, që e mban gjallë që ekziston nga zanafilla e deri në përjetësi dhe ka krijuar edhe të tjerët. Ai që nuk e do Atë, vjen nga injoranca për veten dhe për Zotin e tij. Dashuria është fryt i zgjuarsisë, prandaj vjen pas zgjuarsisë. Pa dituri (*njohje të Allahut*) nuk ka as dashuri. Allahu i Lartësuar na urdhëron kështu: “**..njerëz, që i do dhe që e duan (Atë); (e besojnë Atë) të përulur me besimtarët dhe të ashpër me femohuesit; që luftojnë në rrugën e Allahut dhe nuk i tremben qortimit të asnjë qortuesi (për shkak të besimit dhe Islamit)...**” (Maide, 54)

E dyta, është dashuria për Profetin tonë të nderuar. Dashuria për Profetin, (a.s), është një nga



kushtet e Islamit dhe të besimit. Ai që beson ekzistencën dhe njëshmërinë e Allahut, beson edhe te profeti i fundit që dërgoi. Prandaj, çdo mysliman duhet të dëshmojë se Profeti është një i dërguar nga Allahu dhe të vërtetojë të gjitha fjalët dhe veprat që vijnë prej tij. Dashuria për Profetin, (a.s), është një nga treguesit më të rëndësishëm të adhurimit. Sepse Profeti i dashur, (a.s), urdhëron kështu në hadithet Sherife të Buharit dhe Muslimit që transmeton Enes b. Malik, (r.a): *“Asnjë prej jush nuk ka besim-iman (të plotë), derisa unë të jem për të më i dashur se babai i tij, se fëmija i tij dhe se të gjithë njerëzit bashkë.”* (Buhari, Iman: 8; Muslimi, Iman, 69, 70)

Pa dyshim që njeriu është krijuar me një gjendje shpirtërore që ndjen dashuri kundrejt atij që i bën mirësi. Njeriu e do atë që i bën mirësi dhe ia kthen atij me dhurata. Nëse një person e do dikë dhe e bën këtë, atëherë si do të jetë qëndrimi ynë kundrejt Profetit tonë të nderuar që solli udhëzimin hyjnor për të gjitha botët, që është shkaku i mëshirës për gjithë njerëzimin, që ua mësoi njerëzve librin dhe urtësinë dhe që shpjegoi rrugën e arritjes së lumturisë së dynjasë (*kësaj bote*) dhe ahiretit (*botës tjetër*)? Për të arritur lumturinë e dynjasë dhe ahiretit, e gjithë frymëmarrja që harxhohet në rrugë të Islamit ka një qëllim; dhe

ai është të fitosh dashurinë dhe kënaqësinë e Allahut. Mënyra e vetme është ndjekja e Sunetit të të Dërguarit të Allahut, (a.s).


E treta, është dashuria që kemi për prindërit tanë. Bamirësia ndaj prindërve dhe sjellja kundrejt tyre me respekt, zë një vend të veçantë në Islam. Ebu Hurejre, (r.a), ka thënë: “Një burrë, duke ardhur tek i Dërguari i Allahut, (a.s), i thotë: ‘Kush është ai kundrejt të cilit duhet të sillem mirë?’ I Dërguari i Allahut, (a.s), i thotë: ‘Nëna jote!’ Burri e pyet: ‘Po pas saj kush është?’ ‘Nëna jote!’ - iu përgjigj. Burri e pyet përsëri: ‘Kush vjen pas saj?’ ‘Nëna jote!’ - i thotë. Burri e pyet përsëri: ‘Kush vjen pas saj?’ ‘Babai yt!’ - i përgjigjet.” (Buhari, Edeb 2; Muslimi, Birr ,1)

Një nga kushtet e domosdoshme është që të vazhdojë në mënyrë të shëndetshme dhe të sigurt ky raport “e drejtë-detyrë”, që buron nga dashuria dhe respekti që krijoi Allahu midis prindërve dhe fëmijëve pa degjenerimin e llojit njerëzor. Allahu i Lartësuar na urdhëron kështu në Kuranin e Madhërisëm: ***“Ne e kemi urdhëruar njeriun që t’i nderojë prindërit e vet. Nëna e ka mbartur atë, duke duruar mundim pas mundimi, e ndarja e tij (nga gjiri) është brenda dy vitesh. Prandaj, Ne i thamë atij: ‘Bëhu falënderues ndaj Meje dhe prindërve të tu!’”*** (Lukman, 14)

Artikullin tonë le ta përfundojmë me një fjalë të Mevlanës: “Nëse dëshiron të fitosh një zemër, mbill farën e dashurisë. Nëse dëshiron të fitosh xhenetin, hiq dorë nga përhapja e gjembave në rrugë.”

Me dëshirën për të mos munguar gonxhet e dashurisë në zemrat tuaja...





# Pema e hurmave e Ebu Xhehlit në xhenet

— Nuredin Jëlldëz —

Jam i sigurt se çdokush që lexon këtë titull, në fillim fare do të shastiset, sepse Ebu Xhehli, armiku më i madh që ka pasur feja islame, qoftë me fe, qoftë me logjikë, nuk mund të ketë ndonjë pemë hurmash në xhenet.

Raportohet se një natë Profeti ka parë në ëndërr sikur gjendej brenda në xhenet dhe aty sheh një pemë me hurma që i pëlqen pa masë. Ai pyet se e kujt ishte ajo pemë, një zë i thotë se ajo është pema e Ebu Xhehlit. Kur dëgjon këto fjalë, Profeti hutohet. Pyet veten: “Si është e mundur të ketë një pemë në xhenet për Ebu Xhehlin, personin që nuk do të hyjë kurrë brenda në xhenet?”

Ebu Xhehli ka qenë personi që nuk ka lënë gjë pa bërë, në mënyrë që ta ndalonte përhapjen e fesë islame. Ai rrihte dhe torturonte myslimanët e dobët, si dhe kërcënonte myslimanët e pasur dhe me pozitë në shoqëri duke përhapur shpifje rreth tyre dhe duke organizuar embargo tregtare ndaj tyre. Madje ai kishte dashur t’ia shtypte kokën me gur Profetit ndërsa ai duke u falur ishte në pozicionin e sexhdes dhe do ta kishte bërë këtë gjë, në qoftë se nuk do ta pengonte një forcë hyjnore e mbinatyrshe që nuk e linte t’i afrohej. Ebu Xhehli ishte në krye të personave që patën provokuar betejën e Bedrit. Ai i nxiste mushrikët për luftë, përsëriste fjalët se “do t’u mësojmë mirë myslimanëve se çfarë do të thotë të braktisësh adhurimin e idhujve Lat dhe Menat” dhe në çdo rast që gjente rrinte duke fyer të Dërguarin

e Allahut dhe myslimanët. Ky armik i përbetuar i fesë islame u vra në betejën e Bedrit. Profeti e pati quajtur Ebu Xhehlin “faraonin e umetit mysliman dhe koka e madhe e qafirëve”, prandaj kur pati mësuar se Ebu Xhehli qe vrarë e pati falënderuar Allahun.

Ebu Xhehli kishte një djalë që quhej Ikrime. Ikrime nuk i linte gjë mangur të atit Ebu Xhehlit në armiqësinë që ushqente ndaj fesë islame. Ikrime pati luftuar në betejën e Bedrit përkrah të atit dhe u pati shkaktuar shumë dëme myslimanëve. Ai ishte njëri nga kalorësit më të famshëm që kishin mushrikët. Kishte marrë pjesë në grupin e Kurejshëve, të cilët duke shkelur marrëveshjen e Hudejbijes patën ndihmuar fisin e Benu Bekir që të vrisnin anëtarët e fisit Huzaa, të cilët ishin nën mbrojtjen e myslimanëve. Ai pati folur me të madhe duke thënë se “këmba e Muhamedit nuk do të shkelte në Mekë për sa kohë që jetonte edhe mushriku mekas i fundit.” Kur Profeti Muhamed çliroi Mekën, Ikrime qe arratisur nga qyteti. Ai ishte i pari në listën e personave që Profeti pati urdhëruar të vriteshin për shkak të mizorive dhe krimeve që kishin kryer. Ikrime kishte një bashkëshorte të zgjuar që quhej Umu Hakim. Kur u çlirua Meka, ajo së bashku me gruan e Ebu Sufjanit, Hindin patën formuar një grup prej dhjetë grash dhe kishin shkuar tek Profeti Muhamed (a.s.), që t’i deklaronte atij se pranonte të hynin në fenë islame. Pasi kishte pranuar fenë

islame, Umu Hakim i pati thënë Profetit: “O i Dërguari i Allahut! Ikrimes i hyri frika kur pa se Meka po binte në duart tuaja dhe është arratisur drejt Jemenit. Ai ka frikë se ti do ta vrasësh, prandaj të përgjerohem që t’ia falësh jetën.” I Dërguari i Allahut tha: “Atij ia fala jetën.”

Pas këtyre fjalëve Umu Hakim kërkoi leje që të shkonte dhe të gjente të shoqin Ikrime. Ajo dërgoi skllavin e saj që ta gjente atë sa më parë. Skllavi arriti ta gjente Ikrimen në njërin prej limaneve të Tihamesë, teksa po përgatitej të hipte në anije për t’u arratisur sa më larg. Pas disa fjalësh që këmbu Ikrime me pronarin e anijes Umu Hakim i tha këto fjalë Ikrimes, në mënyrë që ta bindte atë:

- Kam ardhur tek ti pasi jam ndarë nga personi që tregohet më i kujdesshëm se çdokush tjetër në lidhje me të drejtat që kanë antarët e farefisit ndaj tij. Prej njeriut më të vyer dhe më të mirë që ka bota. Mos e shkatërro veten tënde më kot. Unë i kam marrë fjalën të Dërguarit të Allahut se jeta jote është e sigurt.

Ikrime u bind dhe të dy së bashku u kthyen drejt Mekës.

Kur po i afroreshin Mekës, Profeti u tha sahabëve të tij:

- Drejt Mekës po vjen Ikrime, biri i Ebu Xhehlit. Ai e ka pranuar fenë islame, prandaj askush të mos thotë asnjë fjalë të keqe në lidhje me të atin. Fjala e keqe për të vdekurin vetëm sa e hidhëron pasardhësin e tij të gjallë, sepse atij në vetvete nuk i bën keq.

Kur Ikrime u shfaq te dera e çadrës, Profeti u ngrit në këmbë dhe e mirëpriti duke u përqaftuar me të. Profeti me këtë rast i tha:

- Mirë se erdhe, o kalorës mërgimtar! Një njeriu të zgjuar si ti i ka hije të pranojë fenë islame!

Umu Hakim i kujtoi Ikrimes sigurinë që i kishte dhënë Profeti, prandaj Ikrime tha shehadetin dhe u bë mysliman. Pasi tha shehadetin, Ikrime tha:

- Për Zotin, ti të fton vetëm drejt së vërtetës dhe së drejtës, drejt të bukurës dhe fisnikes. Ti ke qenë personi më i mirë, më i besueshëm dhe më fjalëdrejti në mesin tonë edhe përpara se të vinte shpallja hyjnore.

Kur dëgjoi këto fjalë, i Dërguari i Allahut uli kokën nga turpi dhe modestia.

Ikrime i kujtoi Profetit armiqtë e tij të shkuar dhe pati shtuar këto fjalë:

- O i Dërguari i Allahut! Unë dua që ti të kërkosh falje për mua nga Allahu për gjithë armiqtë që kam treguar ndaj teje, për gjithë hapat që kam hedhur në shërbim të përhapjes së shirkut apo për të shkuar në të gjitha vendet që të dilja ty kundër, për të gjitha fjalët e rënda që të kam thënë në sy apo pas krahëve tuaj!

I Dërguari i Allahut kërkoi nga Allahu që Ai t’ia falte gjynahet që kishte bërë në të kaluarën Ikrime. Ky veprim e gëzoi së tepërmi Ikrimen, i cili tha:

- O i Dërguari i Allahut! Nuk do të më ndalë asgjë deri sa të shpenzohet dyfishin e përpjekjeve në rrugën e Allahut, në krahasim me përpjekjet që kam bërë për t’i larguar njerëzit nga rruga e Allahut si dhe të marr pjesë dy herë më shumë në betejat për hir të Allahut, krahasuar me betejat që kam marr pjesë në luftën kundër Tij!

Ikrime dhe Umu Hakim ricelebruan martesën e tyre, tashmë të dy si myslimanë.

Pasi u bë mysliman Ikrime, me të dëgjuar se ndonjë kurejsh kishte në shtëpi ende ndonjë idhull sado të vogël në përmasa, shkonte tek shtëpia e tij dhe ia thyente.

Në kohën e xhahilijetit ai kishte qenë njëri ndër tregtarët më të mëdhenj të tregtimit të idhujve. Ai mernte në dorë Kuranin dhe mes lotësh e puthte duke thënë: “Fjala e Zotit tim! Libri i Zotit tim!”

Ikrime pati treguar trimëri të rrallë në betejat e Riddes, duke mos ia ndarë sytë. Atyre myslimanëve që e këshillonin

të bënte kujdes kur hidhej në fushën e betejës, ai u përgjigjej: “Unë nuk jam treguar i kujdesshëm kur kam luftuar më parë për hir të Latit e Uzasë dhe të tregohem i kujdesshëm tani që luftoj për hir të Allahut dhe të Dërguarit të Tij?! Jo! Kurrë nuk kam për ta bërë këtë gjë!” Kur vendosi të zbriste nga kali dhe të luftonte si ushtar këmbësor, Halid b. Velid i tha: “Mos! Ka për të qenë shumë e rëndë për myslimanët, në qoftë se ke për t’u vlarë në luftë! Ikrime iu përgjigj: “O Halid! Mos më pengo dhe mos më dil para! Ti nuk i ke bërë aq shumë dëme në të kaluarën tënde të Dërguarit të Allahut! Unë dhe babai im kemi qenë armiqtë më të egër dhe të përbetuar të të Dërguarit të Allahut!” Ai ra shehid së bashku me të birin, Amrin. Pas betejës Halid b. Velid ua mori kokat në prehër dhe teksa ua pastronte fytyrat me ujë nga plagët e gjakut, rënkonte sesi

*Unë dua që ti të kërkosh falje për mua nga Allahu për gjithë armiqtë që kam treguar ndaj teje, për gjithë hapat që kam hedhur në shërbim të përhapjes së shirkut apo për të shkuar në të gjitha vendet që të dilja ty kundër, për të gjitha fjalët e rënda që të kam thënë në sy apo pas krahëve tuaj!*



nuk kishte rënë edhe ai vetë shehid.

Kur pati parë në ëndërr pemën e hurmës në xhenet të Ebu Xhehlit, në fillim fare Profeti nuk i kishte dhënë kuptim asaj. Kur Ikrime, djali i Ebu Xhehlit u bë mysliman, ai i pati thënë kështu gruas së tij Umu Seleme: “O Ummu Seleme! Ja kush paska qenë pema e hurmës në xhenet e Ebu Xhehlit! Ashtu sikur kishte ngjarë me profetin Jusuf edhe profeti i dha shpjegim shumë më vonë kur Ikrimeja pati pranuar që të bëhej mysliman. *“Allahu e nxjerr të gjallin prej të vdekurit dhe të vdekurin prej të gjallit.*” (Rum, 19) Ebu Xhehli ishte shpirtërisht i vdekur edhe kur ishte në jetë dhe iku nga kjo jetë duke mos manifestuar as shenjën më të vogël të gjallërimit shpirtëror. Madje edhe në momentet që po vdiste ai nxirrte në pah mendjemadhësinë e femohimit dhe kokëfortësinë e mosbesimit.

Edhe djali i tij Ikrime jetoi në këtë botë duke qenë i vdekur “shpirtërisht”, por u ngjall në momentin që i vuri veshin thirrjes hyjnore: ***“O ju që keni besuar! Kur t’ju ftojë Profeti në ato gjëra që janë jetë për ju, dëgjojeni thirrjen e Allahut dhe të Dërguarit të Tij.*”** (Enfal, 24)

Pema e hurmës, e parë në ëndërr, komentohet si begati. Në rast se shihet një pemë hurme në xhenet, ajo komentohet si një begati dhe mirësi e madhe. Megjithëse në fillim Ikrime i kishte shkaktuar shumë dëme bashkësisë myslimane, ai arriti që ta kompensonte disafish dëmin e kryer duke treguar një guxim dhe sakrificë të paparë në rrugën e fesë islame në fund të jetës së tij. Në momentin që po pranonte fenë islame, kishte premtuar se do të tregonte të paktën në rrugën e fesë islame dyfishin e zellit që kishte treguar më parë në luftën kundër saj. Ai e mbajti fjalën që dha. Arriti shkallën e shehidit të cilën nuk e arriti as vetë Halid b. Velidi, megjithëse e kishte zili për këtë gjë.

Ëndrra që pa i Dërguari i Allahut që e mbushur me mësim për t’u marrë parasysh. Nga kjo histori mësojmë se sa e gabuar është të vlerësojmë njerëzit duke parë prejardhjen e tyre dhe pozitën e tyre të një periudhe kohore të caktuar. Ashtu sikurse një i gjallë me shpirt si Ikrime rridhte nga gjaku i Ebu Xhehlit një njeriu të vdekur me shpirt që në këtë jetë, në jetë mund dhe ka ndodhur edhe e kundërta. Madje kemi raste kur biri i Profetit apo gruaja e tij

nuk patën përfituar aspak nga fryma gjallëruese e shpalljes hyjnore, por u patën mbytur brenda atmosferës helmuese të mosbesimit (kufr) dhe patën vdekur duke qenë mosbesimtar. Kështu pati ngjarë me birin e Nuhut dhe me gruan e Lutit...

Përveç vendimmarrjes së Ikrimes për ringjalljen e tij shpirtëror të simbolizuar nga pema e hurmës në xhenet, nuk duhet harruar edhe roli i mirësisë hyjnore të Allahut dhe qëndrimi i të Dërguarit të Allahut. Në qoftë se i Dërguari i Allahut nuk do t’ia kishte falur Ikrimes ato që kishte bërë më parë kundër tij, Ikrimeja nuk do të mund të shndërrohej në pemën e bekuar të hurmës, përkundër do të mbetej si një cung druri i xhehenemit.

Mësimi më i rëndësishëm që mund të nxjerrim nga kjo histori është që themelore nuk është të vrasësh, por të falësh jetë dhe ta shndërrosh armikun në mikun tënd. Ta bësh mikun armik është shumë e lehtë, por ta kthesh armikun në mik është jashtëzakonisht e vështirë. Para së gjithash, duhet të qëndrosh larg çdo veprimi dhe qëndrimi që nxit dhe provokon armiqësinë. Duke mos ia përplasur në fytyrë gabimet e mëparshme, por duke e rrokur atë me fjalët “Mirë se na erdhe, o kalorës mërgimtar!”, si dhe duke ua ndaluar të pranishmëve që të flisnin keq rreth Ebu Xhehlit, faraonit të umetit mysliman me mendimin se kjo do ta bënte të ndihej keq të birin, Profeti Muhamed (a.s.), qe sjellë jashtëzakonisht njerëzor, në mënyrë që ta shndërronte Ikrimen, armikun e dikurshëm të përbetuar të fesë islame, në luftëtarin trim të fesë islame. Xhiahadi më fisnik është ai që arrin t’i shndërrojë njerëzit nga cungje xhehenemi, në pemë hurme xheneti.

Të gjithë dalin të fituar kur armikun e bën mikun tënd, pasi njeriu i rrezikshëm në këtë mënyrë do të shndërrohet në një person të dobishëm për veten dhe për të tjerët. T’ia fitosh zemrën njeriut, do të thotë të fitosh gjënë më të vyer që ai ka. A ka fitore më të madhe sesa ta shndërrosh njeriun që pranonte të vdiste për hir të idhujve Lat dhe Uzan, në njeriun që është gati të sakrifikojë gjithçka për hir të Allahut? Këto rreshta do t’i përmbyllim me këtë ajet të Kuranit, ku thuhet:

***“Nuk barazohet e mira me të keqen! Të keqen ktheje me të mirë e atëherë armiku yt do të të bëhet menjëherë mik i ngushtë.*”** (Fussilet, 34)

*Të gjithë dalin të fituar kur armikun e bën mikun tënd, pasi njeriu i rrezikshëm në këtë mënyrë do të shndërrohet në një person të dobishëm për veten dhe për të tjerët. T’ia fitosh zemrën njeriut, do të thotë të fitosh gjënë më të vyer që ai ka.*



# *Dbikri dhe vitaliteti me Kurandin*

— Prof. dr. Sadik Këllëç —

Si krijesa që ekzistojmë brenda në kohë dhe gjallojmë brenda një limiti të caktuar të saj, ndër-gjegjësimi mbi konceptin e kohës është nja nga mundësitë e mëdha që i ofrohen njeriut. Aty ne përftojmë ndjenjën e unit e zhvillojmë atë dhe mbi të ndërtojmë universin tonë fizik dhe kulturor!

E thënë me fjalët e Fahredin Raziut (vd. 606/1209), koha është “lumi që buron nga fundet e malit të përjetësisë pa fillim dhe rrjedh drejt malit të përjetësisë pa mbarim.” Pikërisht ky udhëtim i lumit na kujton neve se sa kalimtarë jemi në këtë jetë. Teksa e konsumojmë kohën në linjën e kësaj bote dhe të kësaj jete, nga një anë koha formësohet dhe hedh shtat duke na bërë që të përjetojmë emocionin e papërballueshëm të ekzistencës, ndërsa nga ana tjetër ajo bën të ngadalësohet ritmi i ndjenjave, emocioneve dhe shpërthimeve morale që janë në pronësinë shpirtërore të ekzistencës sonë. Kështu që koha bllokun me mbetjet e saj damarët e ekzistencës dhe të ritmit shpirtëror.

## **1. KOHA E KALUAR, NDJESHMËRI E VYSHKUR...**

Si përfundim, koha na ka rrethuar neve në çdo anë. Një moment të caktuar të kohës biem në tunelin e mitrës së nënës, pastaj gjatë udhëtimit tonë formohemi në formë embrioni dhe në fund fare, kur shfaqemi në këtë botë në formën e njeriut, klithmat tona të para marrin kuptim brenda kufijve të

kohës dhe të hapësirës duke hyrë kështu në botën e ekzistencës. Ai lumë i padukshëm i quajtur kohë ka shumë kohë që ka nisur të rrjedhë, madje çdo gjë ka nisur të marrë formë së bashku duke filluar që nga rrahja e zemrës, formimi dhe zhvillimi i qelizave, formimi i zemrës dhe i trurit, duke mbushur në këtë formë botën tonë të brendshme dhe të jashtme. Brenda kësaj rrjedhe duhet menjëherë të ndalemi një hop dhe të lexojmë mesazhet kuptimplotë që na ka dërguar Zoti i Mëshirshëm me anë të rrahjeve të zemrës. Në emër të hartimit të një harte për rrugën që do të ndjekë aventura e ekzistencës sonë brenda rrjedhës së kohës dhe në emër të marrjes në dorë të iniciativës, ne duhet t'i kushtojmë shumë rëndësi rrahjes së zemrave, ashtu siç është shprehur edhe poeti egjiptian me origjinë turke, Ahmet Shevki (vd. 1932):

*“Në qetësi rrahja e zemrës më tha:*

*‘Mos harro se jeta përbëhet nga minutat dhe sekondat, pra!’*

Në lidhje me paradoksin mes vitalitetit të besimit me anë të kohës na e tërheq vëmendjen vetë Kurani i madhërueshëm! Në ajetin 16 të sures Hadid mësojmë se për besimtarët dy janë mjetet që ata të arrijnë të mbajnë gjallë dhe vitale përherë ndjeshmërinë e tyre shpirtërore përballë ndikimit zbehës dhe gërryes të kohës: dhikri (përmendja e Zotit) dhe leximi i Kuranit.



**“A nuk ka ardhur koha për besimtarët e vërtetë, që zemrat e tyre të përulen para këshillave të Allahut dhe para së Vërtetës që Ai ka shpallur e të mos bëhen si ata, që iu është dhënë Libri më parë?! Me kalimin e një kohe të gjatë, zemrat e tyre u ngurtësuan dhe shumë syresh janë të pabindur?!”**

Në periudhën e shpalljes hyjnore ky ajet i shpallur kishte të bënte me çortimin e një grupi të caktuar të besimtarëve për shkak të manifestimit nga ana e tyre e një gjendjeje përtacie dhe humbjeje të dinamizmit dhe fuqisë së besimit (Alusi, Ebu'l-Fadl Shihabudin, Ruhul-Me'ani, Bejrut, XXVII, 179.), por në të vërtetë në ajetin e mësipërm përdoret një shprehje më e përgjithshme kur thuhet: **“...për ata që kanë besuar...”**, duke përfshirë kështu të gjithë besimtarët në këtë paralajmërim hyjnor. Arsyeya e shpalljes së këtij ajeti është si më poshtë:

Kishin kaluar afërsisht trembëdhjetë apo shtatëmbëdhjetë vjet që kur kishte ardhur shpallja e parë. Aromat e shpalljes hyjnore, sihariqet nga qielli, vetëtimat në mes të errësirës, drita drejt horizonteve të së ardhmes kishin filluar të reshonin palë-palë. Sqarimi që i ka bërë Ibn Mesudi (vd. 32/652) arsyen e shpalljes së këtij ajeti me aromë dhe freski të përhershme është shumë shokuese për besimtarin! Në lidhje me këtë ajet, që duhet të jetë shpallur në periudhën e Mekës, ai ka thënë: “Mes periudhës kur ne u bëmë myslimanë dhe momentit që u shpall ky ajet kishin kaluar katër vjet.” (Ibn Kethir (vd. 774/1372), Ebu'l-Fida, *Tefsiru'l-Kur'ani'l-Adhim*, Bejrut, 1388/1969, IV, 310. Pjesa më e madhe e dijetarëve janë të mendimit se surja Hadid është shpallur në Medinë.) Sidoqoftë, në të dy rastet personat që u tërhiqet vëmendja dhe kritikohen me një gjuhë të ashpër janë sahabët, njerëzit modelë të idealizuar si “personalitetet e përzgjedhura që qenë dëshmitarë të shekullit të shpalljes, njerëzit më fisnikë. Profeti (a.s.) ka thënë: “Sahabët e mi janë si yjet në qiej, këdo që të merrni shembull prej tyre kenë për ta gjetur rugën e drejtë.”

Sipas Ibn Abasit (vd. 68/687) dhe Enesit (vd. 91/710) (r.a.), Allahu ua ka dhënë këtë mësim hyjnor të vlefshëm për të gjithë myslimanët deri në Ditën e Kiametit pas trembëdhjetë apo shtatëmbëdhjetë viteve që filloi shpallja hyjnore atyre e personave që për hir të besimit kishin shtëpi dhe katandi dhe kishin emigruar nga Meka në Medinë, të

cilët kishin treguar guxim dhe trimëri në formimin e një bote të re me anë të personalitetit të besimit dhe fuqisë fizike, vetëm e vetëm se Ai kishte vërejtur se në zemrat e tyre nuk ekzistonte më emocioni dhe predispozicioni i mëparshëm i besimit. Zoti i kishte qortuar me fjalë, mjetin më efektiv të paralajmërimit dhe u kishte kërkuar të ktheheshin sërish në unin e tyre thelbësor që formon aksin e ekzistencës së tyre. (Sujuti, *Ed-Durru'l-Menthur*, VI, 174; *Ruhu'l-Me'ani*, XXVII, 179)

Cili ka qenë faktori dhe motivi themelor që u bë shkak për shfaqjen e këtij paralajmërimi hyjnor të Allahut? Çfarë zhvillimesh kishin ngjarë në botën shpirtërore të besimtarëve, që Vullneti Hyjnor kishte ndjerë nevojën për të ndërhyrë? Në tefsirin e Alusit, gjendet ky raportim nga Ameshi, që prek pikërisht pikën më delikate të ngjarjes. “Sahabët e të Dërguarit të Allahut, gjatë periudhës së shpalljes

hyjnore në Meke përjetuan mungesë të madhe ushqimore dhe probleme të shumta për shkak të besimit të tyre, por kur erdhën në Medinë fituan liri të madhe dhe mundësi të mëdha materiale... Kështu që ata filluan të tregohen më shumë indiferentë në disa pika që ishin treguar shumë më të kujdesshëm më përpara.” (Ebu's-Suud (vd. 951/1544), *Irshadu'l-'Akli's-Selim*, Bejrut, VIII, 208; *Ruhu'l-Me'ani*, XXVII, 179.) Për shkak të argumentimit të konceptit të “hushu”-së në ajetin e mësipërm mund të thuhet se, ndikimi i kohës së kaluar mes mundësive materiale, bollëkut dhe moskokëçarjes mbi zemrën, manifestohet me dobësimin e forcës së aftësisë së drithërimës shpirtërore dhe të prehjes shpirtërore që përbëjnë thelbin e forcës së zemrës.

Hamdi Jazër Elmallëllë (vd. 1942) shprehet me këto fjalë, teksa nënvizon fuqinë shkatërruese të kalimit së kohës:

“Me kalimin e kohës ndjenjat plaken dhe e humbin freskinë e tyre. Dëshirat perëndojnë, zemra përjeton errësim dhe si rezultat i këtij ligji shpirtëror edhe shoqëritë fillojnë ashtu si individit të përjetojnë në zhvillimin e tyre fetar faza të ndryshme që përngjajnë me zhvillimin fizik të njeriut, siç janë foshnjëria, fëmijëria, rinia, formimi, perfeksionimi dhe plakja. Prandaj shoqëritë e plakura arrijnë të gjejnë sërish jetë në sajë të ringjalljes së tyre shpirtërore, që e arrijnë me anë të rihyrjes në freskinë shpirtërore dhe vetëm në sajë të kësaj rruge mund

*Mes marrëdhënies njeri-e mira materiale, mund të thuhet se, në qoftë se nuk i themi dot ndal pasionit të “zotërimit”, që është poli i kundërt i “ekzistencës dhe perfeksionimit”, atëherë thesari më i madh që do të humbim në këtë rast do të jetë ndjeshmëria jonë ndaj qetësisë shpirtërore dhe frikës hyjnore!*

të sigurojnë perfeksionimin e tyre.” (Elmallëllë M. Hamdi Jazër, *Hak Dini Kur'an Dili*, Istanbul, 1979, VII, 4744).

## 2. HUMBJA E NDJESISË SË PREHJES SHPIRTËRORE (HUSHU)

Në kontekstin mes marrëdhënies njeri-e mira materiale, mund të thuhet se, në qoftë se nuk i themi dot ndal pasionit të “zotërimit”, që është poli i kundërt i “ekzistencës dhe perfeksionimit”, atëherë thesari më i madh që do të humbim në këtë rast do të jetë ndjeshmëria jonë ndaj qetësisë shpirtërore dhe frikës hyjnore! Ky hadith i raportuar nga Profeti është shprehje e kësaj të vërtete: “Gjëja e parë e rëndësishme që do të humbin njerëzit do të jetë ndjenja e qetësisë së shpirtit” (et-Taberi (vd. 310/922), Ibn Xherir *Xhami'u'l-Bejan 'an Tevili'l-Kuran*, 1954, XXVII, 228.)

Çfarë është qetësia hpirtërore?

Qetësi shpirtërore është bindja e brendshme e shpirtit që është gjithësia e vërtetë e ekzistencës, bindja dhe drithërima e tij. Kundrejt kuptimit leksikor të qetësisë shpirtërore që do të thotë qetësi e madhe, hesh-tje absolute apo lëshimi i vetvetes, kuptimi shpirtëror që i jep Islami kësaj fjale është bindja e vazhdueshme ndaj Allahut, mbushje e zemrës me devotshmëri dhe frikë ndaj Tij. Të jesh i bindur se do të vijë dita që do të takohesh me Zotin, sepse një ditë do të kthehesh sërish tek Ai. (Ude Halil Ebu Ude, *et-Tatavvuru'd-Dilali*, Jordani, 1985, fq. 199-201,) E thënë me fjalët e Xhunejdit, zemra duhet të jetë e bindur totalisht para “Njohësit së të gjithë sekreteve” (ilhan Ayverdi, *Misalli Büyük Türkçe Sözlük*, istanbul, 2005, 2, 1303)

Kuptojmë se fjala është një shenjë dhe paralajmërim në kontekstin e “marrëdhënies etimologjikuptim” përballë rrezikut të myslimanit për t'u zhveshur nga ndjenjat e zemrës për t'u bërë i pandjeshëm dhe pa qetësi shpirtërore me kalimin e kohës!

## 3. GJENDJA E MOSNDJESHMËRISË SHPIRTËRORE: KASVET-I KALP

I ndjeri Alusi (vd. 1270/1854), pasi e ka cekur me fjalët : “Errësimi është burimi i fillimit të të gjitha të këqijave dhe zhvillohet si rezultat i indiferentizmit për një kohë të gjatë të urdhrave të Allahut.” Gjend-

jen e errësimit, kur zemra fillon të humbasë cilësitë e saj të qetësisë shpirtërore, transmeton këto fjalë që besohet se i ka thënë profeti Isa: “Mos qëndroni kohë të gjatë pa e përmendur Allahun, sepse atëherë do t'u ngurtësohen zemrat tuaja! Ai që kupton se zemra e tij është forcuar dhe është bërë e pandjeshme, të nisë menjëherë të përmendë Zotin dhe të lexojë Librin e Tij, sepse vetëm kështu mund të kthehet në gjendjen e mëparshme!” (*Ruhu'l-Me'ani*, XXVII, 181.)

Muhammed bin el-Fadl ka thënë se kasvet-i kalb shkaktohet nga ushqimi haram, marrja me gjëra të kota, angazhimi me gjëra të rrejshme dhe zemra e ngurtësuar bëhet e pandjeshme ndaj kryerjes së gjynaheve. (Sulemi (vd. 412/1021), Ebu Abdurrahmân *Zijadat li-Hakaiki'-Tefsir*, ed. Gerhard Böwering, Beirut, 1997, s. 152, 196.)

Kështu që, në vend që të rrihet duke u lexuar Kurani vetëm sa për t'u lexuar, më mirë është që të mbyllim portën e **kasvetit** të zemrës, duke u përpjekur të hyjmë në ndikimin e atmosferës shpirtërore të Kuranit, duke u pajisur me ndjenjat e qetësisë shpirtërore dhe frikës së Zotit për t'u distancuar nga të gjitha situatat negative. Hasan el-Basri (vd. 121/739), i ka këshilluar me këto fjalë paralajmëruese myslimanët: “*Dua t'ju tërheq vëmendjen! Beto hem tek Allahu se ai sahab ka lexuar më pak Kuran sesa përpiqeni të lexoni ju brenda ditës, prandaj edhe është qortuar nga ana e Zotit. Ndërsa ju lexoni më shumë pjesë nga Kurani, por mendoni se sa shumë gabime dhe gjynahe janë përhapur në mesin tuaj.*” (*Ruhu'l-Me'ani*, XXVII, 180.)

Ky tregim me protagonist Ebu Bekrin është një nga shembujt më konkretë që tregon se si munden krahët e këtij lugati që zhduk vitalitetin tonë shpirtëror të rrokin brenda vetes çdo person në çdo kohë dhe në çfarëdo pozite të lartë shpirtërore qoftë ai. Një ditë, kur pranë tij gjendej një bashkësi nga zona e Jemames, Ebu Bekri dëgjon ajetin 16 të sures Hadid. Kur përfundon ajeti njerëzit e fisit Jemame zënë të qajnë me ngashërim. Ebu Bekri i sheh ata me kujdes dhe u thotë: “*Të tillë ishim edhe ne një herë e një kohë, deri sa na u ngurtësuan zemrat.*” (Fahredin er-Razi, *et-Tefsiru'l-Kebir*, Teheran, XXIX, 229; el-Alusi, *Ruhu'l-Me'ani*, XXVII, 180.)

## 4. RUAJUNI NGA EFEKTET E TURBULLIRËS





## DHE INDIFERENCËS QË BUROJNË NGA KOHA!

Vlerësimi që duhet të bëjmë ne në këtë pikë është: njeriu e ka të pamundur të thyejë zinxhirin fizik të aspektit kohor të kësaj jete apo ta tejkalojë atë apo të parandalojë këtë zvarritje të kohës që shndërrohet në një tragjedi mendore dhe shpirtërore për njerëzimin. Megjithatë, njeriu duhet ta kuptojë se ai zotëron një hapësirë të gjerë lirie dhe preference përballë këtij paracaktimi të madh, sepse oqeani i tij shpirtëror dhe vullneti i tij janë ideali i tij i brendshëm dhe privat, në të cilin lundrojnë në gjendje të lëvizshme fuqitë e tij të preferencave dhe prirjeve humane. Mbjajta e kësaj pjese të njeriut në gjendje të lirë, vitale, të freskët dhe në gjendje aktive, të afërt me burimet dhe orientuesit e dritës hyjnore është një privilegj që i është dhuruar qenies njerëzore, në mënyrë që ai të shndërrojë errësirën e përkohshmërisë në një moment të përjetshëm. Në qoftë se arrijmë këtë nivel perceptimi dhe të kuptuari, dhe restaurojmë dhe normalizojmë me aromat e qetësisë shpirtërore mendjen dhe shpirtin tonë, atëherë shpirtat e besimtarëve kanë për të mbetur përherë të gjallë, të freskët dhe vitalë, edhe në qoftë se lëkura vjetërohet, gjaku trashet, dobësohet shikimi i syve dhe organet e humbasin funksionin e tyre.

Në brezin e kësaj hapësire të errësuar që gjendet larg jetës, urtësisë së të shenjtës dhe vetëdijes, ne mund të arrijmë ta gjejmë gjurmën e epokës të humbur vetëm në sajë të udhërrëfimit nga gjuhët që kanë shuar etjen e tyre në burimin e edukimit hyjnor. Ky informacion që na ka transmetuar neve Ibn Mesudi nga Profeti (a.s.) duhet vlerësuar si një kandil që ndriçon rrugën tonë : “Mos e lejoni kohën të kalojë përmbi ju, sepse atëherë do t’ju ngrutësohen zemrat! Dijeni mirë se ajo që pritët të vijë është e afërt dhe mos e harroni kurrë se ajo që nuk do të vijë kurrë është e largët.” (Sujuti, *ed-Durru’l-Menthur*, VI, 175.)

Dy zgjidhjet që mund ta ndërpresin këtë proces kaq të madh të vyshkjes dhe vjetërsimit janë përngjasimi i gjendjes së ekzistencës me përmendjen e Zotit brenda **enës** “*së dijës, vetëdijës dhe syçeltësisë*”, duke e kthyer në shprehje ekzistence një proces vetëdijësimi me në qendër Allahun; më pas leximi i Kuranit, “shkëlqimit të së vërtetës së përhershme”

që ka zbritur nga ana e Allahut me përpikmërinë e ndjesisë së përthithjes së pikave hyjnore dhe përpjekja e modelimit të jetës sipas Kuranit!

## 5. DHIKRI DHE KURANI JANË DY BURIMET E PËRHERSHME QË E MBAJNË GJALLËN NDJENJËN E QETËSISË SHPIRTËRORE

Sipas një komentimi tjetër që e trajton në kontekstin e fuqisë intelektuale dhe shpirtërore që siguron besimtari nga leximi i Kuranit dhe përmendja e Zotit si dy burime të përhershme të mbajtjes gjallë të qetësisë shpirtërore, përmendja e Zotit që përmendet në ajetin 16 të sures Hadid është Kurani, ndërsa e vërteta që ka zbritur është qetësia shpirtërore që sigurohet nga leximi i Kuranit.

Kjo përjasje mbështetet në këtë rrëfim, që gjendet në Tefsirin e Alusit, ku tregohet: “Një person i quajtur Usejd b. Hudajr po lexonte suren Kehf dhe pranë tij qëndronte i lidhur kali që kishte.

Papritur atë sahab e mbuloi një re e madhe. Kali i tij u frikësua nga kjo gjë dhe filloi të hidhte shqelma. Kur u bë mëngjes sahabi erdhi tek Profeti dhe i rrëfeu se çfarë kishte ngjarë. Profeti e dëgjoi me qetësi dhe në fund fare i tha: ‘Kjo është prehja që zbret nga leximi i Kuranit!’” (Alusi, *Ruhu’l-Me’ani*, XXVII, 180; Buhari (vd. 256/870), *Sahih*, Tefsir, Feth, 4 ; Muslim, *Sahihu Muslim bi-Sherhi’n-Nevevi*, VI, 82)

Kjo do të thotë se leximi i Kuranit duhet t’i trondisë shtyllat tona të shpirtit dhe nëpërmjet leximit të Kuranit duhen shtënë në dorë përforcimet shpirtërore të besimtarit. Mundet që ngjarja, që në hadith është treguar si re, në fakt të jetë një mënyrë alegorike e blatimeve hyjnore.

## 6. SHEMBUJ NGA HISTORIA: HEBRENJTË DHE TË KRISHTERËT TË SHPARTALLUAR NGA HISTORIA

Ajeti 16 i sures Hadid, nga njëra anë ka një frymë nxitjeje, ndërsa nga ana tjetër përmban një paralajmërim dhe qortim të shprehur me një gjuhë përgjithësuese.

Në ajetin e mësipërm u thuhet besimtarëve që “mos të bëhen si ata që u është dhënë Libri më përpara tyre”. Sado që lidhëza në gjuhën arabe *el-ledhine* është shumë e përgjithshme, sipas rregullave të gjuhës arabe pjesa “atyre që u është dhënë libri

*Mund të themi se edhe pas afërsisht një mijë e pesëqind vjetësh pas shpalljes së frymëzimit të parë hyjnor drejtuar njerëzimit, shpirtat tanë të përzhitur dhe mendjet tona konfuzë kanë nevojë që të nisin një udhëtim të ri eksplorimi.*

para jush” nuk nënkupton të gjithë popujt që kanë ardhur para ymetit të Muhamedit, por nënkupton në mënyrë specifike hebrejtë dhe të krishterët, sepse ata ishin ndër bashkësitë fetare që e ruajtën për një kohë besimin e drejtë. Ata ia kishin frikën Allahut, u mbusheshin zemrat me qetësi kur dëgjonin t’u këndohej Tavrati apo Inxhili dhe zemrat e tyre ishin të ndjeshme ndaj mësimëve të Zotit. Vetëm se me kalimin e kohës bota e tyre shpirtërore nisi të ngurtësohej dhe filluan të mos përjetonin gjendjen e drithërimave shpirtërore kur dëgjonin t’u lexoheshin Librat e tyre. Por kjo nuk mbeti me kaq, sepse ata filluan të shpiknin gjëra të reja në fe, nisën ta komentonin besimin e tyre në përputhje me dëshirat e tyre vetjake dhe u ndanë në grupacione të shumta. (Ebu’s-Suud, *Irshad*, VIII, 209; Alusi, *Ruhu’l-Me’ani*, XXVII, 181.)

Kështu, Kurani na jep një shembull nga historia, duke na hapur rrugën që të mos biem në dialektikën e “ekzistencës dhe kohës” duke na dhënë si shembull hebrejtë dhe të krishterët që kaluan nga një proces i tillë.

Në veprën *Ruhu’l-Me’ani* rrëfëhet një ngjarje e tillë e çuditshme: Ahmed b. Ebu’l-Havari tregon: Ndodhesha në një rrugicë të Basras. Paspritur dëgjova një zë që thirrte dhe u drejtova nga drejtimi nga vinte thirrma. Aty pashë një njeri që ishte shtrirë në gjendje të fikëti.

- Çfarë ka ngjarë? - i pyeta ata që ishin përreth tij.

- Ky është një njeri shumë i ndjeshëm. - më thanë. - Sapo dëgjoi një ajet të Kuranit i ra të fikët dhe ra në tokë shakull.

- Çfarë ajeti dëgjoi?

- **“A nuk ka ardhur koha për besimtarët e vërtetë, që zemrat e tyre të përulen para këshillave të Allahut dhe para së Vërtetës që Ai ka shpallur e të mos bëhen si ata, që iu është dhënë Libri më parë?! Me kalimin e një kohe të gjatë, zemrat e tyre u ngurtësuan dhe shumë syresh janë të pabindur?!”**

Ndërkohë personi të cilit i kishte rënë të fikët erdhi në vete dhe tha:

*A nuk erdhi koha e përfundimit të ndarjes,*

*A nuk ka ardhur ende koha e buzëqeshjes?*

*Për këtë të apasionuar të shkrirë dhe të thyer më dysh, ka ardhur*

*A nuk ka ardhur ende koha që të qani dhe të kërkonit mëshirë prej Zotit?*

Pastaj nisi të përsëriste me vete: “Vështirë, shumë vështirë!” dhe i ra sërish të fikët. Filluan ta tundnin që të ngrihej, por ai tani kishte vdekur. (*Ruhu’l-Me’ani*, XXVII, 180.)

## 7. DHIKRI DHE KURANI, BURIME TË PASHTERRSHËM QË RINGJALLIN ZEMRAT!

Në ajetin e 17 të sures Hadid vihet theksi tek fakti që leximi i Kuranit dhe dhikri i Kuranit janë burimi i ringjalljes së ndjeshmërisë njerëzore dhe dy burime të energjisë hyjnore. Ja edhe ajeti i mëposhtëm, që tregon një tërësi kuptimore me ajetin 16 të sures Hadid, në të cilën Zoti e ngjason ringjalljen e zemrave të ngurta me anë të leximit të Kuranit me ringjalljen e tokës së tharë nga reshjet e shiut, duke na treguar kështu me rrugë krahasimi se Ai nxit për qetësinë shpirtërore në sajë të së cilës ringjallen zemrat dhe nga ana tjetër na tërheq vërejte që të ruhemi që zemrat tona të mos ngurtësohen, në të kundërt:

**“Dijeni se Allahu e bën tokën që të ringjallet pasi ka vdekur nga tharja e madhe... Ne ua sqarojmë argumentet tona, në mënyrë që ju të përdorni mendjet tuaja.”** (Hadid, 17)

Si përfundim, mund të themi se edhe pas afërsisht një mijë e pesëqind vjetësh pas shpalljes së frymëzimit të parë hyjnor drejtuar njerëzimit, shpirtat tanë të përzhitur dhe mendjet tona konfuze kanë nevojë që të nisim një udhëtim të ri eksplorimi. Në përfundim të këtij udhëtimi, që synon të rikonceptojë sërish të kaluarën, për të formësuar në sajë të kinetikës së marrë nga e kaluara një të ardhme sa më shumë dinamike, do të arrihet gjithashtu që uni ynë të kapë të vërtetat e humbura, duke bërë që argumentet me fjalë të Zotit që janë ajetet e Kuranit dhe argumentet kozmike, të cilat janë shenjat e universit, do të qartësohen edhe më shumë për shpirtat e besimtarëve dhe në zemrat e tyre do të fryjnë sërish erërat rigjallëruese. Kjo ringjallje do të kaplojë të gjithë fuqinë tonë shpirtërore dhe administrimin e vullnetit tonë.







# Sakrifica:

## Prologu i udhës drejt lumturisë

— A. Jasin Demirxhi —

Megjithëse lumturia dhe vështirësia mund të duken si dy koncepte të kundërta me njëra-tjetrën, vështirësitë dhe problemet që jetohen gjatë kësaj jete konsiderohen edhe si prologu i ditëve të mbushura me gëzim dhe hare. Me fjalë të tjera, hallet dhe problemet janë edhe lajmëtarët e ditëve të harshme që janë duke afuar drejt nesh. Shpërblimi i durimit ndaj halleve dhe fatkeqësive është gëzimi dhe hareja që do të mbushin jetën tonë. Pra, ashtu siç ngjan për çdo gjë tjetër edhe fitimi i lumturisë kushtëzohet nga sakrifikimi dhe shpenzimi i përpjekjeve serioze në këtë jetë. Specialistët kanë nënvizuar faktin se ata që arrijnë një jetë të lumtur pasi kanë përballuar me sukses vështirësitë që kanë hasur në jetë dhe kanë shpenzuar energjitë e tyre në këtë drejtim, janë më të ndërgjegjshëm për rëndësinë dhe vlerën e jetës së qetë dhe të lumtur.

Dr. Salah Salih Rashid është një psikiatër nga Kuvajti. Ai është i njohur në lindjen e mesme me librat që ka shkruar në lidhje me lumturinë. Njëri prej këtyre librave titullohet: **“100 Këshilla për një jetë sa më të lumtur.”** Këshillat dhe konstatimet e Dr. Salah Salih Rashid në lidhje me përpjekjet që duhet të shpenzojë njeriu dhe rëndësinë e përdorimit të intelektit në këtë drejtim në mënyrë që të arrijë lumturinë në këtë jetë, janë shumë interesante.

**Salah Rashid** i ndan në katër grupe njerëzit nga aspekti i lumturisë:

1. Njerëzit e lumtur edhe në këtë jetë, edhe në jetën tjetër. Këta janë besimtarët që përpiqen për një jetë sa më të lumtur, duke përdorur për këtë qëllim edhe intelektin e tyre. Pra këta janë njerëzit më pozitivë në shoqëri.

2. Njerëzit e lumtur në jetën tjetër dhe të palumtur në këtë jetë. Këta janë besimtarët, të cilët nuk shpenzojnë energji të mjaftueshme në këtë drejtim.

3. Njerëzit e lumtur në këtë jetë dhe të palumtur në jetën tjetër. Këta janë jobesimtarët të cilët shpenzojnë energji të mëdha për të fituar lumturinë në këtë jetë.

4. Njerëzit e palumtur edhe në këtë jetë, edhe në jetën tjetër. Këta janë personat që nuk janë besimtarë dhe nuk shpenzojnë energjitë e duhura për një jetë të lumtur në këtë botë. Këta janë njerëzit më të pavlefshëm për shoqërinë dhe më fatkeqët.

Me këtë klasifikim që u ka bërë Dr. Salah Salih Rashidi njerëzve në varësi të faktit se sa të lumtur janë ata, ai njëkohësisht nënvizon faktin se lumturia është një situatë e mundshme për t'u arritur. Që të jesh i lumtur në jetën tjetër mjafton të jesh besimtar i vërtetë. Në qoftë se besimtari është i palumtur në këtë jetë, përgjegjësia e vetme për këtë gjë rëndon mbi të, sepse ai nuk e ka përdorur mendjen e tij sa duhet dhe nuk është përpjekur sa duhet të fitojë lumturinë.



Këtë të vërtetë Aliu (r.a.), e ka shprehur me këto fjalë:

- O njeri! Ti je burimi i lumturisë apo fatkeqësisë tënde, prandaj mos i kërko këto të dyja më kot atje lart në qiell apo brenda futur në tokë!

**Atëherë, cilat janë hapat që të shpien drejt rrugës së lumturisë?**

**Dr. Salah Salih Rashid** këshillon:

- Njeriu duhet të pyesë veten se çfarë është lumturia? Kjo pyetje mund të marrë afërsisht dhjetë apo njëzet përkufizime, në dritën e të cilave secili mund të krijojë një ide sa më të saktë në lidhje me lumturinë dhe mungesën e saj.

- Personi duhet të besojë thellë në zemër se ai do të jetë një ditë i lumtur, nëse i përkushtohet me gjithë fuqitë e tij këtij qëllimi. Për shembull, ai duhet të thotë: “Unë mund të ngadhënjë mbi zemërimin tim dhe me lejen e Allahut unë do të ndihem i lumtur.

- Personi duhet të përpiqet që të zhvillojë në ndër-gjegjen e tij ide që janë vërtetuar se krijojnë premisa lumturie, siç janë mendimet e llojit të nxjerrësh mësim nga e kaluara, t’ia dish vlerën momentit që je duke përjetuar, të shohësh me optimizëm drejt së ardhmes, t’i konsiderosh problemet me të cilat ballafaqohesh si “mundësi të reja për thyerjen e monotonisë”, të jesh në paqe me veten dhe me të tjerët.

- Jeta ka katër dimensione dhe ato janë: dimension i shpirtëror, shoqëror, personal dhe fizik. Njeriu i lumtur i jep secilës prej tyre rëndësinë që i takon.

- Mendo dhe shpreh me fjalë atë që dëshiron dhe kërkon dhe mos mendo rreth asaj që nuk do të dëshiroje që të të ndodhte. Në vend që të thuash: “Unë nuk dua tensione, shqetësime dhe probleme”, përdor fjalët “unë dua të jem i qetë, i lumtur.” Mendimet dhe shprehjet tuaja formuloji përherë mbi pozitivitetin.

## Këshilla për jetën e përditshme, në mënyrë që të jesh i lumtur

- Tregohu i kujdesshëm që të kryesh me përpikmëri faljen e pesë kohëve të namazit brenda ditës, që janë edhe lidhja jote më e fortë me Allahun. Lutu. Lexo për ditë diçka nga Kurani, qoftë edhe vetëm disa ajete.

- Lexo në mëngjes dhe në mbrëmje suret Ihlas, Nas dhe Felek, në mënyrë që të ruhesh nga dyshimet dhe cytjet e shejtanit. Mos harro ta bësh përherë këtë dua:

- *Unë çdo veprim e kryej me emrin e Allahut, i Cili ndalon çdo gjë në tokë dhe në qiell që t’i bëjnë dëm personit që përmend emrin e Tij. Allahu dëgjon, sheh dhe di çdo gjë deri në detaje.*

- Interesohu për prindërit tuaj dhe ndaj kohë për familjen tënde.

- Ushqehu në mënyrë të shëndetshme duke ngrënë ushqime hallall.

- Bëj sport dhe thith ajër të pastër. Mos i nënvleftëso kontrollet shëndetësore.





# Dëshmorët nuk vdesin

Osman Ersan

Shehid / dëshmor quhet myslimani i cili vritet prej armikut gjatë luftës në rrugë të Allahut Teala. Rënia dëshmor, edhe pse i vjen shumë rëndë nefsit, është kalim në një botë të përhershme dhe të lumtur. Dëshmorët shkojnë në jetën e përhershme duke flijuar për hir të Allahut gjënë më të vlefshme që kanë, pra jetën e tyre.

Rënia dëshmor është një gradë shumë sublime dhe e nderuar sipas fesë sonë. Në Kuranin Fisnik thuhet: **“Mos thoni për ata që vriten në rrugën e Allahut se janë të vdekur! Jo! Ata janë të gjallë, ndonëse ju nuk e ndjeni!”** (Bekare, 154)

Dëshmorët jetojnë te Allahu Teala dhe furnizohen me mirësi shpirtërore në pozita të larta të specifikuara për ta. Në ajetin fisnik thuhet:

**“Kurrsesi mos i quani të vdekur ata që janë vrarë në rrugën e Allahut. Jo, janë të gjallë, duke u ushqyer te Zoti i tyre. Janë të gëzuar për çfarë u ka dhënë Allahu nga dhuntitë e Tij dhe gëzojnë edhe për ata që ende nuk u janë bashkuar e**

**që kanë ngelur pas tyre (dhe ende nuk kanë rënë martirë), sepse nuk do të frikësohen (për çfarë i pret) dhe nuk do të pikëllohen (për çfarë kanë lënë pas). Ata gëzohen me dhuntitë dhe mirësinë e Allahut, sepse Allahu nuk ua humb shpërblimin besimtarëve.”** (Al Imran, 169-171)

Edhe në hadithin fisnik thuhet:

**“Shpirtrat e dëshmorëve janë brenda zogjve të gjelbër. Ata pinë nga lumenjtë dhe hanë nga frutat e xhenetit. Ata lëvizin lirisht në xhenet. Strehohen te kandilat prej floriri që ndodhen nën Arsh. Kur të shohin se sa të bukura janë ushqimet, vendbanimet dhe pijet e tyre, thonë kështu, në mënyrë që edhe vëllezërit e tyre ta admirojnë xhihadin:**

**“Ah sikur populli ynë ta dinte se çfarë mirësish na ka dhënë Allahu!”**

Allahu Teala u thotë dëshmorëve: **“Unë do t'i njoftoj ata në vendin tuaj për gjendjen në të cilën ndodhën. Në këtë mënyrë, ata do të gëzohen për këtë**



*përgëzim dhe do të jenë të lumtur.” Pastaj zbret këtë ajet fisnik.” (Ajetin e mësipërm. Shënim i përkth.) (Muslim, Imare, 121.)*

Ata që luftojnë në rrugë të Allahut Teala, do të kenë gradën më të lartë në xhenet. Në hadithin fisnik, thuhet:

*“Allahu Teala ka përgatitur njëqind grada në xhenet për ata që luftojnë në rrugë të tij. Largësia e një grade nga grada tjetër është sa largësia e tokës me qiellin.” (Buhari, Xhihad, 4.)*

Grada e rënies dëshmor është njëra prej gradave më të larta në xhenet. Kur dëshmori ta shikojë këtë, do dëshirojë të kthehet përsëri në këtë botë, në mënyrë që të bjerë dëshmor sa më shumë herë që të jetë e mundur. Në hadithin fisnik thuhet:

*“Çdo njeri që do hyjë në xhenet, nuk do dëshirojë të kthehet pas në këtë botë, edhe sikur çdo gjë e kësaj botë të ketë qenë e tij. Përveç dëshmorit, sepse kur të shikojë vlerësimin dhe nderimin e madh që do t'i bëhet, do të dëshirojë të kthehet përsëri në këtë botë dhe të bjerë dhjetë herë dëshmor.” (Buhari, Xhihad, 21.)*

Xhihadi në rrugë të Allahut Teala është prej ibadeteve më të virtytshme. Ebu Hurejra, (r.a.), transmeton:

“Të Dërguarin e Allahut, (a.s.), e pyetën:

“O i Dërguari i Allahut! Cila vepër është e barabartë me xhihadin në rrugë të Allahut?” Ai u përgjigj:

*“Asnjë vepër nuk është e barabartë me atë.” Të njëjtën pyetje ia përsëritën dy ose tri herë. I Dërguari i Allahut, (a.s.), në çdo herë dha këtë përgjigje: “Asnjë vepër nuk është e barabartë me atë.”*

Xhenazet e atyre që bien dëshmorë gjatë luftës në rrugë të Allahut Teala, varrosen pa u larë dhe me rrobat e gjakosura që kanë. Kjo konsiderohet si një shenjë se ata janë të pastër.

Dëshmorët do të vijnë në vendin e mahsherit / tubimit në Ditën e Gjykimit duke u rrjedhur gjaku si në ditën kur kanë rënë dëshmor apo janë plagosur. I Dërguari i Allahut (a.s.), thotë në një hadith fisnik:

*“Ai që plagoset në rrugë të Allahut, Ditën e Gjykimit do të dalë në audiencën e Allahut Teala duke u rrjedhur gjak nga plaga e tij. Gjaku do të ketë ngjyrën e vet, ndërsa era do të jetë erë misku.” (Buhari, Xhihad, 10.)*

Allahu Teala ua lehtëson dëshmorëve dhimbjet dhe vuajtjet e vdekjes. Kjo e vërtetë shpjegohet kështu në hadithin fisnik:

*“Aq sa ndjen dhimbje ndonjëri prej jush kur e pikon milingona, aq dhimbje ndjen nga vdekja edhe ai që bie dëshmor.” (Muslim, Imare, 156.)*

Dëshmorëve u falen të gjitha mëkatet, përveç bor-

xheve që mund t'u kenë njerëzve. Edhe këto borxhe, Allahu Teala do t'ua falë në Ditën e Kiametit pasi të zotëve të borxheve t'u japë prej mirësive të xhenetit dhe ata t'ua bëjnë hallall (dëshmorëve).

Mirësitë që fitojnë dëshmorët janë të pafundme. Në lidhje me këtë çështje, i Dërguari i Allahut, (a.s.), thotë:

*“Kur dëshmori të vritet, ndjen dhimbje nga vdekja aq sa ndjen dhimbje ndonjëri prej jush kur pickohet. Dëshmori ka shtatë cilësi: Falet që në pikën e parë të gjakut që i rrjedh. E shikon vendin e tij në xhenet. Shpëton nga ndëshkimi i varrit. Është i sigurt prej frikës më të madhe (frika prej kiametit). Në kokë i vendoset një kurorë aq e mrekullueshme, saqë një rubin i vetëm i kësaj kurore është më i vlefshëm se dynjaja dhe nga çdo gjë e dynjasë. Ai martohet më shtatëdhjetë e tri gra prej hyrive. I jepet leje të ndër-mjetësojë për shtatëdhjetë vetë prej të afërmeve të tij.” (Tirmidhi, Fedailu'l-Xhihad, 26.)*

Grada e dëshmorëve është grada e tretë, e cila vjen pas asaj të peygamberëve dhe të sinqertëve. Në ajetin fisnik shprehet kështu:

***“Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit, do të jetë me ata të cilëve Allahu u ka dhënë shumë dhunti: me profetët, me të sinqertët, me dëshmorët dhe me të drejtët! Eh sa shokë të mrekullueshëm janë këta!” (Nisa, 69)***

Në fenë tonë, qëllimi dhe sinqeriteti janë të vlefshëm po aq sa vetë veprat. Ata që nuk kanë mundësi të marrin pjesë në luftë për hir të Allahut të Lartësuar, këtë qëllim duhet ta mbartin në zemrat e tyre, sepse në hadithin fisnik thuhet:

*“Atë që dëshiron me gjithë zemër të bjerë dëshmor, Allahu do ta lartësojë në gradën e dëshmorëve edhe nëse vdes në shtratin e tij.” (Muslim, Imare, 157.)*

Edhe në një hadith tjetër fisnik thuhet:

*“Kushdo që ndërron jete pa luftuar dhe pa mbartur në zemër dëshirën për të luftuar, ndërron jetë mbi një lloj hipokrizie.” (Muslim, Imare, 158.)*

Ata që vriten në rrugë të Allahut Teala, janë dy llojesh: Lloji i parë janë ata që vriten në luftën e vogël duke e flijuar jetën e tyre me qëllim që të arrijnë pëlqimin e Allahut. Ndërsa lloji i dytë janë ata që vriten në luftë të madhe duke e shkatërruar nefsin me shpatën e dashurisë ndaj Allahut. Ky lloj është më i lartë se lloji i parë. Të gjithë ata që vriten në këto dy luftëra jetojnë në një formë jete të vërtetë të Zotit të tyre. Ata furnizohen në xhenet me mirësi shpirtërore. (Mahmud Sami Ramazanogllu, Uhd Gazvesi, fq. 105.)

Dëshira e vetme që i ka bërë myslimanët shekull pas shekulli të vrapojnë nga një front në një front tjetër dhe nga një fitore në një fitore tjetër, gjithmonë ka qenë ky besim dhe entuziazëm.



# NJERËZIT QË HANË BESIMIN E TYRE

— Abdurrahman Xhandan —

Ndodhemi midis së shkuarës dhe së ardhmes, brenda vorbullës së kohës. Me gjithë thyerjet historike që kemi jetuar, Kurani na pyet: **“Ende nuk po mendoni?”** Prishja e vazhdueshme që po ndodh, po bie si një kancer mbi të gjithë shoqërinë. Anët e pangopshme të njeriut po kacavirren me egërsi në mendjen e tij dhe bota po bëhet dëshmitare e gjenocideve të paimagjinueshme. Kriza ekonomike dhe padrejtësitë sociale, të cilat ranë si ortek mbi qenien e dobët njerëzore, kanë kthyer përmbyes edhe vlerat e saj.

Njerëzit që kanë uri trupore dhe shpirtërore, hanë besimin e tyre. Një njeri që e ka barkun bosh, mund të tentojë vjedhjen pa frikë dhe pa e vrarë ndërgjegjja. Dikush tjetër, thjesht për interesa të ngushta, mund të gënjejë ose të mashtrtojë. Ndërsa ligjet ekzistuese po e humbasin dita ditës fuqinë e tyre. Besa e dhënë nuk respektohet, sepse nuk respek-

tohet as besimi në botën tjetër. Në çdo fushë të jetës, shkelja e të drejtave është bërë diçka e pandalshme. Amaneti nuk respektohet. Numri i myslimanëve, të cilët e neglizhojnë namazin, po shtohet. Zemrat, të cilat janë të sigurta se pasuria shtohet duke dhënë për hir të Allahut, po pakësohen. Po vërehet se ata që janë të ngarkuar për të siguruar paqen dhe qetësinë shoqërore, nuk po e kryejnë detyrën e tyre. *“Kur pasuria është tek koprraci, arma tek frikacaku dhe mendimi tek i dobëti, prishet rregulli shoqëror.”* Kjo thënie e Ebu Bekrit (r.a.), sikur është posaçërisht për kohën në të cilën jetojmë.

Në një kohë, kur sipas “vlerave të përbashkëta” njerëzore të quajtura kritere, grabitja, intrigat, dhuna dhe veprimet e shëmtuara janë të ndaluara dhe asnjë sistem nuk i pranon, përse njerëzit, të cilët pranojnë se i kanë përvetësuar këto vlera, hedhin hije mbi to? *“Koha e krizës është kohë kur sprovohet besimi i njerëzve.”* Çfarë personaliteti kanë ata që, sapo të bien në vështirësi, shkelin vlerat në të cilat besojnë? Njerëzit që nuk respektojnë vlerat të cilat i kanë përvetësuar më parë, padyshim që kanë probleme me moralin, sepse ajo që u jep formë veprimeve të njerëzve, është ajo që mbartin përbrenda tyre. Ajo që cakton drejtimin e lëvizjes së tyre, nuk është vetëm

# “Njeriu i uritur ha besimin e vet.”

Viktor Hygo

dituria. Nëse çdo dituri që kalon në sitën e vahjit (shpalljes) nuk zë vend në të njëjtën kohë edhe në mendje edhe në zemër, pra nëse individi nuk ka arritur të formojë moralin e tij, humbja nuk është e largët. Nëse niveli i shkencës që ka arritur një njeri apo një shoqëri nuk është i njëjtë me nivelin e virtyteve morale, nuk është e drejtë të themi se ata kanë përparuar.

Për shkak se besimi i myslimanit është dëmtuar, edhe veprat e tij kanë filluar të prishen. Kur nuk konceptohet mjaftueshëm përbërja e “asaj” që besohet, shkatërrimi mund të vijë edhe nga një goditje e lehtë. Bota shpirtërore e individëve që nuk e kanë të fortë dinamizmin e brendshëm, është e errët. Prandaj, nuk mjaftojnë disa shkëndija për ta ndriçuar atë. Në kohën tonë, kur problemet psikologjike kanë shënuar rritje drastike, po kërkohen gjëra të cilat do të mbushin boshllëkun e brendshëm dhe do të qetësojnë zemrat.

**“Ata që besojnë dhe zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, qetësohen. Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!”** (Ra’d, 28)

Ja pra, dorëzimi pa asnjë lloj dyshimi ndaj Zotëruesit të gjithësisë, është zgjidhja e vetme, e cila do ta çojë shoqërinë drejt paqes dhe qetësisë. Ndonjëherë mund të ndodhë që edhe një mysliman të bjerë në këtë gjendje të vështirë shpirtërore. Kjo, për arsye se nuk e përmend sa duhet dhe siç duhet Allahun dhe se nuk i praktikon me përpikëri urdhrat e Tij. Dorëzimi ndaj pengesave dhe hileve, të cilat e largojnë atë nga detyra e tij, bëhet shkak i shkatërrimeve të tilla.

Shkaku kryesor i krizës që po kalon shoqëria njerëzore, është mosaplikimi në standardin jetësor i të vërtetave të cilat i besojnë. Vlerat që neglizhohen në çdo pjesë të jetës së tyre të copëtuar, duke synuar përmirësimin e së ardhmes, i bën ata edhe më të humbur. Njerëzit që tregojnë dobësi në besim, janë më afër humnerës. Sjelljet

që janë në kundërshtim me natyrën e pastër njerëzore, e bëjnë njeriun më të mjerë (jo të lumtur). Nëse ka ndonjë konflikt midis mënyrës së jetesës dhe vlerave që mësohen dhe, nëse ky konflikt shtohet vazhdimisht, do të thotë se aty ka lindur një problem shoqëror. Humbja e drejtësisë dhe sigurisë, tregon urinë e madhe materiale dhe shpirtërore. Mbushja e barkut të një njeriu me shpirt të uritur, nuk mund të ruajë ekuilibrin shoqëror. E rëndësishme është që zemra të ushqehet me një ushqim të pastër. Ndërsa kjo arrihet vetëm me anë të Kuranit. Njeriu, shpirti i të cilit ka arritur paqen, tregon durim edhe në besimin e tij.

**“Bindju asaj që të është shpallur nga Zoti yt...”** (Ahzab, 2) Ky urdhër hyjnor hap derën e paqes dhe fitimit më të madh. Nëse mirësitë e kësaj bote nuk kanë formuar ambicie brenda njeriut, nuk është e mundur që ai të veprojë diçka që nuk i ka hije besimit të tij. Njerëz të tillë, kur bien në vështirësi, nuk i kthejnë kurrizin të vërtetës, qoftë ajo edhe kundër tyre. Sido që të jetë **“O njerëz! Ju jeni të varfër e nevojtarë për Allahun...”** (Fatir, 15.) Pra, për shkak se ata e dinë se janë nevojtarë për Të dhe që të kenë fytyrë për t’i kërkuar Atij, qëndrojnë larg nga këto lloj gabimesh. Ata gjithmonë mundohen që për hir të Allahut të mbajnë në këmbë drejtësinë.

Viktor Hygo, në shtratin e vdekjes tha: **“Unë i besoj Allahut dhe botës tjetër. Jeta ime është dëshmia më e fortë për këtë.”** Për të arritur qetësinë dhe sigurinë e kësaj ata mundohen t’u qëndrojnë besnikë vlerave të cilat i besojnë. Shkaku i vetëm, i cili e mban të gjallë në mendje këtë mendim, është forcimi i mendjes dhe i zemrës nën aprovimin e vahjit (shpalljes).





# Respektimi i prindërve ËSHTË POROSI HYJNORE

— Naim Drijaj —

Imam Buhariu ka vënë si kapitullin e parë në librin e tij “Edebul Mufred” (Etika, Edukata e veçantë) kapitullin e titulluar “Edukata ndaj prindërve” duke përmendur në të ajetin: **“Ne e kemi urdhëruar njeriun të sillet mirë me prindërit e tij...”** (Ankebut, 8) dhe hadithin e transmetuar nga Abdullah ibn Mesudi r.a. se: E kam pyetur të Dërguarin e Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, se cila është vepra më e dashur tek Zoti? Ai më tha: *“Namazi në kohën e vet”*. I thashë: Po pastaj? Më tha: *“Respektimi i prindërve”*. I thashë: Po pastaj. Më tha: *“Xhihadi në rrugë të Allahut”*. (Buhariu në “Edebul Mufred”)

Si rezultat i largimit nga mësimet hyjnore, njeriu

dhe shoqëria po kalojnë një jetë të trazuar, ku nëpërkëmben vlerat dhe gjithnjë e më shumë bihet në shfrenim moral. Në këto ditë të materializmit të egër, në zemrat e njerëzve mungon drita e imanit dhe dominon errësira që shkakton një gjendje të rëndë mendore, boshllëk shpirtëror dhe me mungesë humanizmi.

Sot ka raste kur fëmijët nuk përkujdesen për prindërit e tyre, por i lënë ata nën përkujdesjen e institucioneve sociale, sikurse është azili i pleqve duke i privuar ata nga kujdesi dhe ngrohtësia që duhet të tregohet ndaj prindërve. Madje nuk janë të rralla rastet kur fëmijët ushtrojnë dhunë psikike e fizike ndaj prindërve.

Nuk duhet të harrojmë faktin se të gjithë jemi fëmijët e dikujt, prandaj le të kemi kujdes me prindërit tanë e të mos sillemi me ta ashtu siç nuk duam që fëmijët tanë të sillen me ne.

Përditë shohim e dëgjojmë raste të frikshme, por na është bërë zemra gur, na janë bllokuar veshët, na janë zënë sytë dhe asgjë nuk na bën përshtypje.

Tregohet për një çift të ri, i cili kishte një fëmijë. Fëmijën e mbante nëna e burrit. Njëherë burri deshi t'i bënte një dhuratë gruas së tij dhe i blen një unazë shumë të shtrenjtë. Nëna ishte në krahun tjetër me fëmijën e tyre. Nënës i pëlqeu një unazë e thjeshtë. Kishte kohë që nuk kishte vënë unazë në gishtin e saj, prandaj e mori atë unazë dhe e vuri në gisht. Kur burri nxjerr paratë për të paguar, shitësi i thotë që duhet të paguajë edhe një shumë tjetër për unazën që kishte marrë nëna e burrit. Atëherë ky burrë kthehet dhe i thotë nënës, se plakat nuk mbajnë flori. Nëna hidhërohet, e heq unazën dhe del nga dyqani duke qarë, por gruaja i tha burrit të saj: "Nuk bëre mirë që i fole kështu. Kush do e mbajë fëmijën tonë tani e mbrapa"? Katastrofë si burri, si gruaja. Kur ky njeri shkon t'i kërkojë falje nënës së tij, ajo i thotë vetëm një fjalë: "Nuk dua asgjë prej teje. Ta bëftë fëmija po të njëjten gjë."

Sjellja e mirë me prindërit vjen menjëherë pas besimit në Allahun e madhëruar:

**"Zoti yt ka urdhëruar, që të mos adhuroni askënd tjetër përveç Atij dhe të silleni mirë me prindërit. Nëse njëri prej tyre ose të dy arrijnë pleqërinë te ti, mos u thuaj as "uh", mos i kundërshtoj, por drejtoju atyre me fjalë respekti."** (Isra, 23)

## **1. RESPEKTIMI I PRINDËRVE BËHET SHKAK QË TË MOS NA BIEN MBI KRYE FATKEQËSI TË NDRYSHME**

Argument për këtë është ngjarja e tre personave që kishin hyrë në shpellë dhe një gurë i madh kishite rënë duke e mbyllur hyrjen e shpellës. Në këtë gjendje, secili prej tyre iu lut Allahut me nga një punë të mirë që kishin bërë për hirë të Tij. Njëri prej tyre iu lut Zotit duke përkujtuar respektimin e prindërve: "O Zot, Ti e di që unë kam pasur prindërit e moshuar dhe fëmijët e vegjël. Sa herë që milja bagëtinë, nuk u jepja fëmijëve qumësht para se të pinin prindërit. Një natë u vonova me bagëtinë në kullotë dhe kur shkova t'u çoj qumështin prindërve, i gjeta duke fjetur. Megjithëse fëmijët qanin nga uria, unë nuk u dhashë pasi e kisha bërë zakon që të pinin prindërit të parët. Qëndrova me enën me qumësht te koka e tyre derisa u zgjuan në mëngjes. Pasi pinë prindërit, ushqeva fëmijët e mi. "O Zot, nëse këtë vepër e kam bërë për hatrin Tënd dhe për të arritur shpërblimin Tënd, na e largo këtë shkëmb nga hyrja e shpellës". Në atë çast shkëmbi

lëvizi dhe të tre arritën të dalin jashtë nga shpella. (Buhari, Muslim)

## **2. RESPEKTIMI I PRINDËRVE KONSIDEROHET XHIHAD**

Transmeton Abdullah ibn Amri r.a që ka thënë: "Erdhi një person tek i Dërguari i Allahut dhe i kërkoi leje Pejgamberit a.s që të merrte pjesë në Xhihad. Pejgamberi e pyeti: A i ke të gjallë prindërit? Ai iu përgjigj: Po. Pejgamberi a.s i tha: *Xhihadi yt është kujdesi për prindërit.* (Buhari, Muslim)

## **3. RESPEKTIMI I PRINDËRVE ËSHTË SHKAK PËR HYRJEN NË XHENNET**

Transmeton Ebu Darda r.a. se e ka dëgjuar Pejgamberin a.s. duke thënë: "*Prindërit janë dera e mesme e Xhenetit, pra nëse dëshiron fitoje atë derë ose humbe atë.*" (Tirmidhiu) Kushejri ka thënë: "...dera e mesme e Xhenetit, do të thotë, dera më e mirë e Xhenetit."

## **4. KËNAQËSIA E ALLAHUT ËSHTË NË KËNAQËSINË E PRINDËRVE**

Pejgamberi a.s. ka thënë: "*Kënaqësia e Allahut është në kënaqësinë e prindërve, kurse zemërim i Allahut është në zemërimin e prindërve!*" (Tirmidhiu)

Imam Shafiu (r.a.) tregon se kur ulej të hajë bukë, nuk hante derisa të përfundonte nëna e tij. Kur e pyetën rreth shkakut, u përgjigj: "Kam frikë se mos zgjas dorën të marr diçka që do të donte ta hante nëna ime".

Nga historitë e dhimbshme, që tregohen rreth fëmijëve që i harrojnë prindërit në pleqëri, është edhe kjo: Një i moshuar, të cilin fëmijët e kishin cuar në shtëpinë e pleqve, pas disa kohësh vdes. Drejtuesit e azilit u telefonojnë fëmijëve dhe u tregojnë që babai i tyre kishte vdekur.

Përgjigja e fëmijëve nga telefoni ishte më e rëndë se vdekja e babait të tyre. Ata të habitur pyetën: "Po pse deri tani paska jetuar?".

## **5. MOSRESPEKTIMI I PRINDËRVE ËSHTË NGA GJYNAHET E MËDHA**

Pejgamberi a.s ka thënë: "*A dëshironi t'ju tregoj për gjynahet më të mëdha?*" Këtë e përsëriti tri herë. Ne i thamë: "Po, o i Dërguar i Allahut." Pejgamberi a.s. tha: "*T'i bëni shirk Allahut dhe të mos respektoni prindërit...*" (Buhari, Muslim)

Pejgamberi a.s. ka thënë: "*Çdo gjynah Zoti mund ta shtyjë për jetën tjetër, ndërsa keqtrajtimin e prindërve Zoti e dënon që në këtë jetë.*"





# Manaferrat

## FRUTI MË I MIRË I VERËS

Manaferrat janë ndër frutat më të mira që mund të gjejmë tani në treg.

Kur kanë ngjyrë të errët kjo tregon se manaferrat kanë më shumë antioksidantë të cilat na ndihmojnë për të mposhtur plakjen, kancerin dhe sëmundje të tjera.

Ky frut i egër është i pasur me vitamina A, E, K dhe B, fibër, antioksidantë dhe flavonoidë që garantojnë një shëndet të mirë.

Një filxhan çaji me manaferra ofron 8 gramë fibër dhe më shumë se çerekun e nevojës ditore për vitaminë C dhe K.

Manaferrat i bëjnë mirë lëkurës, trurit dhe sistemit tretës.

Ato janë ndër frutat më të rekomanduara nga dietologët për rënien nga pesha.

### MANAFERRA PLOT ME ANTIOKSIDANTË DHE FIBËR PËR RËNIEN NGA PESHA

Një studim i Universitetit të Floridës zbuloi se njerëzit që konsumojnë shumë fruta të pasura me antioksidantë kanë një peshë më të shëndetshme.

Antioksidantët tek manaferrat aktivizojnë gjenet që janë përgjegjëse për djegien e yndyrave.

Për më tepër, polifenolët tek manaferrat kanë af-

tësinë të pengojnë formimin e depozitave dhjamore në organizëm.

Sipas studiuesve, fibra që ndodhet tek manaferrat ndihmon në normalizimin e lëvizjes së zorrëve, ul kolesterolin, mirëmban nivelin e sheqerit në gjak dhe ndihmon në arritjen e një peshe ideale të shëndetshme.

### FIBRA NGADALËSON TRETJEN DHE JUMBAN TË NGOPUR PËR SHUMË GJATË

Duke qenë se manaferrat ofrojnë shumë fibër dhe shumë pak kalori, ato konsiderohen si një frut perfekt për ata që duan të humbasin në peshë.

Ekspertët rekomandojnë që të konsumoni më shumë fruta pylli dhe veçanërisht manaferra gjatë stinës së verës.

Ato mund t'i hani veçmas ose t'i përfshini në sallata e lëngje të ndryshme të kombinuara me perime të cilat mund t'i pini rregullisht.

Konsumi i frutave të pyllit është një mënyrë shumë e mirë për tu kujdesur për peshën në verë, megjithatë një rënie e shëndetshme prej peshës mund të arrihet duke treguar kujdes me ushqimin dhe kryer shumë aktivitete fizik.



# Qumështi apo Kosi

## CILI ËSHTË MË I MIRË PËR MËNGJES?

Produktet e bulmetit janë një pjesë e rëndësishme e çdo regjimi të shëndetshëm ushqimor.

Megjithatë, në disa aspekte, përzgjedhja e llojit të duhur të produkteve të bulmetit bën një ndryshim të ndjeshëm.

Në këtë artikull do të mësoni se si të bëni përzgjedhjen e duhur mes qumështit dhe kosit për shëndetin e organizmit.

### PASURIA E USHQYESVE TEK KOSI DHE QUMËSHTI

Si qumështi ashtu edhe kosi janë të shkëlqyer sa i përket pasurisë së kalçiumit, kaliumit dhe vitaminës D.

### QUMËSHTI

Qumështi përmban edhe tryptophan, vitaminat B2, B12, K dhe A.

Ai është gjithashtu i pasur me proteinë por edhe fosfor.

Shumica e këtyre ushqyesve gjenden më shumë tek qumështi i lopës.

Qumështi në përgjithësi ndihmon në uljen e tensionit të gjakut por ai rekomandohet edhe në uljen e rrezikut të sëmundjeve kancerogjene, mbipeshës, diabetit dhe sëmundjeve të zemrës.

### KOSI

Kosi i përmban me bujari të gjithë ushqyesit e lartpërmendur por edhe proteinë, zink, vitaminë B5 dhe probiotikë.

Këta të fundit janë një prej ndryshimeve më ma-

dhore mes qumështit dhe kosit

Probiotikët janë të domosdoshëm për shëndetin e stomakut dhe tretjen.

Kosi i shtëpisë i fermentuar me farë natyrale është i pasur me probiotikë por përmban edhe sasi më të larta të kalçiumit dhe kaliumit.

Probiotikët në fjalë kurojnë problemet me aciditetin në stomak, ulçerën dhe zorrët.

Nga ana tjetër, kalçiumi tek kosi përthithet më mirë nga organizmi në krahasim me kalçiumin që gjendet tek qumështi.

Kjo ndodh falë prezencës së acidit laktik që shërben si ndërmjetës për përthithjen e kalçiumit.

Një ndryshim tjetër mes qumështit dhe kosit është se ky i fundit tretet dhe pranohet më lehtë nga organizmi.

Ka shumë njerëz në botë që kanë intolerancë ndaj laktozës, ndaj kosi është më i përshtatshëm për ta.

Për më tepër, kosi është më i butë për organizmin e njerëzve që vuajnë nga fryrjet, aciditetin e tjerë.

### CILI REKOMANDOHET PËR MËNGJES

Për shkak se tretet më lehtë dhe ka më shumë probiotikë, kosi është më i rekomandueshëm për mëngjes. Mund ta kombinoni me fara të ndryshme apo drithëra për më shumë energji gjatë ditës..

Edhe qumështi mund të konsumohet pa problem, por duhet të keni parasysh se stomaku do më shumë kohë për ta asimiluar.



## SHKENCËTARËT ZBULOJNË VENDIN MË TË FTOHTË NË TOKË, TEMPERATURAT ARRIJNË DERI NË MINUS 97°C

Shkencëtarët kanë zbuluar vendin më të ftohtë në Tokë. Temperaturat ekstreme të ulëta prej minus 97 gradë celsius, janë regjistruar në një pllakë të akullit në Antarktidë gjatë një nate të gjatë dimri, shkruan National Geographic.

“Ky vend do të ishte ideal për jetesë në një planetë tjetër”, ka deklaruar studiuesi Ted Skamboz, nga qendra nacionale për borë dhe akull në Universitetin e Kolorados.

Këto temperaturat kaq të ulëta kanë “lënë” në hije ato të matura në stacionin rus Vostok në vitin 1986, ku shkencëtarët rusë kishin matur temperaturën prej minus 88,8 gradë celsius.

Ky ajër i ftohtë nuk mund të thithet për një kohë të gjatë, vetëm disa herë frymëmarrje do të mjaftonte që të shkakton gjakderdhje në mushkëri dhe vdekje të shpejtë.

Kjo edhe është arsyeja pse shkencëtarët rusë kanë mbajtur maska para se të thithnin ajrin e nxehtë. Edhe pse pjesa lindore e Antarktidës duket si një hapësirë e rrafshët, ajo është paksa e pjerrët.

Ndërkaq mbi sipërfaqen e pllakës së akullit nuk ekziston kurrfarë stacioni meteorologjik, kështu që ekipi i Skambozit besojnë se temperaturat mund të jenë edhe më të ulëta në këtë pllakë të akullit.

## ZBULIME TË REJA PËR RRUGËN E QUMËSHTIT, SHPËRTHEU 3.5 MILIONË VJET MË PARË

Një energji katalizimike ka përfshirë galaktikën tonë, Rrugën e Qumështit, rreth 3.5 milionë vjet më parë.

Sipas një ekipi astronomësh, shpërthimi Seyfert nisi afër një vrime të zezë super të madhe në qendër të galaktikës. Pasojat janë ndjerë 200 mijë vite dritë larg.

Zbulimi se qendra e Rrugës së Qumështit ka qenë më dinamike nga sa mendohej më parë, mund të çojë në një ri-interpretim të plotë të evolucionit të saj.

“Këto rezultate do të ndryshojnë dramatikisht njohuritë tona për rrugën e qumështit- thonë shken-

cëtarët nga universiteti i Sidneit në Australi. Ne kemi menduar gjithnjë për galaktikën tonë si një galaktikë jo aktive, me një qendër jo shumë të shndritshme”, thonë shkencëtarët.

Shpërthimi ka shkakuar dy kone gjigante të jonizuara që janë shpërndarë nëpër Rrugën e Qumështit.

Ekipi i shkencëtarëve i udhëhequr nga profesori Joss Bland Hawthorn, nga Këshilli australian i kërkimeve, kanë përdorur të dhëna të mbledhura nga teleskopi hapësinor Hubble për të përlogaritur se kur një shpërthim masiv energjie të lartë ka ndodhur.



## MISIONI INDIAN I HAPËSIRËS ZBULON UJË TË NGRIRË NË SIPËRFAQEN E HËNËS

Shkencëtarët kanë gjetur dëshmi përfundimtare që konfirmojnë praninë e ujit të ngrirë në sipërfaqen e Hënës, transmeton BBC.

Depozitat e akullit u gjetën në polet veriore dhe jugore të Hënës dhe ndoshta kanë origjinë të lashtë. Shpikja u vlerësua për misionin indian – Chandra 1, instrumentet e të cilit eksploran Hënën midis viteve 2008 dhe 2009.

Rezultatet e misionit u botuan në revistën Proceedings of the National Academy of Sciences (PNAS).

Shpërndarja e depozitave të akullta është e pabarabartë. Në jug, shumica e akullit është e përqendruar në kratere, ndërsa në hemisferën veriore akulli është më i gjerë dhe më i përhapur. Misioni indian përdori pajisjen për hartimin e mineralit M3 dhe identifikoi tre karakteristika specifike të akullit në sipërfaqen e Hënës.

M3 jo vetëm që ka regjistruar reflektimin e akullit, por ka matur drejtpërdrejt mënyrën në të cilën molekulat e akullit thithin dritën infra të kuqe. Kjo do të thotë se mund të regjistrohen dallimet midis gjendjeve agregate.

## NGROHJA GLOBALE MUND TË SHKAKTOJË ÇEKUILIBRIM TË KLIMËS

Shkencëtarët kanë paralajmëruar se Toka mund të përballet me një çekuilibrim të klimës në rast se rritja e mesatares së ngrohjes globale arrin në nivelin që shkakton çlirimin e rezervave kritike të karbonit.

Shkencëtarët nga Instituti “Stockholm Resilience Centre” kanë theksuar se nëse disa nga depozitat kritike të karbonit në tokë shpërndahen dhe në rast se karboni i ruajtur këtu përhapet në atmosferë, efekti “domino” që do të krijohet mund të tërheqë tokën në një mosbalancim të pakthyesëm klimaterik.

Shkencëtarët theksojnë se pyjet, oqeanet dhe toka absorbojnë 4,5 miliard tonë karbon dhe nëse kjo përhapet në atmosferë do ta kthente tokën në një “tokë serë”.

Në një botë të tillë, thuhet se temperaturat mesatare mund të rriten me 4-5 gradë dhe niveli i detit mund të rritet me 10 deri në 60 metra.

Profesori për klimën që kryeson studimin, Johan Rockström, është shprehur se nëse rritja e temperaturës globale arrin 2 centigradë, ne i japim direkt planetit tonë mekanizmin tonë të kontrollit.

“Për momentin kemi kontrollin, por vetëm nëse tejkalojmë 2 gradë, bota nuk do të jetë më miqësore me ne, por do të bëhet një armik. Ne do ta kemi dorëzuar fatin tonë në duart e një planeti që ka filluar të humbasë ekuilibrin e tij”, theksoi Johan Rockström.

Rezultatet e studimit janë publikuar në revistën e Akademisë Amerikane të Shkencave “Proceedings of the National Academy of Sciences”.







## *Souvenir Albania*

*tregton me shumicë dhe pakicë  
punime artizanale të cilësisë së lartë.*




Kontakt: mob: +355 69 20 72142 / email: arditbilani@yahoo.com / Shkodër-Albania





## "LUX DEKOR"

Lux Dekor është firmë private e specializuar për prodhimin e kuzhinave si dhe orendive të ndryshme shtëpiake dhe të zyreve. Bën shitjen e materialit: iverëplaka, MDF, folje për vakumpress, dhe të aksesuarëve përcjellëse për mobiljeri. Bën prodhimin e balloreve – mvëshjen me ultrplast – laminat, si dhe plastifikimin vakumpres – ballonpress te balloreve me folje te pvc-se në dimensione të kerkuara nga klienti, gravirimin e fronteve me makinë CNC, kandimin –qitjen e shiritëve pvc dhe abs, prerjen e pllakave, të gjitha keto kryhen me makina te persosur kualitet dhe cilësi te lart.








**VILA DANTE**  
RESTORANT


 ADRESA: TUSHEMISHT, POGRADEÇ

**SHOPPING**  
**H O U S E**

  
ADRESA:  
RRUGA QEMAL DRAÇINI  
TEK SAHATI, SHKODËR



# ÇAPA<sup>®</sup> musluk



## REYHAN

Kosovë për herë të parë  
me 5 vjet garanci

N.T.SH. REYHAN  
Distributor për KOSOVË

Të gjitha llojet e baterive, rubinetave të CAPA mund  
t'i gjeni tek firma N.T.Sh. REYHAN - Prizren.  
Si dhe mund të gjeni edhe nëpër lokale të tjera  
në KOSOVË

**ELEGANCË, BUKURI, CILËSI  
DHE 5 VJET GARANCI  
ME ÇMIME TË VOLITSHME**



ISO 9001



**5** ★★★★★  
Yil Garanti

[www.capamusluk.com.tr](http://www.capamusluk.com.tr)

[www.reyhan-ran.com](http://www.reyhan-ran.com)

*Armatürde Dünyaya Vurulan Marka*

Rr:UCK, Pn Tel: + 381 29 225 555  
Prizren - KOSOVË Mob: + 377 44 115 238

Shitje me shumicë mund të kontaktoni  
përmes telefonave dhe web faqes.





Ju ofron:

Kushte bashkëkohore,  
ushqim cilësor dhe të kontrolluar,  
staf të kualifikuar.

Ju mirëpresim!



Lagja Perash, Bulevardi Mehmet Pashë Plaku,  
Pranë Xhamisë Perash, Shkodër

+355 67 47 39389



1 Staf arsimor cilësor

2 Kushte arsimore sipas standarteve të larta

3 Aktivitete sociale, kulturore dhe sportive

4 Klasa dhe laboratorë të kompletuar

5 Ambiente familjare në konvikt dhe cilësi në ushqim



**CIKLI FILLOR**  
(djem dhe vajza)  
**1**  
NGA KLASA E **1**-RË  
DERI NË KLASËN E **5**-TË





“Mos e hidh shikimin  
në të mirat kalimtare,  
që Ne ua kemi dhënë disave  
prej tyre si stoli të jetës  
së kësaj bote,  
për t'i vënë ata në provë!  
Shpërblimi i Zotit tënd  
është më i mirë  
dhe më e qëndrueshëm.”

*(TaHa, 131)*